ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues · Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 28 SHTATOR 2024 · NUMËR 303 · VITI VII I BOTIMIT · ÇMIMI 50 LEKË · WWW.EXLIBRIS.AL · EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL · BOTIM I ONUFRI SHPK

AG APOLLONI

Dokuromani, një zhanër për ruajtjen e kujtesës historike

Bisedoi Elona Gjata

Me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Nasi Lerës dhe të 60-vjetorit të krijimtarisë së tij

Gjithëpushtetshmëria dhe vlefshmëria e rrëfimit poetik

Nga Anton Nikë Berisha



Nasi Lera lindi në Korçë më 29 shtator 1944. Është njëri nga prozatorët tanë bashkëkohorë më të shquar. Me një varg përmbledhjesh me tregime, novela dhe romane të botuar, e lartësoi dhe e pasuroi prozën tonë nga rrafshe dhe aspekte të ndryshme. Ai është ndër shkrimtarët tanë të rrallë që di pse shkruan dhe di çka shkruan. Vepra e tij është e lidhur me botën tonë; e shpreh poetikisht këtë botë dhe i kthehet po kësaj bote...

Publicistika e Ernest Koliqit si fitore e historisë së tij intelektuale

Nga Ardian Ndreca (fq. 6)

SHËNIME MBI LIBRAT

Vëzhgim mbi librin "Kratere njerëzish"

Ballsor Hoxha është zë unik që vjen drejt lexuesit

Nga Flurans Ilia (fq. 13)

DRITËSIMI I DE RADËS

Nga Dr. Skënder Karriqi (fq. 10)

Për motivimin e dritësimit të poetit Jeronom de Rada, mendojmë se vlen të përmendet edhe fakti që për argumentimin e tezave të ndryshme, De Rada niset nga shembuj me natyrë dhe efekte dritësuese.

Mendime, opinione dhe analizë rreth vëllimit poetik "Këngët e Babës" të autorit Bislim Ahmetaj

Ati si perendi, si gjest, si autoritet, si dashni dhe mall

Nga Mark Simoni (fq. 14)

URAT E KOMUNIKIMIT MES KULTURËS ÇAME DHE ASAJ GREKE

Nga Enver Kushi (fq. 8)

Çamëria ime mitike kërkon rikthimin në trojet e saj të shpirtit çam: baladave, këngëve, kostumeve popullore, valleve, rikthimin e miqësive të vjetra jo vetëm me vëllezërit e saj të krishterë, por edhe me grekët, vllehët etj.

Ndahet çmimi "Martin Camaj" për vitin 2024

(fq. 11)

Poezia "Silvias" e Giacomo Leopardi-t

Të lexosh poezinë si një partiturë

Nga Natasha Poroçani (fq. 22)

EMIL ZOLA DHE FOTOGRAFIA - NJË FAQE DASHURIE

Nga Xhyher Cani PhD (fq. 20)

(Me rastin e Ditës Botërore të Përkthimit)

Yasmina Melaouah

Përse jam përkthyese

Përktheu Mariana Ymeri (fq. 18)

BIBLIOTEKË

Mircea Cartarescu (fq. 16)
Solenoid
(Përktheu nga origjinali Luan Topçiu)

Joyce Carol Oates (fq. 17)
Melankoli amerikane
(Përktheu nga origjinali Qerim Raqi)

Ilda Mejdani Jeha (fq. 15)
Me butësi jasemini

Lazër Rrok Lumezi (fq. 15)
Shkodrës

Alfred Duka (fq. 19)
Xhandari i urës

Arben Meksi (fq. 24)
Karikatura e së shtunës

Moskuptimi i shkrimtarëve gjenialë. Rasti Kadare

Nga Bujar Skëndo (fq. 12)

Promovohet sot në Vlorë romani "Mossanga" i autorit Fate Velaj

0ra 11.00, në kinemanë e qytetit

AG APOLLONI

Dokuroman, një zhanër për ruajtjen e kujtesës historike

Bisedoi Elona Gjata

E. Gj: Zoti Apolloni, faleminderit që e pranuat ftesën time për këtë intervistë. Kjo intervistë do t'i referohet dy romaneve të fundit nga krijimtaria juaj *"Një fije shprese, një fije shkrepse" dhe "Kësulkuqja, përrallë për të rritur"*, të cilët i përkasin një zhanri mjaft interesant, por jo aq të lëvruar në letërsinë shqipe. Pra, zhanri dokuroman.

A.A: Në fakt, pastërtisht dokuroman është *Një fije shprese, një fije shkrepëse,* ndërsa *Kësulëkuqja* është roman me dy linja, nga të cilat vetëm njëra (ajo e përdhunimeve) është e dokumentuar dhe e dokumentueshme. Por, gjithsesi, pavarësisht përqindjes së ndryshme të dokumentaritetit, të dy romanet mund të klasifikohen si rrëfime dokumentare.

E. Gj: E si parantezë të kësaj interviste po ju drejtohem sërish me pyetje: përse kjo zgjedhje?

A.A: Letërsia e mirëfilltë gjithmonë e ka mbajtur një lidhje të fortë me realitetin. Në shekullin e kaluar janë shfaqur disa raste të romaneve dokumentare, por që konsiderohen përjashtime, ndërsa në shekullin e ri ato tashmë janë rregull, jo përjashtime. Unë kam zgjedhur të rrëfej artistikisht me fakte, sepse fakti tërheq më shumë se fantazia. Ndoshta, në kuadër të letërsisë shqipe, këtë tip letërsie e kam çuar deri në ekstremitet, mirëpo përderisa ka kaq shumë interesim (dhe jo vetëm nga shqiptarët), mendoj se kam bërë zgjedhjen e duhur.

E. Gj: Përpara se të vazhdojmë më tutje, dua të informoj lexuesin se kjo intervistë do të jetë e ndarë në tri pjesë.

PJESA I: KËSULËKUQET E KOSOVËS

E. Gj: Cili është qëllimi i rimarrjes së figurës së Kësulëkuqes dhe përshtatja në këtë lloj zhanri letrar?

A.A: Ishte rastësi. Po lexoja për origjinën e përrallave, dhe më bëri përshtypje të veçantë *Kësulëkuqja*, që supozohej se ishte një histori përdhunimi me origjinë nga Mesjeta. Kjo hipotezë ma ndezi imagjinatën për një roman dhe pastaj më çoi kah historitë e përdhunimeve në luftën e fundit në Kosovë.

E. Gj: A është kjo vërtet një përrallë për të rritur apo një përrallë e domosdoshme për lexuesin?

A.A: Le të themi se kjo është një përrallë e domosdoshme për lexuesin e rritur.

E. Gj: A synojnë të dy romanet e tua, *"Një fije shprese, një fije shkrepse" dhe "Kësulkuqja, përrallë për të rritur"* ndërtimin e kujtesës historike mbi luftën e fundit në Kosovë te gjenerata e re shqiptare, si edhe te lexuesi gjithashtu?

A.A: Njëri nga funksionet e këtyre romaneve mund të jetë edhe kontributi në ndërtimin e kujtesës historike. Por, romanet e mia kurrë nuk e kanë vetëm një funksion. Pas botimit të romanit *Një fije shprese, një fije shkrepëse*, disa lexues më kanë shkruar se, para se ta lexonin këtë roman, nuk e kanë ditur çfarë ka ndodhur në Kosovë, dhe më falënderonin që i kisha informuar. Për mua, lufta ishte aq afër sa më dukej e habitshme që fëmijë të lindur pas mbarimit të saj, ishin rritur dhe po mësonin për të nga librat e mi. Para se t'i lexoja ato emaile të lexuesve, ende e mbaja veten për të ri.



E. Gj: Në sa gjuhë janë përkthyer këto dy vepra? Dhe cili është qëllimi i përkthimit të tyre?

Është e vështirë të jepet një përgjigje e saktë këtu, meqë ka shpërthyer një interesim për këto dy romane, aq sa para se të botohet kjo intervistë, mund të rritet numri i përkthimeve të botuara. Deri tani, *Një fije shprese, një fijë shkrepëse* është botuar në tri gjuhë të huaja (anglisht, gjermanisht, holandisht), është përkthyer edhe në katër të tjera (frengjisht, bullgarisht, sllovenisht, serbisht) dhe është në proces përkthimi edhe në disa gjuhë të tjera. Ndërsa, romani "*Kësulëkuqja*" është përkthyer në anglisht dhe gjermanisht, ku do të botohet së shpejti, ndërsa në proces përkthimi është edhe në holandisht. Qëllimi i përkthimit është të zgjerojë rrethin e lexuesve. Gëzohem që reagimi për këto dy romane ka qenë kaq afirmativ.

E. Gj: Në veprën *"Kësulëkuqja, përrallë për të rritur"*, tema e përdhunimit paraqitet si tabu për shoqërinë kosovare, madje edhe në ditët e sotme. A vazhdon të jetë tabu dhe në jetën reale?

A.A: Si temë diskutimi, përdhunimi është temë e sikletshme për të gjithë njerëzit, pa dallim kombësie. Për dhunën kurrë nuk është e lehtë të diskutohet, aq më pak për dhunën seksuale.

E. Gj: Në vepër ka fragmente ku rrëfehen histori të ndryshme mbi këtë temë nga personazhet tuaja. A ka nga ndonjë personazh real në vepër të cilin ju e keni kamufluar artistikisht?

A.A: Të gjitha rastet e përdhunimeve

që përmenden, janë të vërteta. Unë kam ndryshuar formën, jo faktet.

E. Gj: A ju është dashur të kryeni kërkime arkivore për shkrimin e këtyre veprave? Nëse po, a mund të ndani ndonjë eksperiencë personale me lexuesin?

A.A: Po, kam përdorur dokumente të ndryshme, kam selektuar, kam modifikuar ndonjë gjë në aspektin stilistik, dhe, kur është fjala për romanin *Kësulëkuqja*, jam kujdesur që përveç rasteve, që tashmë vetë viktimat i kanë bërë publike, të mos jap detaje identifikuese. Por, sigurisht, disa gazetarë dhe hulumtues, mund t'i identifikojnë lehtë personazhet e mia. Ndërsa, për romanin *Një fije shprese, një fije shkrepëse*, përvec materialeve në Kosovë, kam shfrytëzuar edhe shumë materiale (fjalime, dokumente, incizime, video, reportazhe etj.) nga jashtë, sidomos nga "arkivi i ngrirë" i Shtëpisë së Bardhë. Ky është një arkiv nacional, me qasje të hapur, i cili ruan materialet që lidhen me pozicionin dhe përfshirjen e SHBA-së dhe Presidentit Klinton në Luftën e Kosovës.

PJESA II: NIOBA E GJAKOVËS

E. Gj: Perse e keni quajtur personazhin e veprës *"Një fije shprese, një fije shkrepse"*, Ferdonije Çerkezin, Nioba e Gjakovës? Çfarë kanë të përbashkët këto dy personazhe?

A.A: Është ngjashmëri në fatkeqësi. Si Nioba mitike, edhe Ferdonija humbi tragjikisht familjen. Gruaja mitike u kthye në gur vajtues, ndërsa dhimbja e e nënës gjakovare peshon si një gur në zemrën e çdo qenie humane që njeh fatin e saj.

E. Gj: Paralelisht në vepër zhvillohet dhe historia e nënë Pashkës Si do ta përkufizonit shkurtimisht për lexuesin historinë e saj?

A.A: E kam thënë pothuajse në të gjitha prezantimet e librit se rasti i Pashkë Markut më ka prekur jashtëzakonisht shumë, kur kisha lexuar lajmin për fundin tragjik të saj. Në librin tim, ajo nuk është figurë vetëm tragjike, por edhe filozofike. Më shumë sesa person, ajo është simbol, simbol i njeriut thellësisht besimtar, të revoltuar ndaj mizorisë njerëzore dhe indiferencës hyjnore.

14. **A vazhdon të ruhet ende në Kosovë guri që simbolizon aktin a vetëflijimit (atë vetëdjegies) të nënë Pashkës?**

A.A: Për habinë time dhe, besoj, të shumë shqiptarëve, para disa muajsh ai gur u hoq nga pronari i arës, ku e ndjera ka djegur veten. Supozohet se kjo heqje u bë për arsye fetare (pronari, një shqiptar musliman, kishte frikë së aty mund të ndërtohej ndonjë kishë). Fatkeqësisht, organet shtetërore u treguan shumë të qullëta për ta kthyer atë gur në vendin ku ajo grua e fortë i kishte dhënë fund jetës.

PJESA III: KOSOVA, NJË LUFTË MORALE

E. Gj: Një nga personazhet tuaja në veprën, *"Një fije shprese, një fije shkrepëse"*, është një nga të mbijetuarit e Holokaustit, shkrimtari hebre, Eli Vizel, i cili shprehet se për amerikanët Kosova është një luftë morale. Çfarë do të thotë kjo?

A.A: Kjo do të thotë që ata nuk intervenuan për përfitime materiale, por për arsye humanitare. Amerikanët e shpëtuan një popull nga shfarosja dhe nga shpërngulja, e cila mund të çonte drejt asimilimit. Prandaj është e kuptueshme pse shqiptarët e Kosovës i janë kaq shumë falënderues amerikanëve dhe nuk bëjnë asgjë pa u koordinuar me ta. Ne mbijetuam falë amerikanëve, të cilët jo rastësisht dërguan në kampet tona të shpërnguljes një hebre që u kishte mbijetuar kampeve të shfarosjes. Pra, nuk është e rastit që një njeri që kishte humbur familjen në Luftën e Dytë Botërore u dërgua të bënte një raport për vuajtjet dhe traumat e shqiptarëve të shpërngulur si pasojë e luftës së viteve '98-'99. Duke qenë një figurë e madhe morale, Eli Vizeli denoncoi fuqishëm spastrimin etnik që po u bëhej shqiptarëve.

E. Gj: A ishte lufta e fundit holokausti i shqiptarëve të Kosovës?

A.A: Edhe pse lufta e Kosovës ishte një tragjedi e madhe, nuk mund të krahasohet me holokaustin, numri i viktimave të të cilit është më i madh se numri i banorëve të Kosovës dhe Shqipërisë të marrë së bashku.

E. Gj: Cila është gjëja e parë që ju vjen në mendje nga udhëtimi i djaloshit 16-vjeçar (që jeni vetë ju) nga Kaçaniku për në Stagovë, dhe më pas drejt Maqedonisë së Veriut, gjatë luftës së vitit 1999, te vepra "Kësulkuqja, përrallë për të rritur"?

A.A: Unë dhe familja ime kemi shpëtuar në mënyrë rastësore. Kishim vendosur të mos iknim nga shtëpia, por ishte xhaxhai që insistonte të na largonte nga aty. Meqë babai im ishte prej vitesh në Gjermani, xhaxhai do ta ketë ndjerë si detyrë ta shpëtojë familjen e vëllait të tij, kështu që këmbëngulte aq shumë sa s'mundëm ta refuzonim. Nga lagja ime deri në Stagovë nuk është ndonjë rrugë e gjatë, rreth tre kilometra. Mirëpo nga aty, të nesërmen në mëngjes, u nisëm për Bllacë, ku arritëm pas mesnate. Ishte një udhëtim nëpër male, therra, përrenj, me devijime të shumta, gjithmonë me frikën se mund të na zinin serbët. Udhës, të këputur nga lodhja, rrëzoheshin të moshuarit dhe fëmijët, disa i merrnin në shpinë, të tjerët i linin aty ku binin. Nga ai varg njerëzish dëgjoheshin vazhdimisht rënkime dhe qarje. Ishte një kalvar që s'mund ta harroj. Vetëm pasi u vendosëm në Shkup dhe, pas ca ditësh, në Tetovë, dëgjuam për vrasjet në lagjen tonë. Atje e morëm edhe lajmin për vrasjen e xhaxhait, i cili na kishte shpëtuar nga vdekja e sigurtë.

E. Gj: Çfarë do të thonit si shkrimtar për shqiptarët e Kosovës?

A.A: Shqiptarët e Kosovës janë janë popull i vogël në një vend të vogël, ndaj të cilit fqinji veri-lindor ka pretendime territoriale. Lufta e fundit, me vrasjet dhe dëbimet, e ka zbritë numrin demografik nga mbi dy milionë, në më pak se një million e gjysmë. Ndërsa, po të mos ndodhte intervenimi i NATO-s, në Kosovë s'do të mbetej asnjë kosovar. Edhe po të mbetej, s'do të guxonte të deklarohej dhe s'do të mund të regjistrohej si i tillë. Do të doja që shqiptarët dhe serbët ta zgjidhnin njëherë e mirë këtë problem dhe të jetonin në paqe me njëri-tjetrin. Duhet zgjuar ndjenja e fajësisë te fqinjët që shkaktuan aq shumë dhunë dhe traumë në Kosovë, dhe duhen zbutur ndjenjat nacionaliste te të dy palët. Krekosjet krijojnë konflikte.

E. Gj: Dhe si përfundim këtë intervistë dua ta mbyll me një pyetje dhe një mesazh njerëzor.

Çfarë është shpresa dhe liria për shkrimtarin? Po për një kosovar?

A.A: Për shkrimtarin, liria është e domosdoshme në të tashmen, ndërsa shpresa motiv dhe ngushëllim për të ardhmen. Kosovari është një njeri që bën qëndresë dhe, në rrethana sado të vështira, shpreson në mbijetesë. Për arsye se i ka munguar aq shumë dhe aq gjatë liria, ai e di rëndësinë e saj.

Me rastin e 80 – vjetorit të lindjes së Nasi Lerës dhe të 60 vjetorit të krijimtarisë së tij letrare

Rreth romanit "Të gjithë premtojnë Parisin"

GJITHËPUSHTETSHMËRIA DHE VLEFSHMËRIA E RRËFIMIT POETIK

Nga Anton Nikë Berisha

Nasi Lera lindi në Korçë më 29 shtator 1944. Është njëri nga prozatorët tanë bashkëkohorë më të shquar. Me një varg përmbledhjesh me tregime, novela dhe romane të botuar, e lartësoi dhe e pasuroi prozën tonë nga rrafshe dhe aspekte të ndryshme. Ai është ndër shkrimtarët tanë të rrallë që di pse shkruan dhe di çka shkruan. Vepra e tij është e lidhur me botën tonë; e shpreh poetikisht këtë botë dhe i kthehet po kësaj bote nëpërmjet artit dhe komunikimit që nxit teksti.

Edhe punimi për romanin "Të gjithë premtojnë Parisin" dëshmon për artin e madh të përftuar nga Nasi Lera. Me art të lartësuar cilësohen edhe romanet e tjerë të tij "Nata e premierës", "Ana Zh", "Të gjallë e të vdekur", "Kishim një ëndërr" etj.



Romani është zhanër që përherë e gjurmon dhe e studion veten dhe i rishqyrton të gjitha trajtat e veta formale.

M. Bahtin

Romani e ndryshon vijimisht formën e vet

Kur e mbaron së lexuari romanin e Nasi Lerës "Të gjithë premtojnë Parisin" dhe synon t'i qasesh e ta interpretosh, atëherë doemos të shkon mendja te natyra e romanit si lloj letrar, te rrjedha e ndryshimit të tij, veçmas te romanit modern.

Është e njohur e dhëna se brenda krijimtarisë letrare në përgjithësi dhe të prozës në veçanti, romani si lloj është ndër më të ndërliqshmit, qoftë për shkak të shumësisë dhe gjerësisë së dukurive që e trajton, qoftë për mënyrat e ndryshme të të shprehurit poetik, të llojshmërisë së stilit, të marrëdhënieve kushtëzuese dhe ndërvarëse të shtresave rrëfimore e të përbërësve të tjerë që bëjnë veprën si tërësinë poetike kuptimore.

Nga aspekti i konceptimit dhe i shtjellimit të tekstit, i krijesës si tërësi shprehëse komunikuese, në rrjedhë të kohëve romani përherë i gjurmoi dhe i pasuroi përbërësit e vet. Për këtë dukuri dëshmon më së miri romani modern, sidomos gjuha poetike që ai përdor[1].

Ndërlikueshmëria e romanit si lloj letrar dëshmohet nga se ai është *kosmopolit për prirjen e tij* (Vigari) dhe cilësohet me të *shprehurit total letrar*, pra është njëri ndër llojet më të hapur dhe më të pakufishëm. Së këndejmi, nëse dëshirojmë ta rimarrim mendimin e Shkllovskit se – atë që e quajnë zhanër, përnjëmend është njësi konfliktesh – atëherë romani është ndër më tipikët. Romani mund të jetë pasqyrë e realitetit, e botës dhe e përvojës së krijuesit, të ketë një objekt të caktuar poetik, të jetë me shumë objekte poetike ose, siç ndodh te romani modern, pa objekt në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale. Me këtë përligjet mendimi se romani synon të jetë shumësi dukuririsht nga jeta, nga bota shpirtërore ose matanë jetës, përfytyruese ose mitike.

Si përligjet kjo te "Të gjithë premtojnë Parisin"?

Romanin "Të gjithë premtojnë Parisin" duhet parë dhe interpretuar në dritën e asaj që u tha më lart, në veçanti me natyrën e romanit modern, gjë që mund të lidhet dhe me mendimin e Floberit, ku theksohet rëndësia e fuqisë së brendshme dhe e stilit të një vepre letrare poetike: "Ajo që më duket e mrekullueshme, që dua të shkruaj, është një farë libri që nuk flet për asgjë, libër që nuk ka asnjë lidhje me realitetin e jashtëm, libër që do të qëndronte vetëm me fuqinë e brendshme të stilit, sikur toka që qëndron pezull dhe nuk e mban asgjë".

Diçka te romani "Të gjithë premtojnë Parisin" ndoshta duhet parë në dritën e ndjenjës së Sanço Panços, shërbëtorit i cili jeton pas zotërisë së tij, Don Kishotit, që i afrohet dukurisë (lexo: rrezikut) që e kishte çuar zotërinë e tij drejt shkatërrimit të pashmangshëm: në procesin e mësimit e të shkrimit të romaneve, Sanço vëren se bota nuk mund të ndërrohet nga jashtë, po nga brenda. Ai jeton si krijues i romaneve për arsye se veprimtarinë e përqendron në *premtim*. Ai sikur thotë: diçka e ngjashme sikur jeta e menduar nuk ekziston, e as që ka qenë ndonjëherë, por nëse e pranoni fiksionin tim, keni pranuar edhe mundësinë që diçka e tillë një herë, në të ardhmen, mund të ndodhë me të vërtetë[2]. Ky qëndrim (përcaktim) të kujton mendimin e Aristotelit për të vërtetën historike dhe të vërtetën e mundshme (poetike)[3].

Kështu, në romanet e mëdha të shekullit njëzet rrëfimi bëhet *e vërtetë,* sikur që e vërteta bëhet *rrëfim.* Me një anë rrëfimi bëhet forcë absolute, të cilës askush nuk mund t'i bëjë ballë, ndërsa po kjo forcë e të folurit s'ka asgjë të përbashkët me realitetin (natyror), që mund të përfshihet në rrëfim[4].

Ndodh kështu nga se romani e ndërton dhe e shpreh realitetin përmes strukturës gjuhësore. Pra, ky realitet ekziston dhe funksionon vetëm brenda shenjave, fjalëve dhe mendimeve që ngërthen teksti. Mirëpo, mënyra se si përftohet dhe shprehet realiteti (sidomos te romani modern) e krijon edhe iluzionin ose bindjen te marrësi se gjithë ajo është e vërtetë.

Në romanin "Të gjithë premtojnë Parisin" thy-hen rregullat e romanit tradicional dhe qasja dhe inter-pretimi i tij si vepër e tillë të shpien në rrugë të gabuar dhe, çka do që të thuash, mbetesh jashtë qenësisë së kësaj krijese poetike. Në të futet natyrshëm diçka nga "tablotë" e jetës së përditshme, nga "modelet" prej të cilave e përditshmja mund të ndërtohet, që në qëllimin e vet të "përfshijë" edhe diçka nga jo e përditshmja, nga përfytyrimi, imagjinata.

Fytyra e kohës – realitet i përmbysur

Nisur nga fakti se "Të gjithë premtojnë Parisin" është roman modern, atëherë del e paarsyeshme të kërkosh në të përcaktimin e mirëfilltë të objektit poetik, të një ideje ose dukurie kryesore nga se ato në të janë të shumta e të ndryshme dhe nuk i nënshtrohen hierarkisë as rrafshit të vlerës e të peshës së tyre. Secila është e rëndësishme dhe të gjitha së bashku bëjnë atë që te romani tradicional mund të bëjë ideja kryesore ose personazhi kryesor. Tërë ajo që rrëfehet në këtë roman ka si qëllim që ta shprehë e ta përligjë fytyrën e kohës, domethënë kohën, rrethanat dhe gjendjen (botën) shpirtërore të njerëzve. Është e vërtetë se, fjala vjen, personazhet e Evës F. dhe të Simonit janë mjaft të pranishëm në roman, po edhe personazhet e tjerë, Vesa Destani, Eni D. ose kamerieri, Ardi, ose dhe vetë deti (shiu po se po, për këtë do të behet fjalë veçmas) janë po aq të rëndësishëm, jo për praninë dhe hapësirën që zënë dhe kanë në roman, po për kuptimësitë që ngërthejnë dhe për funksionin që kanë në vepër. Kështu, fjala vjen, "historia" e Ardit dhe akuza e pabazë dhe dënimi i tij, nuk zë shumë vend në roman, po është po aq e rëndësishme sa vetë "historia" e dashurisë së Simonit me Evën F. Njëjtë ndodh dhe me dukuritë e "vogla" si, fjala vjen, me ankandin publik të qenve, me paraqitjen e librit në Sheraton dhe me praninë aty të udhëheqjes së shtetit etj.

Çështja kryesore për autorin, Nasi Lerën, është të shqiptojë një varg dukurish të ndryshme që e shprehin në mënyrë të thellë e të shumanshme fytyrën e kohës, përbërësit që e dallojnë atë dhe lexuesi mund e duhet të vihet në komunikim me të dhe ta njohë atë sa më mirëfilli: ta përfillë, ta prapësojë ose t'i përjetojë njësoj të dyja.

Duhet thënë se *fytyra e kohës* në romanin "Të gjithë premtojnë Parisin" nuk shqiptohet si dukuri e thjeshtë, njëpërmasore, një rrafshore dhe njëdrejtimore, po është e ndërliqshme, shumëkuptimore dhe shumëkahore. Ky degëzim është i qëllimtë dhe shprehet përmes një teksti poetik të lartësuar, shprehet përmes artit, siç mund të përligjet nga fjalët e Simonin, ku vajza, Eva, është vetë fytyra e kohës po dhe kundërvënie e saj: "[...] zhdukja e fytyrës së asaj vajze ishte për mua zhdukja e vetë fytyrës së kohës. Asnjëherë nuk e kisha kërkuar, si po e kërkoja atë mëngjes, fytyrën e kohës sime [...] Ajo hyri në lokalin ku pinim çdo mëngjes kafe, sepse iu tremb shiut, sikur ai do t'i zbulonte fytyrën e vërtetë. Po ajo ishte një fytyrë e bukur dhe në ndryshim nga koha, që nuk e fsheh fytyrën e bukur, donte që ne të mos e shihnim".

Eva F. mundëson njohjen e vetëm një pjese, një këndvështrimi të fytyrës së kohës: "Befas ajo vajzë nuk ishte gjë tjetër veçse koha që përpiqej të fshihte fytyrën e saj. Dhe koha kullonte nga flokët e saj shiun e fundit të vjeshtës dhe shiun e parë të dimrit. Edhe koha është përpjekur gjithmonë të fshehë fytyrën e saj. Kur e zbulon sheh se nuk ka fytyrë më të frikshme, më tragjike, më cinike, më hipokrite, më mediokre se fytyra e kohës me të cilën ke jetuar si mes një makthi. Ishte hera e parë që po më buisnin mendime të tilla, që i zhvlerësuan në çast të gjitha tregimet dhe novelat që kisha shkruar deri atëherë".

Nuk janë vetëm personazhet dhe rrethanat shoqërore, veprimet e ndryshme konkrete që shprehin kohën që shqiptohet në vepër. Janë edhe dukuritë natyrore. Pra, format e përligjjes së fytyrës së kohës shprehen edhe përmes shiut: "[...] aty ishin të gjithë si brenda një strehimi, ku ishin strukur për t'i shpëtuar jo shiut, por kërcënimit të kohës, që kishte formën e shiut"[5]. Këtë e shpreh dhe rënkimi i detit që, simbolikisht, bëhet pjesë e fytyrës së kohës: "Atë natë nuk kishte njeri në hotel. Ishte kulmi i dimrit. Rënkimi vinte nga Perëndimi. U çova nga shtrati dhe shkova dhe hapa dritaren. Në trup m'u përplas nata me të ftohtit e saj të hidhur e tërë lagështi. Qielli ishte gjithë yje. Më në fund e kuptova se rënkimin e lëshonte deti. Më erdhi keq për detin. Rënkimi që përhapte nëpër natë ishte vetë ulërima dhe rënkimi i vetmisë sime" ose "[...] dhe ajo kishte një fytyrë të bukur që fshihte një dhimbje të thellë".

Pikërisht fytyra e kohës konkrete, gjithë ajo që zien brenda saj dhe pasojat që shprehen në marrëdhëniet shoqërore dhe në shpirtin e njerëzve, kushtëzojnë që Simoni të mos ia dalë ta shkruajë romanin e tij.

Shiu – simbol i shqetësimit dhe i pësimit

Brenda veçantive të tekstit poetik e të figurshmërisë së pasur që e cilëson romanin "Të gjithë premtojnë Parisin" simbolika e shiut shtrihet në gjerësi dhe në thellësi. Të thuash s'ka ndonjë veprim të rëndësishëm të personazheve dhe të pësimit të tyre ose përsiatje të autorit që nuk lidhet ose nuk përshkohet nga rënia e shiut dhe simbolika e tij.

Fjalia e parë e këtij romani fillon me shi: "Ajo nuk priste të na shihte në lokalin e vogël, ku mblidheshim çdo mëngjes për të pirë kafe, prandaj kur ia ngulëm sytë, u hutua aq shumë, sa u kthye përsëri nga dera dhe sikur shiu të mos ishte bërë papritmas i rrëmbyeshëm, do të ishte larguar menjëherë [...] ajo iu tremb shiut më shumë se pranisë sonë". Në faqen e parë të romanit shiu është jo vetëm i pranishëm, po përligj pjesërisht edhe rëndësinë e simbolikës që ka në gjithë veprën: "Brenda atij poçi të djegur përpëlitej jo vetëm shkretia që kishte mbuluar plazhin, por edhe fundi i vjeshtës. Edhe shiu, që përplasej pas qelqeve të lokalit, nuk ishte aspak si shirat që kishin rënë deri atëherë, që shfaqeshin zakonisht në perëndim, derdheshin në det dhe pjesën e mbetur retë e shkarkonin mbi bregun e shkretë [...] shiu i sotëm nuk dihej sa do të vazhdonte, sepse kishte ardhur nga veriu dhe ishte i ftohtë".

Një çast shumëfish i rëndësishëm për

1 Shih rreth natyrës së romanit si lloj letrar dhe veçantive të tij dy punimet e mi *Romani – zhanër pa kanone,* f. 139 - 142 dhe *Romani tradicional dhe romani modern,* f. 143 – 155. Në veprën time "*Çështje teorike të letërsisë".* Faik Konica, Prishtinë 2005.

2 Shih punimin tim Romani tradicional dhe romani modern. Në veprën time "Çështje teorike të letërsisë". Faik Konica, Prishtinë 2005, f. 146 – 147.

3 Shih më gjerësisht në studimin tim Vëzhgime mbi "Poetikën" e Aristotelit.. Faik Konica, Prishtinë 2018 dhe Aristoteli, Qasje artit poetik. Përkthimin, studimin hyrës dhe shënimet Anton Nikë Berisha. Argeta LMG, Tiranë 2020.

4 Shih punimin tim të përmendur Romani tradicional dhe romani modern, f. 149.

5 Kjo të kujton mbylljen në shpellë të personazheve të romanit "Karvani i bardhë" të Azem Shkrelit. Shih më gjerësisht studimin tim Poetika e fjalëve të gurta. Qasje veprës letrare të Azem Shkrelit. "Argeta – LMG", Tiranë 2011.

nismën dhe rrjedhën e romanit "Të gjithë premtojnë Parisin" lidhet, po ashtu, me shiun, kur Eva F. hyn një kafene: "U bëra gati ta fajësoj edhe shiun për dështimin tim, kur thashë me vete, se po të mos binte shiu, ajo nuk do të hynte në lokalin tonë, ku pinim zakonisht kafen e mëngjesit".

Edhe në fjalinë e parë të romanit, që shkrimtari, Simoni, mendon ta shkruajë, është i pranishëm shiu: "Ajo hyri në lokalin tonë dhe nuk e dinte se shiu që pikoi nga flokët e saj ishte shiu i fundit i vjeshtës dhe shiu i parë i dimrit..."

Simbolika e shiut degëzohet dhe përligjet në mënyra, në forma dhe në rrjedha të ndryshme të tekstit; është ose paralajmërim i ndonjë drame që do të ndodhë ose shënon dramën që ndodh, qoftë kur bëhet fjalë për dukuri të caktuara, qoftë për atë që përjetojnë dhe pësojnë personazhet në jetë dhe në botën ebrendshme. Kështu, që në fillim të romanit, shqiptohet simbolika dhe metaforike e njësimit të fatit të njerëzve me shiun, që secili e ka brenda tij dhe që, në vend që të dalë jashtë, derdhet brenda qenies: "[...] na kishte shqetësuar (vajza që hyn në lokal – v. ime), duke u frikësuar nga gjëmimi shurdhues dhe atë çast pashë se pikoi nga maja e flokëve të saj dhe pika e fundit e shiut. Ne u përpoqëm t'i buzëqeshim, ndërkohë që ajo pikë shiu futi në lokal një shi tjetër, që filloi të bjerë pa zhurmë në kujtesën tonë, sepse isha i sigurt që secili prej nesh e kishte në jetën e tij një shi të largët që pikonte nga flokët edhe më të largët".

Simbolika e shiut përdoret edhe kur shqiptohet ndërrimi i stinëve: "Vjeshta nuk kishte më forcë të shfaqej dhe ishte tërhequr e drobitur, për t'ua lëshuar vendin shirave të ftohtë të dimrit. Mbi breg ranë hijet e rënda të muzgjeve dimërore, ndërsa thellë, atje ku ndodhej vija e horizontit, u shfaq dhe u shua në një të qindtën e sekondës, shkreptima e parë dhe mbi sipërfaqen e detit, era që frynte nga veriu, formoi mornicat e para".

Shiu bëhet shenjëzim dhe i bukurisë dhe i prehjes së personazheve, siç ngjet me Simonin dhe Vesa Destanin: "Të dy ishin të çliruar dhe nata ishte e bukur dhe shiu ishte i bukur dhe deti që nuk shihej duhej të ishte i bukur dhe avulli që mbështillte trupin e Eni D. ishte i bukur dhe flokët e Vesa Destanit ishin të bukur dhe gjithçka kishte ndodhur ishte e bukur, përveç asaj që i kishte ndodhur Eni D. Sepse asaj i kishte ndodhur diçka tronditëse".

Autori e shfrytëzon shiun edhe për të shprehur bukurinë e femrës, Evës, siç ndodh kur ajo hyn në pijetore: "Ajo hyri në lokal dhe ishte aq e bukur sa e bëri të tillë edhe shiun e ftohtë dhe të mërzitshëm që binte jashtë".

Shiu simbolizon edhe njësimin me kënaqësinë shpirtërore të personazhit: "Dola nga dhoma (Eni D. v. ime) dhe u lehtësova kur shiu më rrahu fytyrën. Kisha nevojë për atë shi".

Mirëpo, shiu nënkupton, po ashtu, frikën dhe pësimin: "Vajza nuk dinte ç'të bënte. Po të largohej nën shi, tërë faji është i yti, qortova veten. Ajo të ka parë të dehur dhe është trembur. Vajza qëndronte midis frikës nga një i dehur, që isha unë, dhe frikës së shiut, që ishte vetë shiu" ose "Asnjëri nuk guxonte të pyeste se kur filloi shiu. Rrinin zgjuar dhe mbanin vesh si ai binte shtruar. Simoni ishte i sigurt se shiu nuk kishte rënë gjithmonë ashtu, shtruar, si po e dëgjonte tani. Atij i kujtohej se shiu kishte ardhur nga deti tërë zhurma ere dhe degët e pishave të buta kishin ulëritur si të jetonin natën e tyre të fundit".

Në kreun e fundit të romanit (kreu 41) shiu zëvendësohet me dëborën (borën), e cila bëhet pjesë e veprimit dhe e frymëmarrjes: "Dëbora kërciste nën hapat e tyre dhe dielli, që kishte shpërndarë retë, të verbonte duke u përshëkënditur në miliarda kristale të kaltra, si të ishin situr tërë diamantet e qiellit. Çatitë heshtnin nën shtresën e trashë të dëborës dhe shtëpitë, shumica të mbyllura, të fusnin në mendime ndjenjën e vetmisë dhe të shuanin çdo dëshirë për të folur".

Dëbora shpreh edhe pësimin dhe tragjiken që ndodhin për shkak të saj: "[...] dhe gjithçka ndodhi për faj të dëborës".

Qenësia e dashurisë: Nisja drejt vetvetes

Brenda fytyrës së kohës, siç thuhet në romanin "Të gjithë premtojnë Parisin" ose brenda kohës që *Kishte koha ethe, kishte koka frymë,* siç do të thoshte shkrimtari, Azem Shkreli, ose *kohë e vrarë në sy,* siç thotë shkrimtari, Visar Zhiti, vetë njerëzit dhe dukuritë mbajnë ngjyrimin dhe frymën e saj. Tek e fundit, kohën e bëjnë njerëzit, rrethanat, kushtet që i krijojnë ata. Koha në vetvete dhe për vetveten s'ka rëndësi.

Fytyrën e kohës që shqiptohet në roman Nasi Lera synon ta shprehë edhe përmes dashurisë. Fytyrës së kohës së tillë, përkatësisht kërcënimit të saj ia kundërvë dashurinë dhe artin, si dy forma të rëndësishme, po të mundshme për përballim dhe ngadhënjim mbi të.

Vepron kështu për arsye se përmes dashurisë koha shpaloset mirëfilli, shprehen përbërësit e saj më thelbësorë e më të ndieshëm. Kështu, në projektin *reality show* "Kështjellari" dashuria i përligj rrethanat dhe frymëmarrjen e mirëfilltë të gjallimit, gjendjen shpirtërore të njerëzve. Dashuria midis Evës dhe Simonit dëshmon të kundërtën. Në thellësinë e saj ajo i kundërvihet realitetit të tillë që është zhveshur nga virtytet, nga dinjiteti dhe mirësia. Mirëpo, autori Lera këtë nuk e thotë, nuk e pohin, po gjithë kjo del nga thellësia e rrëfimit poetik për dashurinë e tyre. Eva F. është edhe fytyra e kohës, po në një çast ajo vetëdijesohet dhe bëhet fytyra e vetvetes. Ajo niset drejt Simonit, po në të vërtetë niset drejt vetvetes, siç ndodh dhe me të dashuruarit e *Këngës së këngëve*[6] të *Biblës së Vjetër.* Në këtë krijesë poetike të dashuruarit ballafaqohen me veten e me tjetrin, siç thekson dhe Christos Yannaras: "Tjetri bëhet 'kuptimësia', përgjigja e ndjeshme e dëshirës më të thellë e jetike të natyrës sonë. Ndoshta nuk jemi dashuruar në personin e Tjetrit, po në etjen tonë të mishëruar në personin e tij[7]". Së këndejmi, dashuria barazohet me vetë jetën: "Tjetri përbën mundësinë e vetme për arsye se marrëdhënia jonë me botën është e ndërsjellë. Tjetri është fytyra e botës, logosi i secilës qenësi objektive. Logosi që më drejtohet mua dhe më fton në universalen e bashkë-ekzistimit[8]".

Në *Këngën e këngëve* e dashura jeton brenda të dashurit, siç i dashuri jeton brenda saj. Shprehja hebraike "Ləki lak" shpreh pikërisht "Nisjen drejt vetvetes" (Shih dhe Zan 12, 1). Qëllimi i të dashurit nuk është ta bëjë atë (të dashurën) të veten, po ta lirojë, t'i ofrojë gjithë zjarrin e dashurisë absolute[9]. Edhe kur ata nuk janë afër njëri – tjetrit, ajo është krejtësisht e tij dhe anasjelltas:

I dashuri im është i imi e unë jam e tij
ai kullot midis zambakëve. (2, 16)

Dashuria e Evës me Simonin synon të jetë e pakushtëzuar, po rrethanat dhe kushtet e jetës konkrete bëhen pengesë, ia zënë frymën dhe në fund ajo (dashuria), bashkë me ta, shkatërrohen nga të tjerët, që janë fytyra e njëmendtë e kohës për të cilën rrëfehet në roman.

Romani – dëshmi e artit të madh

Ajo që e bën romanin "Të gjithë premtojnë Parisin" të rëndësishëm, për shumëçka të papërsëritshëm brenda prozës sonë, është mënyra e ndërtimit të tekstit poetik, është rrëfimi poetik i lartësuar nga fillimi në fund. Pra, të shprehurit poetik, përkatësisht përmasa artistike që e cilëson tekstin e këtij romani, paraqet vlerën kryesore të tij. Gjithçka tjetër është e dorës së dytë: shqiptimi i realitetit të përmbysur e të dhunshëm, paradokset shoqërore, vetëdija e fjetur, bota e brendshme e personazheve, pësimet dhe fatkeqësitë.

Nasi Lera nuk pohon, nuk e përdor të shprehurit retorik, nuk klith, nuk akuzon pandërmjetësisht, nuk shpreh as pezëm e as urrejtje, as ndaj personazheve dhe veprimeve që dëshmojnë zhvlerësimin shpirtëror, që janë të ligj. Ai gjithçka e shpreh përmes një gjuhe poetike sa të veçantë aq dhe të pasur; i vë përballë faktet e të dhënat, karakteret, rrjedhat dhe veprimet e ndryshme të personazheve dhe gjithçka ia lë lexuesit; atij i mbetet të vlerësojë vetë, të përcaktojë se çka është e mirë ose e keqe, ose as e mirë e as e keqe; çka duhet të vihet në peshojën e dyshimit e të ndërgjegjes ose pse duhet ta pranojë ose t'i kundërvihet.

Rrëfimi i Nasi Lerës në këtë roman, siç ndodh dhe në romanet e tjerë të tij, nuk është i shpifur, po i lirë dhe i çliruar; autori është i sigurt në atë që e rrëfen; nuk i fsheh gjërat as nuk e i zbukuron ato; asgjë nuk paragjykohet e as nuk të detyron.

Brenda këtij koncepti, gjërat dhe dukuritë nuk shqiptohen sipas hierarkisë ose rëndësisë së tyre. Ato kanë vlerë të barabartë. Kështu, burgosja e Ardit, vendosja e Evës F. në vilen e një bosi dhe "shndërrimi" i saj pronë e tij (edhe në telefon duhet t'i përgjigjet bosit pa u vonuar), prania në Sheraton e njerëzve më të lartë të pushtetit, shikimi me përbuzje i Evës nga të tjerët, pastaj, në fund, dhuna dhe pësimi i Simonit dhe i Evës dhe ndërprerja e dashurisë së tyre, kanë të njëjtin status dhe vlerë dhe nuk synojnë ngritjen mbi tjetrën. Secila nga dukuritë e përmendura i ka veçantitë dhe dramën e vet. Për dikë njëra dramë heq më shumë peshë, për një tjetër, tjetra.

As rëndësia dhe vlera e dukurive dhe e përbërësve të botës së brendshme (të personazheve) nuk përligjet nga prania e gjatë ose e shkurtër në tekstin e romanit ose nga rastësia, po nga shtresimi dhe mbishtresimi kuptimor që kanë dhe marrin brenda strukturës gjuhësore shprehëse dhe barten te secili lexues, sipas natyrës që ka, njohjes së artit të fjalës dhe shpirtit të tij.

Teksti i romanit "Të gjithë premtojnë Parisin" dëshmon për shtjellim e për të shprehurit modern dhe për artin e madh që e cilëson. Në tekst zbatohet një sistem sa i veçantë aq dhe i pasur, sidomos i të shprehurit metaforik.

Nga llojshmëria e shqiptimit të tillë bindesh se qëllimi i autorit ishte arti, hartimi i një krijese letrare sa më të lartësuar poetikisht.

Pra, në tekstin e romanit mbisundon rrëfimi poetik i menduar dhe i përftuar me përkushtim e dije, ku përligjet mirëfilli gjithëpushtetshmëria dhe vlefshmëria e tij.

Brenda kësaj duhet përmendur mënyrat e shumta e të ndryshme të përftimit të pamjeve poetikisht të rralla, që shkrihen natyrshëm në kuptimësitë që dalin nga teksti; shmangien e përsëritjeve e të modeleve të caktuara, ku krijohet sistemi i mozaikëve poetikë të pasur që nuk i gjen tek prozatorët tanë të sotëm.

Nasi Lera dëshmohet mjeshtër i kapjes dhe i shqiptimit të çasteve të veçanta, nga të cilët dalin e degëzohen kuptimësi të shumta; imtësi që nxitin përsiatje dhe meditime të thuash të pafund, pra te lexuesi shndërrohen në "dukuri" të mëdha e të rëndësishme. Veti e shkrimtarëve të mëdhenj.

Fjalia e tij është e menduar dhe kuptimisht shumësore; e cilëson drejtpeshimi; metaforat, krahasimet dhe figurat e tjera në këtë roman janë të rrafshit të lartë dhe me shumicë. Këtë rrafsh dhe harmoni ndonjëherë e lëkundin rastet kur fjalia fillon me *sepse*, me *por* dhe me *prandaj*, ose ndonjë përsëritje e fjalës brenda një fraze.

Të sjellësh vetëm një pjesë që dëshmojnë

(Vijon në faqen 7)

6 Shih për Këngën e këngëve studimin tim Kënga e këngëve – kryevepër poetike e dashurisë dhe e jetës. Me përkthim të ri të tekstit. "Faik Konica", Prishtinë 2015.

7 Christos Yannaras, Variazioni sul Cantico dei Cantici. Edizione Qiqajon. Comunità di Bose. Magnano (BI) 2012, f. 8.

8 Christos Yannaras, Po aty, f. 9.

9 Po aty, f. 119.

Publicistika e Ernest Koliqit si fitore e historisë së tij intelektuale

Nga Ardian Ndreca

Sapo doli nga shtypi përmbledhja publicistike e Ernest Koliqit me titull "Drita e Shêjzave. Publicistikë 1957-1974". Libri është kujdesuar nga editori i revistës Shêjzat, Ardian Ndreca, dhe është botuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët e cila drejtohet nga Diana Kastrati. Botojmë këtu parathanjën e vëllimit që mban firmën e editorit të Shêjzave.

Jeta e Ernest Koliqit në mërgim asht nji digresion që krijon hapsina lirie për me komunikue me mbasardhësit. Shkrimtar i parakohshëm për atmosferën kulturore të rinisë së tij, ai e ruejti këtë dimension deri në fazën e fundit të krijimtarisë së tij, mbasi siç e tregon edhe kjo përmbledhje, kemi të bajmë me *soliloquia* ma fort se me dialogje me bashkëkohësit e tij.

Publicistika e Koliqit, e këtu skaji përdoret në nji sens të gjanë, asht edhe prozë poetike edhe *elzevir* ku ndihen jonet e nji shpirti të bukur e dora e nji argjendari të gjuhës shqipe, urtësia e poetit dhe poezia e të urtit.

Shkrimi i tij, në të gjithë regjistrat që ai ka përdorë, ka privilegjin e madh të lirisë, forcën e mendimit dhe delikatesën e ndjenjave.

Leximi i kësaj përmbledhje të jep ndjesinë nji dige që ka tubue emocione, kujtime, keqardhje dhe herë mbas here portat e saja hapen për me ujitë fushat e djerra të diasporës antikomuniste. Këto editoriale, "mendime të zhgarravituna" siç i quen ai, janë ideogramet e fundit nëpërmjet të cilave bahen të kuptueshme idealet e Rilindjes kombtare.

Mërgata antikomuniste asokohe ishte nji masë heterogjene, ku gjeje intelektualë e zotni të mirëfilltë, të lodhun e të hutuem, por edhe nji mori *enfants gâtés* djerraditës të pakuptimtë, pinjoj të familjeve të pasuna që Shqipnisë nuk i kishin vjeftë kurrgja, shihje njerëz të vorfën në xhep e në tru, hujlí, spijuna e mujshar, por s'gjen kurrsesi nji rrymë homogjene e serioze që mund të krijonte idealisht nji alternativë serioze për nji nesërme të atdheut.

Koliqi e kishte kuptue me kohë këtë gja e prandaj tenton tri rrugë të reja: me aktivizue të rinjt e talentuem, me tërheqë idealisht intelektualët e Kosovës dhe me plazmue botën arbëreshe tue e nxjerrë prej ekzotizmit e tue e drejtue kah moderniteti si dimension shpirtnor dhe urban.

Me aktivitetin e tij si themelues i *Shêjzave*, si shkrimtar, përkthyes, pedagog dhe politikan, mendojmë se Koliqi ia ka arritë disi të trija këtyne objektivave.

Ankthi me komunikue ia rritë tensionin fjalës së tij tue alternue emocionet stenike e ato astenike, shpresën dhe dëshpërimin. Tëhuajzimi i jep shkas me folë, me reague, idhnimi i hapë horizontin dhe i jep tone profetike shkrimit të tij.

Në fundin e viteve '50 klima mendore e emigracionit antikomunist kishte sintetizue tashma idenë se kthimi në atdhe s'ishte i afërt. Të ikunit ndërkaq kishin mësue abetaren e travajëve të ekzistencës, simbas asaj profecisë danteske:

> Ti do provosh sa ka përmbrenda krypë
> buka e huej, sa shtegu asht i vështirë
> n'shkallë të hueja me hypë edhe me
> zdrypë. (*Parajsa*, XVII, 58-60, përkth. P. Gjeçi)

Por edhe ata që e kishin sigurue jetesën nuk e kapërdinin të qetë kafshatën tue mendue të afërmit e tyne në kampe përqëndrimi, në burgje apo thjesht në atë burgun e madh që ishte Shqipnia asokohe. Koliqi përthithë me kureshtje çdo lajm që i vjen prej atdheut, lexon gazeta e libra, ndjekë për aq sa mundet propagandën komuniste dhe vëren sesi regjimi krenohet pse në pak vite ka mbërrijtë me e modernizue vorfninë, me krijue nji *tabula rasa* ku ka zanë fillë nji epokë e re që nuk e njeh veten si projektim të së kaluemes por thjesht si nji shpikje shkencore, parametrat e së cilës duhet me i vu në jetë me dhunë.

Koliqi në atdhe urrehet si fashist, por urrehet edhe në diasporë si ish fashist. Nuk shkon dot në Kosovën e tij të dashun, pse edhe atje konsiderohet si kriminel lufte prej regjimit të Beogradit, mbasi dikur, kur ishte Ministër Arsimi, ka dërgue atje nji numër të konsiderueshëm arsimtarësh.

I kanë mbetë vetëm arbëreshët, nji realitet i ruejtun prej mbylljes por i rrezikuem prej kohnave të reja që po shfaqeshin në horizont. Koliqi shkon deri në SHBA tue gjurmue arbëreshet e ikun në fillimet e '900, tue mbledhë folklor e visare shpirtnore, tashma të shenjueme me u zhdukë përgjithmonë.

Vetëm dimensioni i kujtesës e kthen në Shkodrën e rinisë apo tek Tirana e viteve '30-'40, tashma sytë e tij janë ngulë tek "gjaku ynë i shprishun". Prej nji dimensioni tragjik me plagë të hapuna që kullojnë gjak ai kalon tek nji tragjizëm i qetë që e lejon me jetue dyfish të tashmen tue qenë njikohsisht pjesë e së kaluemes.

Mësimdhanja në Universitetin e Romës dhe politika nuk mjaftojnë. Koliqi ka nevojë edhe për hapsina të tjera, prandaj ai rindërton – përreth *Shêjzave* – në mënyrë plastike shpirtin si entitet të epërm nëpërmjet artit figurativ të Lin Delisë, erotikes dhe sakrales të mbrujtuna në episode që të çojnë drejt e në atdhe. Nga ana tjetër kundron me interesë dhe dashamirësi horizontet sintetike të Ibrahim Kodrës, ku drita artificiale izolon format gjeometrike dhe u jep atyne dinjitet artistik.

Afron tek *Shêjzat* talente të reja si Prenk Ndrevashaj apo Anesti Andrea, inkurajon intelektin skofiar të Fehime Pipës apo entuziazmin poetant të Nermin Falaschi Vlorës. Afron edhe të tjerë që ma vonë kanë tretë rrugë.

Gjatë rrugtimin të tij Koliqi ka humbë dhe ka gjetë shokë me të cilët ka nda çaste të bukura e të dhimbshme. Gjithçka që ai trajton ka mbrendë nji *pietas* që dëbon çdo lloj urrejtjet, edhe ndaj *kuqalashave*, siç i quen ai komunistat, atyne që e lanë pa atdhe.

E çka mund të bajnë nji shkrimtar pa atdhe? Në vendet e tjera të Lindjes komuniste për me e shkallmue shpirtin e nji artisti mjaftoheshin me e dëbue prej atdheut, pse e dinin se kështu i thaheshin lozet, tek ne i vrisnin për mos i lanë as me shpresue tek liria.

Për Ernest Koliqin, por edhe për Martin Camajn e shumë të tjerë, ndamja prej atdheut ishte dënimi ma i madh dhe kërcënimi ma serioz për shpirtin e tyne krijues. Xhelatët shpirtmalcuem të Tiranës s'kishin si ta njihnin Ovidit për me e kuptue të keqen që kishin ba, prandaj s'hiqnin dorë nga shpresa e aktit supererogator të nji breshnie plumbash në krahnor, a thue se nji çast vuejtje mund të barazohet me dekada të tana vetmi e lodhje shpirtnore!

Nostalgjia asht timbri që karakterizon gjithë krijimtarinë e Ernest Koliqit në mërgim. Mjeku zviceran Johannes Hofer në shekullin XVII e kishte diagnostikue nostalgjinë si nji sëmundje neurologjike të trupave mercenare zvicerane që luftonin larg atdheut të tyne: "Heimweh" ka mbrendë dhimbjen therëse për shtëpinë, për rranjët dhe vendin ku njeriu ka pa për herë të parë dritën e diellit.

Ajo dhimbje e shoqnoi gjithë jetën Ernest Koliqin në mërgim, prandaj dera e shtëpisë së tij – falë edhe bashkëshortes bujare, Vangjelisë, ishte e hapun natë e ditë për çdo shqiptar, verior apo jugor, pa dallim feje apo fryme politike. E ai shëndohej tue ndie tue folë malsorë e katundarë, qytetarë, të shkolluem e të pashkolluem, pse kishte etje për atmen e tij.

Me këtë përmbledhje Ernest Koliqi rikthehet në atdhe me të vërtetat e tija, prej të cilave ende kanë frikë pinjojt e gënjeshtrës së madhe, ata që bajnë sikur e duen Koliqin por thellë thellë e urrejnë. Komunizmi nuk asht vetëm dhunë, ma së parit asht klimë, po ajo klimë që i ka mbijetue deri sot dhunës së djeshme dhe trajton me nji respekt kallp Ernest Koliqin, Lasgushin, Gjergj Fishtën, Mit'hat Frashërin.

Kemi në dorë thuejse dy dekada shkrime ku ikja prej atdheut e ka afrue shkrimtarin me vendin e tij; urrejtja me të cilën ai asht rrethue asht kthye në kurë ndaj njerzve të fisit, siç i quen ai bashkëkombësit. E keqja e shqiptarëve tek Koliqi identifikohet me ideologjinë që ka kaplue mendjet dhe jo me njerëz të veçantë.

Vitet e fundit janë të trishtueshme, vdekja e bashkëshortes së dashun, largimi nga jeta i shumë miqve dhe vetmia që e rrethon i peshojnë. Kanë mbetë drekat me miqtë e tij të ngushtë shkodranë, mbramjet tue ndigjue muzikë klasikë në shoqninë e të birin, paraditet tue punue me ndonji doktorand apo bashkëpuntor të *Shêjzave*, takimet me miq të ardhun prej përtej oqeanit apo me funksionarë amerikanë, italianë, bisedat me intelektualë të mërguem prej vendeve të Lindjes komuniste, por sidomos mbasditet në lutje në kishën e Shën Piut X në Balduina.

E ardhmja e dikurshme tashma ka mbërrijtë por shikimi i tij asht ba opak, për vete nuk ka ma shpresë se kthehet në shtëpinë e tij, për të tjerët po.

Me të në mërgim mbyllet nji epokë e tanë. Në atdhe prej kolegëve që vlejnë të brezit të tij ka mbetë gjallë vetëm Lasgushi, por edhe ky rezulton në jetë vetëm për evidencat e gjendjes civile.

Koliqi len mbas vetes visarin e *Shêjzave*, sidomos këto shkrime ku ndihet afshi gjakues dhe tonet e kërthëndezëta e mbi të gjitha, kundër çdo arsyeje logjike, ndihet i pastër nji kumt ndjellamirë, pse për atdheun tand nuk mund ta mendojsh kurrë të zezën si gjendje të përhershme. Poeti rus Osip Mandelshtam në nji poezi të tijën thotë se ka mësue "shkencën e lamtumirave". Kjo asht shkencë e pazakontë poetësh e nuk ka nji metodë të veten por ushqehet me aktet e pastra të shpirtit e si të tilla duhen trajtue edhe këto shkrime të Ernest Koliqit, ushtrime për shkencën e lamtumirës prej atdheut të tij.

(Vijon nga faqja 5)

veçantitë dhe pasurinë e tekstit poetik të këtij romani do të duhej shumë vend. Po sjell disa që mjaftojnë për të fituar idenë e artit të madh dhe mundësinë e ndikimit estetik që teksti mund të bëjë në marrësin.

*

Ishte hera e dytë që ajo largohej si një ëndërr e shqetësuar, duke lënë pas një hije të mjegullt trishtimi.

*

Edhe vetë qenia e saj nuk ishte gjë tjetër veçse një shkrirje e dhimbshme e fundit të vjeshtës dhe e fillimit të dimrit.

*

Nata kishte filluar brenda saj.

*

Plazhi ishte i shkretë, kurse deti ishte i thinjur. Asnjë siluetë njerëzore nuk dukej sa të hanin sytë. Shiu binte i heshtur si të sitej në dritën e mugët. Heshtja që shtrihej e lodhur pas gjëmimeve dhe rrebeshit, të fuste në mendime trishtimin e stinës që po fillonte. Ishte një trishtim që të ngjitej dhe nuk të shqitej si një mjegull e ftohtë

*

Ai zë kishte për mua butësinë e reve puplore pas shiut.

*

Unë iu trembesha syve të saj. Ata vlonin nga një vullkan i brendshëm për të sunduar mbi çdo gjë.

*

Kishim kaluar një mbrëmje shumë të bukur dhe duke thithur erën dehëse të flokëve të Vesa Destanit, thitha dhe gjithë aromat e asaj nate. Ne ishim pjesë e saj, pjesë e shiut që filloi të trokasë mbi dritare dhe kur e largova pak nga vetja, që ta shihja në sy, ajo nuk kishte asnjë lloj frike. Një shkreptimë e fuqishme, e pasuar nga një gjëmim edhe më i fuqishëm, drodhi qelqet. Nata kishte shkrepur blicin e saj për ta përjetësuar në kujtesën e vet...

*

[...] Valixhja me rrota kaloi para meje, se pse m'u duk sikur po tërhiqte një arkivol. U trondita, sepse vegimi i arkivolit nuk m'u shqit edhe kur nisi të binte shi. Brenda valixhes dergjeshin ditët e fundit me diell të vjeshtës.

*

Sa këmbë të bukura që paske. Vithet e kërcyera, si dy maja kodrash dhe shpatullat e gjera mbi të cilat prehej perëndimi i përflakur i reve të floknajës së saj, më turbulluan më shumë se fërneti që kisha pirë. Ajo qëndronte si një statujë e nxjerrë nga viset ku nuk binte shi.

*

Ajo shkoi drejt çelësit, e hapi dhe kur u ndezën të gjitha dritat u kthye nga unë, e bukur [...] Ashtu si derdhen në vjeshtë të gjitha ngjyrat e pyjeve të përzierë, ashtu derdheshin prej saj hiret e moshës.

*

Gjoksi, si të mos duronte dot prangat e një trikoje të hollë, të hapur para, u tund kur më kaloi para si një ninullë e vjetër.

*

Qielli ishte i kaltër, kurse deti kishte dallgë të vogla. Ato vinin njëra pas tjetrës si një buzëqeshje tërë dritë. Më pushtoi dëshira të dilja dhe të futesha mes tyre. Gëzimi i tyre do të më përfshinte edhe mua. E doja detin, megjithëse ai sa nuk më mashtroi atë muzg...

*

Në flokë më kishin mbetur disa fije bari. I hoqa [...] edhe pse doja t'i merrja me vete, si të ishin reliktet e një muzgu të vdekur.

*

Ngjyra e artë që merrte mbarë horizonti, mbasi perëndonte dielli, sikur ma afronte edhe më shumë detin dhe, megjithëse nuk ia dëgjoja zhaurimën që përhapnin gurët e vegjël dhe të bardhë në breg, kur uji tërhiqej, ndjehesha e spërkatur nga stërkalat, si të ishin grimcat e yllit të fundit që ishte shuar miliona vite më parë.

*

Dora e saj u lëkund para syve të tij si një degë e njomë, ku gota u duk si një fole e zhveshur, e braktisur, si të ishte fole zogjsh shtegtarësh, kur bien gjethet në vjeshtë dhe degët heshtin në pritje të dimrit.

*

Dhe të dy u stepën. Gjaku sikur ua preu këmbët. Si të ishin zgjuar papritur edhe avujt e harruar të Martinit të bardhë. Evës iu mjegullua shikimi. Asnjëherë nuk e kishte ndjerë aq tronditëse praninë e një burri. Aq më shumë që ishte dhe hera e parë që ndodhej vetëm për vetëm me një burrë në një dhomë hoteli. Edhe kraharori sikur po i zhurmonte, si të përplaseshin aty dallgët e një deti të panjohur. Ajo ishte e sigurt se kishte ndryshuar edhe në fytyrë. Veçse nuk po e kuptonte se ç'ishte ajo mrekulli që rridhte nga heshtja. Dhe priti. Ajo ishte e gjitha një pritje. Ajo që po ndodhte brenda saj ishte e ngjashme me pjalmimin.

*

Hija e vilës ishte ende në fytyrën e saj, si të ishte mbërthyer pas poreve të lëkurës me rrënjët e padukshme të netëve, të frikës dhe të vetmisë. Edhe ajo e kuptoi se nuk po ecnin në rrugën nga kishin ardhur, por nuk pyeti ku po shkonin. Eva donte vetëm të udhëtonte [...] Për të udhëtimi ishte i barabartë me harrimin dhe me fillimin e një diçkaje që nuk mund të ishte kurrë më e keqe se ajo që po linte pas, megjithëse ende nuk e kuptonte plotësisht ç'kishte lënë pas.

*

Simoni po e shihte si të ishte një krijesë e tejdukshme, dalë nga shkrirja e rrezeve të hënës me bardhësinë e kreshtave të valëve.

*

Dhe ndërsa dielli po zhytej në det, mbi njollën e madhe të reve ngjyrë portokalli, u krijua një lumë i ngushtë, i verdhë drite, që dukej sikur kishte ngrirë gjithë limfën e ajrit. Pastaj deri në horizontin e largët, ndërsa shuhej drita e asaj dite, kishte nisur përpëlitja e heshtjes së mbrëmjes. Ajo do të endej e pakapshme mbi det dhe do të hidhte menjëherë rrjetën e yjeve mbi plazhin e shkretë.

*

Drita e filtruar nga qelqi akull, ia kishte thithur gjithë kohën, duke e kthyer në një pakohësi, ku ajo ndjehej sa e dehur aq edhe e lumtur [...] Dhe Simoni nuk po e kuptonte ku po humbiste ashtu, në ç'limbe, në ç'ujëra, në ç'pyje të përzierë, që jetonin, vetëm se katër stinët ishin të përziera në të njëjtin çast. Ai flaku tej mbulesat dhe trupat e tyre u shkrinë me natën, ndërsa indet e trupit thërrmoheshin mes një kënaqësie [...] si të ishte zjarri i brendshëm i një planeti në krijim e sipër [...] Ulërima e ndrydhur shpërtheu si një burim uji që ka çarë mes errësirës së rrënjëve të gurit.

*

Sa mbetën vetëm, Eva u zgjat mbi tryezë dhe puthi Simonin. Ajo u harrua në buzët e tij, si të mos ndodhej në restorantin e hotelit të vogël, por mes një dëbore të çuditshme, që mund të shihej vetëm me sytë mbyllur [...] Mes tyre ishte një qiell tërë re të zbardhuara, që derdhnin dëborën e parë të atij viti.

*

Ajo (dëbora) kishte thithur erën e flokëve të Evës dhe ai u deh. Ai e tërhoqi pas vetes dhe e puthi marramendës. Dëbora që kishte mbuluar një anë të fytyrës së tyre u shkri dhe puthja kishte një shije krejt të re, të panjohur, sikur brenda saj të ishin shkrirë bashkë qielli, retë, toka, dielli dhe ajri i asaj dite dimri.

*

Në mbyllje them se romani "Të gjithë premtojnë Parisin" i Nasi Lerës dëshmon mirëfilli për rrafshin e lartë poetik që ka mbërritur proza jonë e gjatë.

Prishtinë, fillim shtatori 2024



Gjeografia shpirtërore e Ballkanit

URAT E KOMUNIKIMIT MES KULTURËS ÇAME DHE ASAJ GREKE

Nga Enver Kushi



Problemi i dhënies dhe marrjes mes kulturës çame dhe asaj greke në veçanti, por edhe asaj shqiptare e greke apo kulturave të popujve ballkanikë në përgjithësi, është pak e studiuar, por edhe kur është trajtuar, vihet re jo vetëm një subjektivizëm i skajshëm, apo edhe shovinizëm kulturor "alla ballkanik". Do të mjaftonte të sjell në kujtesë studiuesit serbë, të cilët të paktën prej një shekulli, për të mos thënë më shumë, kanë shkruar qindra faqe duke derdhur shumë energji, për të "provuar" se "Eposi i Kreshnikëve" u përket popullit serb e se shqiptarët si "endacakë" dhe ardhës" të vonshëm në Ballkan", e kanë marrë atë nga sllavët. Jo vetëm "Eposi i Kreshnikëve", por edhe mitet gojëdhënat, legjendat, siç është ai i kalasë së Shkodrës janë të tyret. Ballkani ynë, ky truall befasues i kulturave nga më të çuditshmet, që ka rrezatuar përtej maleve të tij vlera të padiskutueshme në Europë, për fat të keq brenda vedit është shquar jo vetëm për sherrnaja e luftrave për territore në dëm të fqinjëve, si edhe për ca sherrnaja të tjera absurde, siç janë ato për kulturën.

Për fat të keq fjala "URË" në kutimin e mirëfilltë si lidhje mes brigjeve dhe në kuptimin metaforik edhe si lidhje mes popujve e në fushën e kulturës si dhënie e marrje reciproke, është shpërdoruar keq në Ballkan. E megjithatë, popujt e Ballkanit përtej këtyre sherrnajave absurde, kanë ditur që në mijëra vjet fqinjësi të ndërtojnë dhe rindërtojnë ura komunikimi. Ata kanë patur dhe kanë kodet e tyre të komunikimit dhe mirëkuptimit herë të qarta e të dukshme, herë- herë të mjegullta me simbole nga më të çuditshmet.

Ballkanasit edhe në kulmet e acareve nxitur nga politikat përçarëse, ideologjitë ekstremiste nacionaliste, stinët e shpeshta të përgjakshme që ka shoqëruar historinë e tyre, janë marrë vesh me ca kode që vetëm ata mund t'i kuptonin... Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Ballkanasit e sertë, por edhe të mençur, herë- herë kapadaij dhe me ca gjeste teatrale në sjellje, gjaknxehtë si ata, por edhe mikpritës trima të çartur dhe herë- herë naivë si fëmijë, të habisin me urat e komunikimit kulturor. Një këngë, valle, melodi, veshje e bukur, fjalë e urtë, legjendë, befas natyrshëm kapërcente kufijtë e një fshati të humbur dhe qindra kilometra më në jug, veri, lindje, perëndim, por edhe më pranë bëhej, pjesë e kulturës shpirtërore të atij vendi... Udhëtarë anonimë që flinin nëpër hane, tregëtarë, që me karvanet e tyre lëviznin lirshëm nëpër trojet ballkanike, barinj që veronin dhe dimëronin nëpër fushat e buta bregdetare apo alpe, rapsodë dhe grupe instrumentistësh ose këngëtarë të njohur, që ftoheshin nëpër dasma etj ishin padyshim këmbë të forta "urash mes kulturave të Ballkanit..."

Kështu ka ndodhur edhe mes shqiptarëve dhe grekëve, që janë popujt më të lashtë të gadishullit, ku në historinë e hershme të tyre ka një substrat të përbashkët gjuhësor dhe kulturor. Kështu ka ndodhur veçanërsisht mes shqiptarëve çamë të Thesprotisë dhe fqinjëve të tyre grekë. Këto dhënie dhe marrje në fushën e kulturës, sidomos asaj shpirtërore, kanë qenë normale dhe të natyrshme.

Çamëria është trualli ku pikafrimet dhe pikëtakimet mes kulturës shqiptare dhe asaj greke janë të prekshme dhe të dallueshme. Të gjendur pranë njëri-tjetrit gjeografikisht, por në disa fshatra dhe qytete çame edhe të përzierë, në fushën e kulturës shpirtërore, por edhe më gjerë, kanë dhënë dhe marrë mes tyre. Ka një të vërtetë të pamohueshme, se duke njohur dhe vlerësuar kulturat e njëri-tjetrit, çamët dhe grekët i kanë respektuar ato. Në këtë kuptim diversiteti kulturor në Çamëri dhe këtu fjalën e kam për kulturën shqiptare çame, që ishte homogjene, por edhe për kulturën e grekërve, vllehëve etj ka qenë një nga pasuritë dhe vlerat e mëdha të saj. Ndasitë fetare nuk ishin pengesë sa kohë që ata respektonin njëri-tjetrin si besim dhe vlerë. Çamët merrnin pjesë jo vetëm në festat fetare të fqinjëve të tyre, por edhe në dasma dhe gëzime të tjera. Përveç sinoreve ndarës pra gjeografisë me vija të përcaktuara ose edhe jo ndarëse, në Ballkan, dhe veçmas në Çamëri, mund të flasim edhe për gjeografi shpirtërore. Kjo e fundit nuk figuron në asnjë traktat apo marrëveshje ndërkombëtare ose ndërshtetërore. Ka patur por ka edhe sot, studiues seriozë grekë, ndonëse shumë të pakët në numër, që kanë vlerësuar kulturën e çamëve, këngët dhe vallet e tyre, veshjet, mënyrën e jetesës dhe banesën në qytet dhe fshat. Bota çame, shpirti i patjetërsueshëm çam ka vulën e vet në kulturën origjinale dhe befasuese të krijuar dhe trashëguar nga brezi në brez. Trashëgimia kulturore në Çamëri në tërësinë e saj është unike dhe pjesë e trashëgimisë kulturore shqiptare. Do të gabonim në qoftë se këtë kulturë do ta veçonim nga ajo e së tërës, pra shqiptare, siç do të gabonim edhe nëse atë do ta quanim një ishull më vete të mbyllur e pa komunikuar me fqinjët e saj grekë. Kultura lëndore, e quajtur ndryshe materiale dhe ajo shpirtërore në Çamëri janë shprehëse e vlerave të një popullsie me histori të lashtë. Ajo bart shtresëzime të hershme të formuara në epoka të ndryshme. Siç janë vënë në dukje nga studiues të ndryshëm, ajo është formuar nga elementë të lashtë parailirë (pellazgë) e pastaj ilirë dhe që u trashëguan në Mesjetën e Hershme. Nuk është e rastit një nga përfundimet e studiuesve gjermanë në librin "Këngët e çamëve" (Berlin 1965) se "ky gjurmim muzikologjik dhe tekstologjik dhe botimi i materialit të mbledhur, na tregon qartë se te këngët çame kemi të bëjmë me një shtresë arkaike të muzikës shqiptare."

Kostumi popullor çam, Faik Konica dhe shformimet greke

Në mungesë të botimeve shkencore nga Greqia fqinje për vlerat dhe marrëdhëniet e kulturës çame me atë greke, por në mungesë edhe të studimeve shqiptare në këtë fushë, do na duhej të zhvendoseshim në kohë dhe hapësirë, pra të riktheheshim dekada më parë, ndoshta edhe më shumë se një shekull, si dhe në trojet e Çamërisë për të analizuar jo mekanizmin e marrëdhënieve mes kulturës çame dhe asaj greke si shpirt dhe lëndë, por mekanizmin e përvetësimit të njëanshëm të kulturës çame prej grekërve, deri në grabitje dhe duke mohuar autorësinë e saj. Këtu jo popujt, por doktrinat nacionaliste greke kanë shembur njërën këmbë ose tërësisht "urën" e komunikimit kulturor.

Shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare, duke u marrë me këtë temë ka thënë: "Lufta për autorësinë e vlerave artistike zhvillohet prej kohësh në zonën ballkanike, ku ajo është veçanërisht e komplikuar, për shkak të marrëdhënieve kulturore të popujve të Ballkanit gjatë shekujve. Nënshtrati ndërballkanik, i krijuar si rrjedhim i këtyre marrëdhënieve, motivet e përbashkëta të epikës e të legjendës kanë qenë një terren tepër i përshtatshëm për incidente e shkelje kufijsh kulturorë, kacafytjet për përvetësimin e vlerave shpirtërore kanë qenë disa herë jo më pak të egra se kacafytjet e përgjakshme për kufijtë".

Popujt e Ballkanit "duke i huazuar njëri- tjetrit motive, tinguj ngjyra dhe teknika poetike, asnjëherë nuk kanë menduar se këto dhënie e marrje të bukura e sublime do të shfrytëzoheshin prej shovinistëve për qëllime të ulëta e krejtësisht të huaja për artin".

Do të duheshin studime serioze, mbështetur në argumente shkencore për të trajtuar jo vetëm marrëdhëniet mes kulturës çame e asaj greke, por veçanërisht huazimet reciproke. Gjithashtu do të duheshin edhe fushat, ku grekët fillimisht kanë huazuar, por më pas i kanë shformuar dhe përvetësim kulturën shpirtërore dhe materiale të çamëve. Pikërisht në këto shformime e përvetësime ka vepruar tinëzisht politika e qarqeve ultranacionaliste greke, një mekanizëm djallëzor, duke përbaltur shpirtin sublim të dy popujve në dhëniet e marrjet e bukura në fushën e kulturës.

Do përpiqem të trajtoj përvetësimin dhe shformimin që grekët i kanë bërë kostumit dhe valles çame.

Studiues seriozë, por jo vetëm ata, kanë vlerësuar kostumin popullor të çamëve. Poeti i madh anglez Bajron i mrekulluar nga ky kostum ka dhe një pikturë, ku ka pozuar i veshur me të. Udhëtarë të tjerë europianë, në librat e tyre kanë bërë të njëjtën gjë: kostumin çam e quajnë një nga vlerat e kësaj popullsie dhe asnjë prej tyre nuk vë në dyshim, se ai u përket shqiptarëve të Çamërisë.

Sipas citimit që bën studiuesi i mirënjohur Hajredin Isufi në librin "Çamëria studime historike – sociologjike shek XIII – XX" Çajrëll ka qenë në vitin 1880 mes çamëve në fshatin Mazërek dhe jep këtë përshkrim: "Grupet piktoreske të malësorëve, kësulat dhe fustanellat e tyre, bënin kontrast me livadhin e gjelbërt e me armët e tyre të çuditshme, që vezullonin në diell..."

Edhe konsulli francez në Janinë Pukëvil, që siç dihet nuk kishte ndonjë simpati për shqiptarët, nuk e fsheh entuziazmin dhe vlerësimin për kostumin e çamëve:: "Udhëtari që do të shikojë ata çamë që do të kenë shpëtuar nga sundimi feudal i sovranit të Janinës dhe nga rënia e mortajës, do të njohë me vështirësi ata burra të bukur me ato qëndisma të bukura lara- lara të veshur me kostume të shkëlqyer dhe të ngarkuar me ar të çmueshëm, që ngjasin sikur të ishin një koloni ushtarësh të Pirros të pasur me plaçka të Trojës, që kanë zbarkuar sërish në Epir.". Edhe historiani grek Spiro Mela (sipas citimit që i bën Hajredin Isufi) shkruan për "çamët me rrobat e tyre elegante e luksoze, këmisha të bardha të gjata, të qëndisur anash me ar."

Kur është huazuar kostumi popullor i çamëve nga grekët? Është një pyetje, përgjigja e së cilës do të kërkonte hulumtime serioze.

Në qoftë se do t'i riktheheshim kontakteve, por edhe fqinjësisë mes çamëve e grekërve, dhënieve e marrjeve reciproke në fushën e kulturës, kur popujt tanë nuk vuanin nga komplekse dhe ishin normale që në gëzime, veçanërisht në dasma, të ftoheshin apo të mernin pjesë në pazare, që organizoheshin në Prevezë, Paramithi etj e që sot quhen panaire, duhet të ketë qenë i hershëm huazimi i kostumit çam. Jam i bindur se në këto periudha grekët fqinjë të çamëve admironin

fustanellën palë- palë, jelekët e qëndisur dhe mëngoret që vareshin, festet e gjata me majë, këpucët me xhufka, levendërinë në të kërcyer të çamëve….

Faik Konica, një nga shkrimtarët dhe kulturologët e mëdhenj shqiptar, përmend shek XIV, kur kostumi shqiptar ''ka hyrë ndër grekët, kur shqiptarët nën Bua Shpatën sulmuan dhe nënshtruan Greqinë". Po Faik Konica, duke u marrë me këtë problem, shkruan: ''Shumë më vonë, nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë, greku praktik e pa se ishte në të mirën e vet që ta pranonte veshjen shqiptare në disa rrethana dhe për disa arsye, që i kanë paraqitur disa autorë".

Koloneli Lik në ditarin e udhëtimeve të tij nëpër More, më datën 28 mars 1805, shënon: ''Veshja shqiptare po bëhet përditë e më e zakonshme si në More, edhe në pjesën tjetër të Greqisë…. Kjo veshje është më e lehtë dhe më e volitshme se ajo turke ose greke". Ndërsa admirali Zhyrjen dë la Gravjerë shkruan: "Shqiptarët përbëjnë një racë të veçantë në Evropë…Veshja shqiptare u bë e modës dhe osmanët më fodullë e mbanin me krenari fustanellën e bardhë të shqiptarëve të jugut. Vetë grekët, kur djali i dytë i Aliut, Veli pasha, qeveriste Morenë, e morën këtë veshje si simbol të trimërisë dhe e bënë uniformën elegante të palikarëve."Faik Konica gjithashtu, duke ju referuar të huajve, citon edhe G. Finlay, i cili në librin "A history of Greece" ka shkruar: "Ka qenë fama e shqiptarëve që i ka detyruar grekët e sotëm të pranonin fustanellën shqiptare si kostumin e tyre kombëtar. Është pasojë e këtij adhurimi për shqiptarësinë, që oborri i mbretit Oto merr pamjen e vet melodramatike dhe shkëlqen me një imitim të shtirë e verbues të veshjes së ndritur e të pasur, që ka tërhequr vëmendjen e Çajld Haroldit në galeritë e pallatit të Tepelenës, por fustanella prej basmeje u varet rreth këmbëve grekërve si fund grash prej letre, ndërsa fustanella e bardhë e toskëve, e përbërë nga cohë e fortë e endur në vegjën vendëse, bie me pala të hijshme si cohët e lashtësisë".

Nuk ka nevojë për shumë koment për të arritur në konkluzionin që siç shprehet Konica,'i ashtuquajturi kostum modern ''grek" në të vërtetë është një imitim i poshtër i kostumit shqiptar'' dhe se në shformimin grek të veshjes shqiptare ka një element të palaçove, që i bën shumë shqiptarë të qeshin, ndonëse të tjerët janë të pakënaqur e të zemëruar. Faik Konica është i pari që në dukje dallimet kryesore ndërmjet veshjes së mirëfilltë shqiptare dhe karikaturës greke. Xhaketa në veshjen shqiptare ka një të çarë të lirë te mëngët, për të lënë të kalojë krahu, ndërsa mngët të qepura vetëm në pjesën e sipërme të supeve hidhen prapa. Ato edhe mund të përdoren, por përgjithësisht nuk u futen krahët. Ndërsa grekët, nënvizon Konica, gjithmonë i fusin duart dhe nuk e kanë vënë re ose nuk e kanë kuptuar këtë tipar, që nga koha e mbretërimit të mbretëreshës Elizabeta ka tërhequr vëmendjen e një poeti të madh anglez. Edmond Spenser flet për mëngët, që u vareshin si të shqiptarëve. Është me interes të nënvizojmë se në këtë shformim nuk ka shpëtuar as fustanella, që përbën elementin kryesor të kostumit çam. Sipas Konicës, në veshjen origjinale shqiptare, fustani ka një numër të vogël palësh, zakonisht gjashtëdhjetë. Veç kësaj ai bëhet me pëlhurë liri të rëndë, të endur në shtëpi dhe është mjaft i gjatë sa mbulon tërësisht kofshët dhe le të pambuluara vetëm pulpat. Burrat më të vjetër e mbajnë fundin tetë deri dhjetë centimetra nën gju. Sipas Likut por edhe autorëve të tjerë, përshtypja e përgjithshme që krijon fustanella shqiptare është ajo e cohëve të lashtësisë. Si e kanë shformuar fustanellën shqiptare grekët? Ky shformim ka prekur jo vetëm gjatësinë, numrin e palëve, por edhe cohen. Ata ''kanë shtuar palat e fustanit nga gjashtëdhjetë në rreth dyqind ose më shumë; në fillim ata kanë ruajtur gjatësinë e rregullt të fustanit, por meqë nuk ishin të zotët ta mbanin në vend rreth këmbëve, nisën ta shkurtonin gjithnjë e më shumë, derisa sot ka arritur një shkurtësi të pahijshme dhe ata përdornin një pëlhurë të lehtë pambuku. Në fakt ata e kanë rrëgjuar fustanin në një fund të lirë baleti e në tërësi ai të jep përshtypjen e diçkaje të neveritshme, që nuk u shkon burrave.".

Vallja çame dhe ''Çamiko" e kërcyer nga grekët.

Ndryshe ka ndodhur me vallen çame. Grekët deri më sot kanë njohur çamët si krijues dhe bartës të valles. Në të gjitha grupet foklorike jo vetëm të trevës së Çamërisë së sotme, por edhe ato greke apo ansamblet, programet televizive, shfaqjet kulturore brenda e jashtë Greqisë, ajo quhet vallja ''çamiko" ose thënë ndryshe "vallja e çamëve". Unë kam patur rastin në vitet '70 e më vonë të shekullit që lamë pas, të shoh disa ansamble greke që kanë dhënë shfaqje në Tiranë, Durrës e gjetkë. Jam mrekulluar nga niveli i lartë dhe muzika moderne greke si dhe këngëtarët e mëdhenj Marinela Mariza Koh Janis Parios etj. Gjithashtu jam mrekulluar edhe nga traditat folklorike të krahinave të ndryshme të Greqisë fqinje. Emocione të veçanta kam ndjerë kur kam parë në skenë valltaret virtuozë grekë, që interpretonin vallen çamiko. Ato ishin djem të rinj shumë të talentuar, që e kërcenin me shpirt këtë valle.

E megjithatë, kur kam dalë nga këto shfaqje më janë kujtuar shumë valltarë çamë, që unë i kisha parë në dasmat çame. Atëherë isha i ri dhe në qytetin e vogël të Rrogozhinës, ku jetonte një numër jo i vogël çamësh kisha parë disa valltarë virtuozë. Nuk do të harroj kurrë Shaban Osmanin nga Salica. Ai ishte një burrë i gjatë shumë elegant, që atëherë më dukej një njeri kockalli. I thatë, me një fytyrë të mprehtë, kërcinj të gjatë me një mirësi të spikatur në tërë qenien e tij Shaban Osmani ishte një nga mjeshtrat e mëdhenj të valles çame. Mbaj mend se ai nuk dilte menjeherë në valle. Sheshi ishte bosh i rrethuar vetëm nga burra dhe orkestrën ulur në krye. I pari çohej në këmbë klarinetisti. Ai quhej Karaman dhe vinte nga Tirana . Karamani ishte i njohur që në Çamëri dhe thonin se për të klarineta ishte e shenjtë…

Pas Karamanit ngriheshin në këmbë violinisti dhe ai që i binte defit. Karamani ja niste melodisë së valles… Asnjë nuk pipëtinte. Burrat ndërprisnin muhabetin dhe ata që pinin cigare i shuanin ato…. Vështrimet e syve të trishtuar e plot mall të çamëve, ishin drejtuar nga Karamani. … Atje kam parë pleq që vinin duartt në dy anët e kokës e disa të tjerë që shihnin herë sheshin bosh e herë- herë qiellin. Ndoshta nga qielli prisnin të vinte vallja çame. Sepse vallja çame kishte shumë nga qielli, siç kishte shumë edhe nga toka… Kalonin kështu një, dy minuta… Karamani ulte e ngrinte klarinetën. Dukej sikur thërriste shpirtërat e valles çame ose më saktë shpirtin e valles çame… Dhe ai vinte në minutin e tretë, krejt befasisht, sikur kishte rënë nga qielli ose dalë nga thellësia e tokës. Nuk ishte Shaban Osmani që njihja unë, dhe që e takoja thuajse çdo ditë. Ishte Shaban Osmani i valles çame, që ulej e ngrihej me një lehtësi të habitshme nga toka, shtrihej për t'u ngritur prap në ajër… Shaban Osmani ishte edhe ëndërr edhe qiell, edhe ditë, edhe natë, edhe lot edhe gëzim. Shaban Osmani ishte triumfi i njeriut çam krenaria dhe levendëria e Çamërisë, sakrifica sublime, tallaz dhe dehje në beteja….

….Kur kam lexuar librin e Aristidh Kolës "Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve'', valltarët e talentuar të ansableve greke që i kisha parë duke kërcyer vallen çamiko m'u dukën si hije të zbehta dhe vallja jonë e bukur tërësisht e shformuar prej tyre. Atëherë m'u kujtua Shaban Osmani nga Salica e Çamërisë, mjeshtëria dhe virtuoziteti i kërcimit të tij. Aristidh Kola, ashtu si Faik Konica më parë, që publikisht denoncoi përvetësimin dhe shformimin e kostumit shqiptar çam, në librin e tij ka argumentuar nga njëra anë madhështinë e papërsëritshme të valles çame dhe nga ana tjetër shtrembërimin dhe deformimin e saj nga grekët. Studiuesi i mirënjiohur arvanitas qartësisht jep thelbin e valles çame, si një valle që pasqyron shpirtin shqiptar... Ajo, sipas Aristidh Kolës, ka levenderi, krenari, bukuri në lëvizje, të cilat vënë në dukje dhe virtytet e mësipërme. Nuk është valle erotike. Por gjithashtu nuk është as luftarake, as e ndjenjës. Vallja çame është valle triumfale. Diçka që bën të dyshoj nëse mund të ketë të dytë në botë, nënvizon Kola. Vallja çame përmbledh me lëvizjet bukurinë, levenderinë, burrërinë dhe krenarinë e kërcimtarit të parë. Sepse duhet theksuar këtu se vallen çame nuk e kërcejnë të gjithë por vetëm kërcimtari i parë. I dyti "e mban mirë" dhe është me të vërtetë e vështirë të "mbash drejt" dhe mirë kërcimtarin e parë e të zotë me figurat e mrekullueshme dhe kërcimet, ndërkohë që të tjerët ndjekin nga pas, duke marrë pjesë mendërisht dhe shpirtërisht, duke u krenuar dhe duke i dhënë figurën e plotë asaj, që përpiqet të shprehë i pari me lëvizjet dhe figurat e tij.

Ç'ka ndodhur me vallen e famshme çame në Greqi? A është ruajtur origjinaliteti i saj në kërcim? Përveç emrit ''çamiko" që grekët çuditëriht nuk e kanë ndryshuar, të tjerat janë të shformuara. Valltarët e rinj e të talentuar grekë përveç lëvizjeve prej atletësh dhe figurave që krijojnë gjatë kërcimit të kësaj valleje, nuk japin asgjë më tepër se kaq. Ky nuk është faji i tyre, por i koreografëve. 'Çamikos" greke i mungon kryesorja:shpirti shqiptar çam dhe bukuria, levendëria, burrëria, dhe krenaria, që karakterizon popullsinë çame. Studiuesi Aristidh Kola me të drejtë konkludon: "Ata njerëz që kanë marrë në duar vallen çame që prej disa kohësh, me sa duket qartësisht as arbëreshë nuk janë dhe as idenë s'ia kanë se ç'lloj valleje është vallja çame dhe nga cili popull është krijuar. Kështu na paraqesin një lloj valleje çame që po jua them haptazi, kur e shohin arvanitasit nisin e qeshin. E quajnë "Shkollore", sepse mësuesit që dërgoheshin nëpër fshatrat arbëreshe pa ditur gjë prej gjëje rreth saj, përpiqeshin t'ua mësonin vallen çame popullit që e krijoi atë, duke e bërë kështu imitimin mjaft qesharak".

Ndryshe ndodh me vallet çame të kërcyera edhe sot nga çamët e krishterë, apo vllehët, ose grekët, kur popullsia myslimane e krahinës së Çamërisë nuk është më atje, e shpërngulur dhunshëm në vitet 1944-45, nga bandat zerviste. Kur I shoh këto valle më duket se atje është shpirti i vërtetë i valles, shpirti i vërtetë i Çamërisë. Gjej rastin t'I përshëndes vëllezërit

e mi të krishterë në Çamëri, që vazhdojnë të ruajnë të patjetëtsueshme karakterin e kësaj valleje të mrekullueshme.

Urat e reja të shpirtit ballkanik

Shumë vite më parë, kur shekulli që lamë pas po rrokullisej drejt fundit të tij, pata fatin të marr pjesë në një festival ballkanik që organizohej në Ankara. Ishte maj dhe nuk do të harroj kurrë qiellin e Ankarasë, erërat e ngrohta, tingëllimin poetik të gjuhës turke, por veçanërisht atmosferën e krijuar në kryeqytetin e Turqisë nga shfaqjet e grupeve folklorike, ardhur nga gjithë vendet e Ballkanit. Ndryshe nga acaret, makthet, sherrnajat e pafund, luftërat e përgjakshme që kishin ndodhur në Ballkanin tonë gjatë shekullit që po rrokullisej ankthshëm e me përtim, në Ankara, gadishulli tragjik nëpërmjet melodive, këngëve, valleve, larmisë së kostumeve, sillte shumë nga shpirti i tij. Ndihej, siç shkruan shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare "nënshtrati ndërballkanik" si dhe motivet e përbashkëta. Urat e komunikimit që risillnin popujt e Ballkanit në këtë festival ishin të lashta sa vetë ata, solide dhe ndryshe nga baladat e tyre, që prisheshin natën për t'u rindërtuar ditën… Ishte maji i vitit 1991. Shqipëria ime përpiqej të largonte përgjithmonë mantelin e përgjakur komunist, ndërsa Ballkani në veri të tij, ishte në prag të gjakderdhjes së tij të fundit… Kanë kaluar gati 20 vite që nga festivali Ballkanik i Ankarasë dhe gadishulli ynë mitik ndodhet në proceset e evropianizimit ose thënë ndryshe, po punon për të ringritur urat e komunikimit të shumanshëm. Në Jug të tij, shqiptarët dhe grekët popujt më të moçëm të Ballkanit, gjithashtu janë në këtë proces rindërtimi urash, pavarësisht fantazmave të fundit që ringrihen nga varret e idelogjive përçarëse. Çamët e shpërngulur me dhunë nga bandat kriminele greke të Napolon Zervës në vitet 1944-1945, kërkojnë të rivendosin ura komunikimi shpirtëror me vëllezëri e tyre të një gjaku, çamët e krishterë, vllehët dhe grekët, që jetojnë në Çamërinë e sotme. Jo vetëm kaq. Ata janë për ura komunikimi edhe me grekët, sepse çamët e grekët, pavarësisht nga e kaluara e tyre e hidhur, kanë ditur që në fushën e kulturës të marrin dhe japin me njëri- tjetrin.

Çamëria ime mitike kërkon rikthimin në trojet e saj të shpirtit çam: baladave, këngëve, kostumeve popullore, valleve, rikthimin e miqësive të vjetra jo vetëm me vëllezërit e saj të krishterë, por edhe me grekët, vllehët etj.

Ballkani ka nevojë për ura të reja komunikimi mes kulturave të tij nga më befasueset jo vetëm të gadishullit, por edhe në rrafshin europian.

DRITËSIMI I DE RADËS

Nga dr. Skënder Karriqi

Zjarri brenda njeriut

Nëse gjithçka që ndryshon ngadalë shpjegohet si veçori e jetës, gjithçka që ndryshon shpejt shpjegohet nëpërmjet zjarrit. *Zjarri është shumë i gjallë. Zjarri është intim, është edhe universal. Ai jeton në zemrën tonë, jeton edhe në qiell. Ai ngrihet nga thellësitë e substancës dhe vjen si një dashuri. Ai zbret përsëri në materie e fshihet si një urrejtje dhe hakmarrje. Midis gjithë dukurive, ai është i vetmi që të shtyn të kuptosh qartë dy* të kundërta: të mirën dhe të keqen. *Ai shkëlqen në Parajsë. Ai djeg në Ferr. Ai është ëmbëlsi dhe torturë, ai është kuzhina, ai është Apokalipsi. Ai është zbavitje për fëmijët e ulur urtësisht pranë vatrës; ai dënon të gjithë të pabindurit, kur ata luajnë* në flakët e tij. *Ai është kënaqësi dhe respekt.* Është një zot mbrojtës edhe i tmerrshëm, i mirë edhe i keq. *Duke menduar për zjarrin, mund të biesh në kundërshtim me veten: ai është një nga parimet e shpjegimit universal*.[1]

Ky përcaktim i Bachelard mbi zjarrin, i bërë në esenë *Psikanaliza e zjarrit* dhe që i paraprin studimit tërësor të R. Trousson, me titull: *Tema e Prometeut në letërsinë evropiane,* hap rrugën që figura e zjarrit dhe e efekteve të tij të shihen në një plan të gjerë universal, ku argumenti komparatist pothuajse e humb vlerën si burim identifikues i origjinalit përmbajtësor. Motivi i zjarrit, i reflektuar edhe në figurën e efekteve të *dritës, shkëlqimit, vezullimit, ndriçimit, agimit, ditës së bardhë, prushit, energjisë* etj, sipas tij, është edhe brenda njeriut, përkatësisht brenda poetit, dhe manifestohet si produkt i shpirtit të tij... Është historia prometeike e njeriut që reflektohet në dy faza: së pari në fazën mitologjike ku shkëlqen me kultin e Prometeut, origjina e të cilit është lindore[2] dhe së dyti me fazën letrare ku rrugëtimi historik nis me Eskilin dhe vazhdon deri sot

Vepra ndërtuese e De Radës

Me pak fjalë, prometeikja është veti e brendshme e njeriut, përkatësisht autorit. E manifestuar në shkallën më të lartë, ajo përkon me individin nismëtar të misioneve të mëdha me karakter të thellë human. Në këtë kuptim do të ishte e përshtatshme që analiza kritike mbi prometeiken të fillonte me autorin si referent i rastit prometeik. Është folur për individualitetin dhe personalitetin prometeik të De Radës, është folur për ndjeshmërinë e tij të veçantë ndaj fisit, kombit, atdheut, për vetminë e tij si shenjë dalluese e karaktereve të mëdha, si dhe disponimin prometeik të tij, të argumentuar përkundër alternativave të kalorësit dhe profetit të modelit biblik. Dritësimi i poetit Jeronim de Rada do të përmbyllte këndvështrimin tonë dhe njëkohësisht do të na çonte tek vepra letrare deradiane e cila s'është gjë tjetër, veçse manifestim i asaj energjie që natyrshëm na vjen ta quajmë prometeike.

Parimet e estetikës e De Radës na ndihmon të provojmë se vepra e tij letrare është mishërim i plotë i personalitetit dhe induvidualitetit të tij, gjegjësisht prometeik.

De Rada, qoftë veprën letrare, qoftë veprën *Parimet e estetikës,* i motivon nga këndvështrimi filozofik dhe teoriko-letrar aristotelian. Ndër të tjera, mimetizmi i tij, për sa i përket veprës letrare, konsiston në imitimin e modeleve rapsodike arbëreshe, si pika të rëndësishme reference për krijimin e një literature të munguar, e cila, nga njëra anë do të ishte ringjallje e gjuhës shqipe, nga ana tjetër do të ishte drita ndriçuese në udhën e rilindjes shqiptare. Gjithashtu mimetizmi i tij konsiston edhe në imitimin e brendisë së vet individuale, të cilën autori e ka projektuar në personazhet e veprave të tij. Jo rtastësisht *Këngët e Milosaos* motivohet me fakte biografike të autorit. Këtë lidhje biografike, para se ta pohonte hapur në *Autobiografnë* e tij më 1898, autori do ta shprehë më 1834 në letrën dërguar Rafael Xangareze-s, ku ndër të tjera i shkruan: *Në të* (*Këngët e Mliosaos*. shënimi im, S.K.) *derdha shumë ëmbëlsi, sidomos vërtetësi duke përshkruar në pjesën më të madhe ngjarje krejt të miat, as kam lexuar ndonjë gjë asodore...*[3] Është fjala për *Këngët e Milosaos,* të cilën studiuesit e konsiderojnë si bërthamën e veprës deradiane. Pikërisht kjo vepër bërthamë (vepra e parë, themeluese e letërsisë së kultivuar shqipe) buruaka ngushtësisht nga brendia e autorit. Si e tillë ajo do ta modelojë letësinë shqipe, dhe, me sa duket, kjo provohet me shenjën lirike të kësaj letërsie.

De Rada besonte se mërgimi i kolonive arbëreshe në Italinë e Jugut ishte vepër providenciale, qëllimi i lartë i së cilës ishte rilindja e kombit shqiptar. Ndoshta i nxitur edhe nga Virgjili, i cili, i nisur nga qëllime glorifikimi dhe legjitimimi të Perandorisë, origjinën e Romës së lashtë e pa të lidhur me mërgatën që printe Eneu pas shembjes që i bënë grekët Trojës, poeti nismëtar arbëresh, ringjalljen e Shqipërisë e shihte si një procest rimarrjeje dhe referimi ndaj modelit jetësor, gjuhësor dhe kulturor të kolonive arbëreshe të Italisë, të cilat, sipas tij, i kishin konservuar mjaftueshëm tiparet qenësore të jetës shqiptare, që nga koha e Motit të Madh, kur Shqipëria, në përgjithësi, ishte në nivele të krahësueshme me Evropën. Në këtë kuptim historik De Rada për Rilindjen Kombëtare nuk shikon përpara, por kthehet mbrapa, me qëllim për ta zhbërë kohën 500 vjeçare të sundimit osman dhe për të kthyer Shqipërinë Skënderbejane, imazhi letrarohistotik i së cilës do të ishte referenca shembullore për vendin amë.

Gjithsesi, ndërmjet De Radës dhe Virgjilit, ndër të tjera, qëndron dallimi se vepra e antikut nuk i paraprinte ndërtimit të Romës në kuptimin e ringjalljes së Trojës, përkundrazi, ajo e pasonte atë dhe prandaj nuk mund të quhet një vepër ndërtuese në një pikëpamje të tillë vizionare. Ndërsa vepra e De Radës i paraprin ringjalljes së kombit dhe në këtë kuptim ajo është një vepër ndërtuese vizionare. Nisur e nga ky fakt vepra e De Radës është një vepër me dritë. Ajo ndriçon shembullin e modelit jetësor, kulturor dhe gjuhësor të kolonive arbëreshe, ndriçon Motin Madh dhe në këtë mënyrë ndriçon të ardhmen e rilindjes shqiptare. Prandaj kjo vepër, duke përshkuar horizonte pritëse letrare, vjen deri tek ne si një vepër që domosdoshmërisht të shkakton ndjesinë e forte të dritës, duke i përmbajtur



të gjitha reflekset e saj. Pothuajse të gjithë studiuesit e veprës deradiane e kanë vënë re një fakt të tillë. Më së shumti reflekse të tilla: *drite, shkëlqimi, vezullimi, agimi*, reflekse të një *drite teokrite* apo të një *drite prej miti*, i përjeton si ndjesi të forta dhe i përcjell në formë eseistike Ernest Koliqi.

Dielli i brendshëm

Është rasti të ndalemi, sado pak, në ndjesinë e dritës si shenjë paqeje, për të vënë në dukje një dallim të rëndësishëm. Prej antikitetit, nëpërmjet heroit mitologjik dhe letrar, Prometeut, imazhi i dritës në kuptimin përmbajtësor lidhet edhe me zjarrin, të rrëmbyer nga qerrja diellore, fshehur në një kallam. Kështu zjarri do të ndriçonte edhe natën. Kjo qe një fitore e rëndësishme e njeriut: nata u bë ditë. Por ky imazh bruto i zjarrit ndriçues përmban në vetvete edhe mundësinë e shkatërrimit. Prandaj në udhën e qytetërimit, njerëzimit iu desh ta filtronte këtë imazh në pikëpamje përmbajtësore. Ky proces rezultoi në përputhje me botëkuptime dhe ideologji të ndryshme, veç të tjerash, në dy qëndrime: zjarri që djeg, shkatërron dhe në këtë mënyrë i hap rrugë ringjalljes, rilindjes së një jete të re. Kjo është praktika revolucionare me të cilën përkon Prometeu si hero i revolucionit politiko- shoqëror, që i ve flakën botës së vjetër për t'i hapur rrugë botës së re. Kjo pra, është hitoria e revolucioneve politiko-shoqërore, që i kanë kushtuar aq shumë njerëzimit. Konceptimi i zjarrit si i tillë është relativisht i vonë dhe bie ndesh me imazhin e zjarrit që ngroh dhe ndriçon, me imazhin e zjarrit si simbol i urtësisë, që rëndom e shohim tek njeriu i mençëm, intelektuali, qoftë edhe tek ai që ecën sipas mësimeve të Zotit. Një konceptim ksisoj i zjarrit ka të bëjë me qëndrimin e dytë dhe është më i hershëm. Ai vjen i përpunuar nga institutet e fesë, si zjarri dhe drita hyjnore që i paraprijnë njeriut dhe njerëzimit. Efektet e tij kanë të bëjnë me ndjesinë e paqes dhe të drejtësisë, ndjenja këto që e kanë motivuar dhe do ta motivojnë përjetësisht, në mënyrë të mjaftueshme, njeriun dhe njerëzimin drejt qëllimeve të mëdha, pa tejkaluar caqet përtej të cilave ai do të ishte i pamjaftueshëm për ruajtjen e ekuilibrave kozmikë. Kjo ndjenjë e tillë prometeike, (le ta quajmë kështu), e filtruar, e butë, ngrohëse, ndriçuese, e karakterizon Jeronim de Radën, i cili me vetëdije bën kujdes për të artikuluar në mënyrë sa më të zbutur zemrimin e tij ndaj Zotit, qoftë drejtpërdrejt, qoftë me anë të personazheve. (Në përshtatje me këtë filozofi ai ka praktikuar edhe tabunë, qoftë ndaj figurës së Prometeut, prej së cilës çlirohet në fund të jetës, qoftë ndaj ndonjë anëtari tjetër të familjes së titanëve siç është Sizifi).

I ngarkuar me një energji të tillë, ngrohëse dhe ndriçuese, De Rada do të çlirohet prej saj duke e shkarkuar në veprën e vet. Dhe veprimit në këtë rast i paraprin qëllimi i ndriçimit të udhës së Rilindjes Kombëtare. Këtë energji dhe intesitet drite që i karakterizon veprat e tij letrare, shpërfaqur në nuanca të larmishme (*vezullimi, ndriçimi, shkëlqimi, agimi, aurore, dite të bardhë, drite teokrite, drite prej miti etj),* ai do ta teorizojë në nivelin e një parimi estetik, i cili i pazbatuar apo i zbatuar keq, do të pamundësonte veprën letrare, apo do ta dëmtonte rëndë cilësinë e saj. Për këtë De Rada, në veprën *Parime të estetikës* (1861) botuar në Napoli, italisht, do të shprehet tekstualisht: *Mirësia dhe dinjiteti i permbajtjes të misionit të krijuesit,* (kupto shkrimtarit, shënimi im, S. K.) *nënkupton përgjgjësi shumë të madhe dhe e bën këtë gati veprimtari të shenjtë. Andaj çdo vepër duhet të vlerësohrt si e zbrazët dhe e pavarur kur nuk ka një domethënie të tillë,* ***një diell të brendshëm****, por synon vetëm të kënaqë ose të dëshmojë se autori i saj është i shkathët.*[4]Po japim këtu edhe një variant tjetër të përkthimit të këtij pasazhi të tij. Çdo vepër që nuk ka ***një diell të brendshëm****, por synon vetëm të sjellë kënaqësi dhe të dëshmojë për një mendje të shkathët e të aftë, duhet të vlerësohet si një vepër e zbrazët dhe e pavarur.*[5]Këto dy variante, përkthyer nga *Parime të estetikës*, (vepra e De Radës në italisht), i pari sjellë nga Alfred Uçi dhe i dyti nga Nasho Jorgaqi,[6]dëshmojnë mirfilli për dritësimin e poetit Jeronim de Rada. Këtë efekt iluminant të veprës esteti De Radë e sheh në raport me misionin e autorit dhe përmbajtjen e veprës letrare. Në konceptimin e tij, kjo përmbajtje e ndriçuar, e dritësuar, vjen si ndjesi e pakushtëzuar nga retorika propagandistike. Në këtë mënyrë tradita prometeike në letërsinë shqipe vjen e lirë prej propagandizmit, pavarësisht njohjes së një letërsie misionare. Në qoftë se kjo letërsi më vonë do të karakterizohet nga retorika propagandistike, duke synuar që me anë të saj të formulojë dhe të përcjellë mesazhin, kjo s'ka të bëjë me De Radën dhe veprën e tij. Përkundrazi, vepra e tij, më tepër se sa mendim, është ndriçim i mendimit, më tepër se arsye e qartë, e kulluar, është ndjenjë, që vjen me *dritë prej miti* dhe si e tillë, vjen në përmasa universale, që për argument kanë rastin historik shqiptar.

Për motivimin e dritësimit të poetit Jeronom de Rada, mendojmë se vlen të përmendet edhe fakti që për argumentimin e tezave të ndryshme, De Rada niset nga shembuj me natyrë dhe efekte dritësuese. Fjalavjen, për të mbështetur me shembuj idenë e larmisë së tingujve të gjuhëve të ndryshme *që i përgjigjet karakterit të pafund të gjithësisë dhe* të cilën *një gjuhë e vetme, tok me shpirtin e jetën e një kombi të vetëm, nuk ka mundësi ta përfshijë të tërë* ,[7] De Rada u referohet yjeve qiellorë dhe fjalëve përkatëse në gjuhë të tilla si: italishtja (stela), greqishtja (astir) dhe gjuha shqipe, përkatësisht variantit arbëresh (iill). Teza e tij është se kompleksi tingëllor në gjuhët përkatëse, përcjell, transmeton nuanca të ndryshme drite. Konkretisht, kompleksi tingëllor ***stela*** përcjell ndjesinë nuancuese të një drite të qëndrueshme dhe të lëmuar. *Ndërkohë*-shtjellon tezën e vet De Rada-*ka edhe një lloj ndriçimi më të fuqishëm, të pandërprerë dhe të pashteruar, që duket sikur elenët e kanë paraqitur me fjalën e tyre* ***astir.*** Ndërsa *një lloj drite të yjeve që është e zbehtë dhe e pagjymtuar, duket sikur e shpreh mirë fjala shqipe* ***iill*** **(yll).** *Kështu na duket se janë diferencuar prej gjuhës njerëzore të folmet e ndryshme, të cilat në tërësinë e tyre i shembëllejnë një pasqyre që hap herë njërën anë, herë tjetrën anë të botës.*

Në mes të gjuhëve të ndryshme, ndrisin si yjet më të mëdhenj ato gjuhë që pasqyrojnë dukuritë më të bukura dhe që kanë një përmbajtje më të thellë. Megjithatë, edhe gjuha më e dobët në mes të tjerave, nuk dëshiron të humbasë, ashtu si çdo yll, edhe ai më i vogli, nuk shuhet fare por ruan për shumë kohë vendin e vet në qiell.[8] Me sa duket, e ka fjalën për yllin shqiptar, që në kohën e tij fekste, por që ai do ta energjizonte me diellin e tij të brendshëm.

---

1 Gaston Bachelard. *La psychanalyse du feu,* fq 21-22, cituar nga R. Trousson, vepër e cituar, fq 25.

2 Jacqueline Duchemin. *Prométhée- Histoire du mithe, de ses origines orientales á ses incarnations modernes*. Belles-Lettres, Paris, 1974.

3 Jeronim de Rada, Vepra III, e cituar, fq 304

4 J. de Rada. *Parimet e estetikës* . Vepër e cituar.

5 J. de Rada. Vepra III, e cituar

6 J. de Rada. Vepra I, e cituar, fq276.

7 J. de Rada. *Parime të estetikës, ,fq130.* Përgatitur nga A. Uçi (1972), Globus R

8 J. de Rada. *Parimet të estetikës*, fq 130-131

Ndahet Çmimi "Martin Camaj" për vitin 2024

Çmimi "Martin Camaj" vlerëson kontributet e rëndësishme kulturore që forcojnë bashkëpunimin kulturor mes Shqipërisë dhe Gjermanisë dhe shoqërohet gjithashtu, me një shpërblim monetar.

Ai u është akorduar më parë personaliteteve të shquara si Zef Zorba dhe të tjerave figura shumë të rëndësishme të letersisë dhe të kulturës.

Në vitin 1996, një komision, i përbërë nga albanologu Hans Joachim Lanksch, prof. dr. Walter Breu (Universiteti i Kostancës), prof. dr. Elvira Glaser (Universiteti i Zurihut), dhe prof. dr. Wilfrich Fiedler (Universiteti i Munihut), i dha Zorbës çmimin Martin Camaj me një motivacion të lartë.

Synimi i Shoqatës Martin, Camaj, pra, është përkrahja e shkëmbimit kulturor dhe ndërmjetësimi mes kulturave shqiptare dhe gjermane.

Prandaj, prej disa vitesh ofrohet ky çmim "Martin Camaj", duke nderuar tashmë talentet e reja në fushë të shkencës dhe të kulturës.

Vitet e fundit janë ftuar të aplikojnë studuiesit, përkthyesit e letërsisë (nga gjermanishtja), e, për këtë vit autoret e letërsise për fëmijë.

Me çmimin "Martin Camaj 2024", Shoqata Martin Camaj dëshiron, pra, të tregojë vlerësimin e saj për letërsinë shqiptare për fëmijë, e cila vendos themelet kulturore për më të rinjtë. Janë ftuar të aplikojnë të gjithë autorët nga Shqipëria, Kosova, Mali i zi dhe Maqedonia e Veriut të cilët në dy vitet e fundit kanë botuar libër për fëmijë.

Juria ndërkombëtare e ndërdisiplinare e Çmimit "Martin Camaj" si çdo vit, bën një përzgjedhje dhe njofton fituesin e çmimit nga fundi i qershorit, e më pas bëhet prezantimi në mbledhjen vjetore të shoqatës në shtëpinë e Erika Camajt në Lenggries, në "festen e verës"-që organizohet çdo korrik.

Sot Presidenca e Shoqatës "Martin Camaj", në Lenggries, Gjermani, drejtohet nga Prof.dr. Christian Voss dhe përkthyesja e përkushtuar, me kontribut te pandërprerë në marrëdhënien mes dy kulturave, znj. Zuzana Finger.

Profesor Voss është drejtuesi i departamentit të studimeve sllave jugore pranë Universitetit të Humboldtit në Berlin. Ai është shkolluar në Cologne dhe Freiburg dhe është habilituar me vlerësimin Venia legendi për filologji sllave. Interesat e Profesor Voss shtrihen edhe në Albanologji, fushë për të cilën ka organizuar konferenca, ka mbajtur kumtesa dhe boton vazhdimisht në "Shoqatën e Europës Juglindore", një shoqatë gjermane shumë e rëndësishme për studimet lidhur me Europën Juglindore. Në 2021 ai u zgjodh president i shoqatës "Martin Camaj" dhe vizioni i tij është zgjerimi i shoqatës, si dhe vazhdimi i promovimit të veprës së Martin Camajt në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, diasporë e siguristi në Gjermani.

Zonja Finger prej vitesh mbante statusin e presidentes së shoqatës dhe në mbledhjen e vitit 2021 ia dorëzoi këtë detyrë Profesor Voss që u zgjodh president i ri i shoqatës. Zonja Finger ka një kontribut të jashtëzakonshëm në përkthimin e letërsisë shqipe në gjermanisht dhe promovimin e saj në vendet gjermanishtfolëse. Ajo përkthen me shumë dëshirë poezi, dhe parapëlqen poetë e prozatorë bashkëkohorë. Në cilësinë e zv. Presidentes ajo merret me organizimin e mbledhjeve, konferencave, konkurseve dhe aktiviteteve të shoqatës.

Këtë vit u paraqiten kontribute të shkëlqyera nga autorë tashmë klasikë te letërsise për fëmijë, e fitues të çmimeve te meparshme për letërsinë për fëmijë e të rinj si: Viktor Canosinaj, Shkelzen Zalli e Natasha Shuteriqi; po ashtu, u paraqit njohësi i meekullueshëm i zhanrit, Astrit Bisqemi dhe profesoresha Klara Kodra, një personalitet ne fushë të studimeve letrare, dalluar në krijimtarinë për fëmijë, sidomos për gjuhën e kulluar.

Tërhoqën vëmendjen e jurisë dhe u vlerësuan shumë në diskutimet e vazhdueshme, kandidatë si Rovena Rrozhani, Ana Tisi po edhe Vjollca Myftari, Aleksandra Pano e Hysen Kobellari.

Dallohen edhe tekstet e Jamarber Hoxhes, të cilat meritojnë vëmendje, përkujdesje e inkurajim të veçantë.

***

Fitues u shpall libri per fëmijë "Përrallat e Ana Tisit". Ky është një libër i bukur me përralla dhe ilustrime botuar me Shtëpinë Botuese "Dituria"- me autore Ana Tisin.

Ana Tisi është autore e dy vëllimeve me poezi që titullohen: "Të gjitha dashuritë", si dhe e "Fyellit magjik", një tjetër libër me përralla për fëmijë. Gjithashtu, parapelqen levrimin e tregimit per femije, tekste, te cilat, kjo shkrimtare i ka tashme ne proces botimi në shtëpinë botuese Dituria.

Libri fitues përmban përralla klasike dhe ilustrime, të cilat janë autentike, është shumë i këndshëm në tekst dhe figurë dhënë në një shqipe shumë të pastër dhe përcjellës i dashurisë njerëzore dhe universale.

Disa nga mendimet dhe kritikat mbi këtë libër po renditen më poshtë:

"Në këtë libërth të bukur janë fshehur një tufëz përrallëzash të cilatpresin për t'u zbuluar nga secili prej jush. Rrëfimi herë-herë I kapërcen rregullat "morfologjike të përrallës"; në ndonjë rast I respekton "mot-a-mot" ato, - por rrëfimtarja e përdor alegorinë si shkopin magjik për të ndërtuar botë këndjellëse imagjinare, duke mbajtur të gjallë karremin e misterit deri në rreshtin e fundit, përmes një gjuhe të latuar dhe të kuptueshme nga lexuesit e vegjël dhe me mesazhe të

fuqishme didaktike që dalin natyrshëm nga nënteksti. Duke i lexuar këto përralla, secili prej nesh zbret nga përmasa imagjinare e tekstit në realen e përditshme, duke reflektuar për disa konstante universal njerëzore si fuqia e dashurisë, falja, xhelozia, egoizmi i papërmbajtur,

smira apo babëzia.

Prandaj, unë do të rekomandoja patjetër që këto pjesëza magjike të lexohen çdo mbrëmje jo vetëm nga lexuesit e vegjël, por edhe nga prindërit, të cilët kanë shumëçka për të mësuar prej tyre, - përpara se vogëlushët të mbyllin syçkat, për t'u nisur më tej në botët fantastike të gjumit. Ky shtegtim, me siguri, do të jetë më i lehtë dhe më i bukur, duke e përndezur dhe vaditur mendjen e fëmijës tuaj me të tilla përrallëza kaq të bukura". (Dr. Albert Gjoka)

Përmes librit të saj, Ana Tisi na dhuron një tokë magjike, në të cilën bukuria dhe pastërtia janë ende të mundshme. Sepse, nga të gjitha gjërat që kalojmë në jetë, mbijeton vetëm ajo që transformohet në përrallë. Dhe përrallat e Ana Tisit, që pata rastin t'i lexoja para Krishtlindjeve, janë si një dimër i freskët, që më shumë ngroh se sa ftoh, që më shumë shkrin se sa ngrin, sepse gjithë kjo e bardhë e pastër që e ndieva, më ka mbështjellë si një përrallë dashurie, siç di të krijojë vetëm kjo autore e mrekullueshme. Dashurinë e mësojmë në familje dhe ky libër është një ilustrim i jashtëzakonshëm dhe prandaj, unë e lexova edhe si libër apo mësim pedagogjie.

(Oana Anca Mihaela Glasu, studiuese nga Rumania, albanologe)

Përralla dhe mistiçizmi është gërshetuar mrekullisht në këtë libër sa për një çast të duket vetja i katapultuar në një botë onirike ku çdo gjë frymon sipas një dizenjoje të gjetur në baulen e kujtimeve të pa kohë. Të jepet përshtypja se autorja është gjendur dhe ka folur vetë me personazhet para se t'i mblidhte e fuste në libër ku mjeshtri ka ditur t'i japë formë edhe ngjyrë.

Besoj se mbas leximit të këtyre përrallave lexuesi i vogël do të mbledhë lule mirësie për njerëzit e dashur në ëndrrat e veta. (Fatmir Gjata, shkrimtar)

Në këtë libër përfshihen pesë rrëfenja, shkruar me fantazi dhe intuitë, për të depërtuar jo vetëm në botën e lexuesit të vogël, por edhe te më të mëdhenjtë, janë si disa lëndina të gjelbëra çlodhjeje e pushimi, apo si disa kroje me ujë të qelibartë ku çdokush prej nesh freskon trupin dhe mendimet. Por mund ti krahasojmë rrëfenjat edhe si pesë valltarë të vegjël, që paraqesin me harmoninë e tyre të gjestikulacioneve e lëvizjes ,madhështinë e pakundërshtueshme të jetës.

Të pesë valltarët e përzgjedhur me sqimë nga Ana Tisi janë; " Përralla e vogëlushes Lea" që trajton shkaktimin e mërzisë dhe gjendjes depresive tek më të vegjëlit, kur midis prindërve ka zënka dhe mungesë dashurie. Valltarët e tjerë janë; " Përroi i vogël", " Princi i humbur", " " Legjenda e thesarit", kur njerëzit bien pre e lakmisë, dhe i fundit, " Vajza e liqenit të dritës" që vjen tek lexuesi si një nimfë e qenie e dritësuar, por

që për dashurinë pranon të humbë gjithë atributet e shenjta dhe përjetësinë.

Per librin, nuk kam fjalë, ilustrime të bukura, nga piktori Kujtim Murati, letër e kapakë të mrekullueshëm, një botim impenjativ dhe luksoz, që mban vulën e Shtëpisë Botuese " Dituria". Një gjini që, autorja në fjalë, duhet ta vazhdojë edhe në të ardhmen. Për aftësitë e saj të dukshme, për të qenë pjesë e sojit të shkrimtarëve për fëmijë.

Të pesë përrallat e përfshira, kanë një rrjedhje të natyrshme, fantazia ndërthuret më së miri me elementet e rrëfimit, fabula dhe gjetja artistike përforcojnë mesazhet që ato përcjellin, secila në vetvete.

Ndjen në çdo pasazh kënaqësinë e të shkruarit, përfshirjen emocionale të autores, futjes në një botë paralele me botën ku jetojmë, në një botë magjie, ku mrekullia, dashuria, mirësia, sundojnë universin, dhe bëhen shtysë dhe nxitje që gjithsecili prej nesh të përsosë vetveten, duke luftuar të keqen , urrejtjen, lakminë e padrejtësinë.

Në laboratorin e fshehtë krijues të Ana Tisit, kanë mbirë përsëri dhjetëra fidanë të rinj rrëfenjash, të cilët ajo po i kuron me dashuri , për tia dhuruar lexuesit të vogël, në botimet e saj të ardhshme. Përveç poezisë së saj, e përfshirë mes dashurive njerëzore dhe mistikes, ajo ndan me lexuesin edhe këtë pasion të hershëm për përrallën. E kush prej nesh në vegjëlinë e tij nuk u mahnit prej bëmave të çuditshme të heronjve të përrallave? E kush nuk ndjeu neveri për shtrigat e këqija që u shkaktonin fatkeqësi njerëzve? Secili prej nesh do kishte dashur të ishte një luftëtar i së mirës, të shprangoste bukuroshen e burgosur në kullë, të vriste ujqërit që vjellin zjarr nga goja, dhe u pengojnë udhën heronjve,të sfidonin bishat mitologjike si Cerberi e Minotauri, e t'iu jepnin njerëzve lirinë. Tek njëra prej përrallave të Ana Tisit, titulluar, " Princi i humbur"gjejmë pak a shumë diçka të tillë. Një princ i rrëmbyer që në lindje nga shtriga, por dashuria e motrave të tij dhe vendosmëria e tyre për ta kërkuar ,bënë të mundur kthimin e tij në shtëpi.

Por kemi dhe përrallën e përroit të vogël, që donte të bëhej lumë, dhe nuk e kuptonte, se në jetën e fshatit të vogël ai ishte më shumë i rëndësishëm dhe jetik ashtu si ishte, dhe jo si lumë i madh.

Pra, ashtu si pesë gishtat e një dore, këto rrëfenja, kanë unitet dhe së bashku formojnë një mozaik të larmishëm vlerash artistike. (Rifat Ismaili)

***

Ana Tisi eshte fituese e dhe e nominuar për disa çmime ne gjinine e poezise; veprimtaria e Ana Tisit eshte gjithashtu, promovuese e vlerave me te çmuara identitare shqiptare, pjese te pasurise kombetare, siç eshte ajo e autoreve te tradites.

Përrallat e shkruara nga kjo autore duket se udhëtojnë nga shtresat e vjetra të kulturave të popujve, prej gjirit të kohërave që s'mbahen mend deri te modeli i letersisë së shkruar në zemër të botës moderne ku jetojmë.

E veçantë dhe e vyer mbetet prirja për t'u takuar me fuqinë tonë të humbur e të harruar, esencialen e hershme, - e gjithë kjo duke përnaltësuar pafajësinë, nën një ndriçim të pafundmë metafizik.

Duke lexuar përrallat e Ana Tisit, ndodh përfshirja në një përvojë njohëse, shpirtërore e shpëtuese në shprehjen e aspekteve më të thella e misterioze të ndjeshmërisë së natyrës njerëzore për të kuptuar më mirë qenien tonë në botë, marrëdhënien me Krijuesin e për të mbetur deri në fund të rrugëtimit të virtytshëm e punëmirë.

MOSKUPTIMI I SHKRIMTARËVE GJENIALË. RASTI KADARE

Nga Bujar Skendo

1.

Është pranuar prej kohësh se gjëja më e keqe që mund t'i ndodhë një gjeniu është t'a kuptojnë tërërisht që në botimin e parë të veprës të tij. Në një rast të tillë, mjerisht, do kishim një shkrimtar thjesht të përkoshëm, lehtësisht të kuptueshëm, të kufizuar, të harrueshëm. Kurse gjeniu është shkrimtar i të panjohurës e i të paarritshmes. I dendësisë së pafund të ideve dhe thellësive të pakapshme të mendimeve. Është një shkrimtar i përjetshëm.

Me shkrimtarin tonë gjenial Ismail Kadare ka ndodhur diçka edhe më e ndërlikuar. Për herë të parë në historinë e letërsisë shqiptare kishim një shkrimtar të jashtëzakonshëm, vepra gjeniale e të cilit është admiruar nga lexuesit e tij të shumtë. Por edhe është moskuptuar, keqkuptuar, keqinterpretuar, keqtrajtuar prej diktaturës. Armiqësisht, me këmblëngulje, vetëdijshëm. Kurse kritika është treguar krejt e paaftë për t'u përballuar me veprën kadareane. Siç rrëfen vetë Kadare, për një dyzinë të librave të tij të famshëm, "nuk është shkruar asnjë reçension"! Një njollë e zezë në kulturën tonë! Mëkat i pashlyeshëm! Dhe në rastet kur është shkruar, vetëm sa është prekur ana e dukshme e vlerave të tij artistike. Dhe po ashtu, vetëm idetë e mendimet e përvijuara vetëm në shtresëzimin e parë të veprave. Nuk është tentuar aspak zbërthimi në thellësi i ideve e mendimeve të mëdha të shkrimtarit gjenial. Nga paaftësia? Nga konformizmi? Nga frika? Ndoshta nga të tria. Nuk është kuptuar, pothuajse asnjëherë, çfarë fshihej më në thellësi, çfarë mendimesh vlonin brenda, poshtë fjalëve, fjalive, paragrafëve dhe, afërsisht, 40 mijë faqeve të shkruara nga shkrimtari ynë gjenial. Nuk janë zbërthyer eflektimet e dyfishta apo të shumëfishta të artit të tij. Në atë kohë, kjo ka qene sa përfytyrueshme, e shpjegueshme, aq edhe e papërfytyrueshme, e pafalshme. Veçanërisht kur bëhet fjalë për një krijimtari gjeniale si ajo e Kadaresë.

Njerëzimi, çdo gjeneratë, çdo shekull kërkon e gjen në veprat gjeniale përgjigje për shqetësimet e kërkesat e veta, zbulon ato ide për të cilat ka nevojë e është i etur. Sepse veprat gjeniale ashtu janë, një det i pafund e i pashtershëm idesh e formash artistike.

Ana e pakuptueshme e veprave gjeniale nuk ka asgjë të përafërt me pakuptueshmërinë e veprave hermetike, të errëta. Këto janë konceptuar si të tilla, të vështira për t'u kuptuar, të vetëdënuara për moskuptim. Dhe ashtu mbeten, fatkeqe, të ftohta për lexuesin. Ngarkesa me ide filozofike, fshehja e tyre si qëllim në vetvete, është krejt tjetër nga arti gjenial, nga thellësia e pambarimtë e ideve e mendimeve, nga shprehja e ideve të mëdha, preokupuese për njerëzimin, me një gjuhë thjeshtësisht madhështore.

2.

"The New Folger Library Shakespeare" në Washington, e themeluar në vitin 1932, botimin me të fundit akademik e ka bërë në vitin 1992, 35 vjet pas atij paraardhës. Një botim serioz, i pajisur me aparat të pasur analitik, spjegues, argumentues, zubulues idesh e vështrimesh të kohëve moderrne. Në fjalën hyrëse, drejtori i saj Werner Gundersheimer thekson se "pasioni për Shekspirin vazhdon të rritet". Asnjë shkrimtar tjetër, shton ai, nuk flet më fuqishëm për qenien njerëzore, në tërë format e shfaqjes së tij. Është koha të zëvendësojmë botimin e mëhershëm me një version të ri tërësor, i cili përfshin mendimin aktual më të mirë dhe më bashkëkohor për tragjedinë "Makbeth".

Kurse editorja Barbara A. Mowat, në parathënie nënvizon se botimi është konceptuar "për një gjeneratë të re lexuesish dhe feflekton mënyrat bashkëkohore të të menduarit për Shekspirin".

Në kapitullin "Shakespeare's Macbeth" shkruhet se "Në shekujt e mëhershëm historia e Makbethit është parë si një qëndrim i fuqishëm i një njeriu heroik i cili kryen një veprim të lig dhe më pas paguan një çmim të tmerrshëm, ndërsa ndërgjegjia e tij dhe forcat natyrore të të mirës e shkatërrojnë atë". Dhe menjëherë, pas kësaj theksohet se "Në shekullin tonë, linja midis të ligës së Makbethit dhe të mirës së supozuar të atyre që e kundërshtojnë atë është e turbullt, shprehen qëndrime të reja mbi shtrigat dhe magjitë, pyetje të reja ngrihen për mënyrat si janë portretizuar burrat dhe gratë në këtë vepër". Për të përfunduar, "Midis kaq shumë dramash të Shekspirit, "Makbethi" i flet çdo gjenerate me një zë të ri"...

Kështu ecën nëpër shekuj tragjedia gjeniale "Makbethi" dhe vetë Shekspiri. Trazues, nxitës, turbullues, provokues, qartësues. Minierë hyjnore idesh e mendimesh të thella. Edhe pse është botuar e ribotuar mijëra herë në pothuajse të gjitha gjuhët e globit, njerëzimi i kthehet e rikthehet Makbethit për artin superior dhe idetë e fshehura, por të domosdoshme për t'u zbuluar e shijuar estetikisht. Edhe pse Shekspiri ka pesë shekuj nën tokë, nëpërmjet veprës së tij gjeniale ai jep e merr mesazhe me të gjallët, vazhdon të trokasë në ndërgjegjen e njeriut dhe të njerëzimit. Vazhdon të nxisë, të frymëzojë e të dërgojë dritë hyjnore edhe prej errësirës së përjetshme.

Në kulturën tonë nuk kemi pasur ndonjë përvojë në ribotime të tilla me synime e theksime të caktuara idesh e mendimesh. Thesht sepse deri më sot nuk kemi pasur ndonjë shkrimtar gjenial. Dhe kemi bërë ribotime të zakonshme, sipas koronologjisë. Gjeneratat që vijnë, me Kadarenë, do kenë rastin e provës. Do të duhet të bëjnë ribotime me një aparat të posaçëm vlerësues, me kërkime e zbulime idesh për të cilat shoqëria do jetë e interesuar...

3.

"Unë jam krenar që e kam shkruar këtë vepër (është fjala për romanin "Koncerti"-bs). Është botuar kudo në botë, por pa atë zbërthimin e vërtetë që duhej të kishte", është shprehur shkrimtari ynë gjenial Kadare. Është fare e qartë se ka një peng në këtë pohim, që, ndoshta, është peng i të gjithë gjenive dhe që, me sa duket, lind prej tundimit që veprat e tyre të zbërthehen në tërë madhështinë artistike dhe thellësinë e ideve që ato përmbajnë, qysh kur ata vetë janë gjallë.. Shkrimtarët gjenialë digjen së brendëshmi nga dëshira që lexuesit e tyre të përjetojnë ato mrekulli e magji që ata vetë i kanë ndier gjatë procesit të të shkruarit. "Koncerti", duke qenë një kryvepër, është analizuar, zbërthyer e vlerësuar nga kritika perëndimore. Por, sërish, pengu i shkrimtarit për moskuptim, mbetet. Dhe ndoshta do jetë i tillë për një kohë të pambaruar. Sepse ky është ligji që shoqëron veprat gjeniale. Çdo gjeneratë e çdo shekull kërkon e gjen në këto vepra ato përgjigje, ide për të cilat shqetësohet. Ato mendime që e ndihmojnë për të kapërxyer krizat që e mbajnë të mbërthyer mendimin njerëzor të kohës.

Jo rrallë shkrimtari ynë gjenial duket se është trembur nga moskuptimi i ideve të mëdha të veprave të tij dhe herë pas here ka nxituar të zbulojë vetë disa prej ideve të thella, të pazbuluara si prej kritikës, të pakapshme prej saj, ashtu edhe prej lexuesve të një gjeneratës së tij. Vetë Kadare i është kthyer e rikthyer romaneve të veta duke theksuar ide qëndrore apo edhe periferike. Në librat e tij eseistikë "Ftesë në studio", "Nga një Dhjetor në tjetrin", "Pesha e kryqit", në intervista dhe në botime të tjera ai ka qartësuar shumë nga idetë e mëdha që përshkojnë romanet e tij, të cilat kanë mbetur të pazbërthyera nga kritika. Përveç të tjerash, për arsyen e thjeshtë se ato kanë qenë të veshura me mjeshtëri artistike. Dhe, sidomos, kanë qenë të vendosura në thellësi të veprës. Aty ku errësira është më e dendur, zymtësia më zotëruese, krimi, vrasja është më e pranishme. Dhe, sigurisht, mjeshtëria artistike më e lartë. Kështu ndodh të "Përbindëshi" dhe sidosmos te "Dimri i vetmisë së madhe", "Koncerti" e te "Pallati i Ëndërrave". Dhe po ashtu, te "Pasardhësi", "Vajza e Agamemnonit", "Hija" ... Pothuajse në çdo roman të tij. I tillë është tërë korpusi i veprave të Kadaresë.

Vepra "Kohë e pamjaftueshme" e Helena Kadaresë, shkrimtare dhe bashkëshorte e fisme, me informacionet që vetëm ajo i dinte dhe që janë, por edhe nuk janë, të pranishme në romanet e Kadaresë, ka ndihmuar në zbulimin e shumë ideve të fshehta, të mbuluara nën pasurinë e pafundme të stilit, të artit romanesk të gjeniut. Copëza bisedash, sinopse, fjali, emra, vargje, ide, kriza, thënie, detaje, frikëra, ankthe dhe, sigurisht, zhgënjime, armiqësira, revolta, shfrime, përbetime, frymë kryengritëse, guxim, humor asgjësues... Jeta reale dhe jeta artistike e gjeniut Kadare. Të dyja madhështore, unikale. Sikundër thekson botuesi francez, "këto kujtime dëshmojnë drejtpërdrejtë mbi kompleksin e "punës së laboratorit" në të cilin është përpunuar vepra e Kadaresë". Për të vijuar me thënien se "kjo kronikë e gjerë dhe e pasur, lexohet si një roman aventurash e pasionesh të atillë, që ngjallin dhe frymëzojnë dashurinë për artin dhe për lirinë".

Mund të shtonim vetëm se ky "roman" i Helena Kadaresë, i shkruar me një gjuhë të pasur artistike dhe stil elegant, përmban, gjithashtu, një pasuri të pafund idesh e mendimesh të cilat ndjekin e zbërthejnë shumëçka nga kryeveprat e gjeniut, nga jeta dhe mendimet e tij jashtë e brenda veprës. "Kohë e pamjaftueshme" e Helena Kadaresë është gjithashtu një kryevepër më vete.

Dilema apo edhe zhgënjimi i Kadaresë për kuptueshmëri të paplotë të ideve të veprës, mendimeve të saj të mëdha, të thella, por të fshehura e të mbështjella me art të madh, ndoshta, nuk do shërohen asnjëherë. Sepse te ky mosshërim fshihen vlerat universale, të gjithkohëshme të kryeveprave. Për Kadarenë ka qenë e pamundur të shkruante "gjëra që nuk kishin mister, që nuk kishin atë tërheqjen e fshehtë, që nuk kishin mjegull t'i mbështillte"... Veprat e mëdha, siç janë romanet e Kadaresë, kanë shumë mister brenda vetes, shumë të fshehta turbulluese. Dhe shumë zymtësi, ankth, frikëra të errëta. Ai e kërkon me vetëdije këtë mister dhe, ndoshta, ndonjëherë edhe është shtangur prej tij. Vështrim të shumëfishtë të detajeve, thellësi interpretimi dhe mendimi njerëzor. Dhe, sigurisht, shumë art, shumë madhështi artistike... Ky, me sa kuptohet, është arti gjenial dhe ky është, po ashtu, fati i tij. Të jetë tërheqës për shumë gjenerata e shumë shekuj. Dhe kjo nuk mund të ndyshojë.

A është e mundur dhe a është e domosdoshme që tërë këto margaritarë të zbulohen menjëherë? Përvoja dëshmon se nuk është as e mundur dhe as domosdoshme. Veprat gjeniale janë projektuar të jenë të vlefshme për shumë gjenerata dhe shumë shekuj. Ndaj shpesh kanë krijuar përshtypjen se shkrimtarët gjenialë lindin para kohe, lindin në shekullin e gabuar...

Pamundësia për të interpretuar e zbërthyer tërë madhështinë dhe thellësinë e një vepre gjeniale është diçka normale. Gjeneratat kërkojnë e gjejnë në të, atë për të cilën kanë më shumë nevojë, atë që u jep përgjigje pyetjeve të tyre themelore, mëdyshjeve të tyre dhe të epokës së tyre. Gjenerata e shekuj të tjerë do kërkojnë e do gjejnë të tjera ide të madha, në të tjera shtresëzime të shumëfishta të veprës.

Shkrimtarët gjenialë trajtojnë problemet e mëdha të njerëzimit. Ata paralajmërojnë rëniet e epokave dhe të diktaturave. Këtë bënë Dante, Shekspiri dhe Servantesi në kohët e tyre. Po ashtu, Hygo, Gëte e Gogol... Të njëjtën bëri edhe Kadare me diktaturën komuniste. Romanet gjeniale si "Dimri...", "Koncerti", "Përbindëshi" e "Pallati ...", "Vajza e Agamamnonit", "Piramida", "Pasardhësi" e të tjerë, janë vepra komplekse, të thella, përplot zymtësi shekspiriane, tmerre, hije, vrasje pas një darke makbethiane, tradhëti. Tragjedi e madhe dhe grotesk i pamëshirtë. Diktatura komuniste, me një ligësi në thelbin e saj dhe diktatorët groteskë të saj, të zbuluar në tërë shëmtinë e tyre, në tërë krimet e tmerret e tyre planetare. Ajo lindi nëpërmjet krimit, u rrit dhe u rrëzua, po nëpërmjet krimit të stërmadh. Siç ndodh, pak a shumë, me diktaturat dhe diktatorët nga një shekull në tjetrin, nga një kontinent

në tjetrin. Romanet e Kadaresë nuk kanë të krahasuar në zbulimin dhe përshkrimin e madhërishëm të çarjes së perandorisë komuniste, të nisjes së rrënimit të saj. Me romanet e tij Kadare e kishte goditur komunizmin mu në qendrën e tij, në zemrën e vet perandorake. Në thelbin e krimit të tij. Përleshja e gjeniut me diktaturën ishte madhështore. Prandaj edhe hakmarrja e saj do të ishte e përbindshme. Moska komuniste "nuk do e lejonte as për njëqind vjet botimin e veprave të Kadaresë" në kryqendrën e vet.

4.

Gjeniu është një shkrimtar i domosdoshëm, i projektuar nga Krijuesi për vepra të madhërishme, universale. Një shkrimtar gjenial për tërë njerëzimin dhe për shekuj të tërë. Një shkrimtar që ka aftësinë dhe guximin të depërtojë në zonat më të errëta të shpirtit dhe të mendjes së njeriut e të njerëzimit. Një shkrimtar- gjeni lind i tillë. Gjenialiteti nuk krijohet, siç pandehet më kot. Nuk mësohet në jetl dhe as në shkollë. Nuk është thjesht këmbëngulja që e bën gjeniun. Në radhë të parë është fryma hyjnore, fuqia supreme që "zbret" në trurin e tij. Kadare pranon se "ka vërtet "diçka" që vjen nga lart, por sa herë njeriu kërkon ta shpjegojë këtë gjë, nuk e gjen dot"... Gjeniu është i pangjashëm. Është unikal. Ngjason vetëm me "rracën" e gjenive.

Çdo qytetërim lind gjeniun e vet. Shkrimtarët gjenialë paraprijnë e "përmbyllin qytetërime", thotë Viktor Hygo në librin e tij gjenial për Shekspirin. Hapin apo vulosin kaperximet e mijëvjeçarëve, bashkë me enigmat, misteret, konfliktet. Tamam, atëherë, kur njerëzimi gjendet befas në kryqëzimin e epokave dhe kërkon me dëshpërim zgjidhje të mëdha për fatin e vetvetes. Jo çdo shekull lind domosdo gjeniun e tij. Sikundër ka edhe shekuj të veçantë që lindin më shumë se një gjeni. Dante tronditi shekujt e trembëdhjetë e katërmëdhjetë me veprën gjeniale "Ferri", Shekspiri dhe Servantesi dominuan shekujt e gjashtëmbëdhjetë e shtatëmbëdhjetë. Pastaj vjen Gëte, "njeriu i fundit që i dinte të gjitha", në shekujt e tetëmbëdhjetë-nëntëmbëdhjetë. Dhe Viktor Hygo,"njeriu oqean" në shekullin e nëntëmbëdhjetë, i cili me veprat e tij të mëdha ndau epokën e absolutizmit me erën e republikanizmit...

Shekulli i njëzetë lindi Kadarenë që me gjenialitetin e tij lajmëroi rënien e diktaturës komuniste, ndoshta më e përbindshmja e tërë diktaturave.Vepra e tij ushton nga dendësia e mendimeve që ndryshojnë botën. Dhe, po ashtu, nga tërbimi njerëzor. Truri i tij nuk ishte një tru i zakonshëm. Ishte një tru i gjithbotshëm. Pothuajse tërë truri i njerëzimit i përmbledhur në një të vetëm. I dendur, tërë intensitet. Zemra e tij është mister që rreh lehtësisht e, po aq, edhe madhërisht, vrullshëm, rrëmbyeshëm. Ajo nuk ishte një zemër e dosido. Ishte një zemër universale. Gjithçka te Kadare ishte trubulluese.

Arti i Kadaresë nuk njeh kufizime hapësire e kohe. Nuk njeh as kufij qiellorë, as tokësorë. Dhe as kufij skëterrorë. Kadare nuk stepet përballë të ligës, diktaturës, sado e përbindëshme ishte. Ai nuk u ndal as përpara veseve njerëzore, sado të fshehta dhe të thella të ishin. Përkundër sulmeve, intrigave, ndalimeve, ai nuk u tërhoq asnjë pëllëmbë nga fortesa e tij përplot gjetje artistike e thellësi mendimi. Siç nuk nguroi aspak të zbulonte të mirën, të mbronte liritë njerëzore, të drejtat humane. Madje i himnizoi të tëra ato. Pafundësia dhe e pakufijshmja, zbulimi, hamendësimi, e panjohura, e pamundshmja, fantazma dhe hijet, ëndërrat, pengimi, mëdyshja.., ishin elemente artistike të arsenalit të këtij gjeniu.

Nuk është aspak e rastësishme shfaqja e tij në kohën e krizës më të madhe njerëzore të shekullit të njëzetë. Kur liria dhe e vërteta u nëpërkëmbën, u përgjakën. Kur shtypja dhe dhuna e diktaturës komuniste nuk njohu asnjë kufi. Në këtë kohë të zymtë, plot tmerr e frikë lindi ky shkrimtar gjenial, ky gjigand i mendimit njerëzor... Dhe në vetminë e tij prej "murgu në thellësi të manastirit", siç e përcakton ai veten, krijoi veprat e tij gjeniale...

Vëzhgim mbi librin "Kratere njerëzish" të tregimtarit Ballsor Hoxha

Ballsor Hoxha është zë unik që vjen drejt lexuesit

Nga Flurans Ilia

Në kryeradhë bri këtyre shënimeve për librin «Kratere njerëzish» (Buzuku, 2024) të autorit Ballsor Hoxha na duhet të pohojmë se mënyra e rrëfimit dhe trajtimi i tregimit nga ky autor është i veçantë, befasues, i pasur në shtresa dhe nënshtresa kuptimore dhe ndërtimore, jo vetëm në përshkallëzimin gjuhësor dhe analitik të mënyrës se si ky tregimtar e trajton gjuhën e tregimit, por më gjerë, zhvendosjes korrekte të kësaj gjinie të letërsisë në rrugëkalime të reja, çka përbënë një prurje dhe mëvetësi për vet letërsinë.

Është e vështirë të kanalizosh shtratin e «Kratere njerëzish» si një libër që bënë pjesë në një rrjedhë të caktuar lineare rrëfimi. Sepse libri i Ballsor Hoxhës është si ata lumenjtë që burojnë nga brendia e mistershme e qenies. Vjen rrëmbyeshëm dhe gjen shtratin e vet natyror shtruar-shtruar drejt lexuesit. Në të njëjtën kohë kur ky i fundit, mendon se ka gjetur drejtpeshimin e duhur, rrëfimi i autorit ndërron shtrat, tejkalon lexuesin me një forcë mbinatyrore që vetëm një letërsi e mirë është e aftë ta bëjë duke i folur njeriut në atë çka ai ka më të qenësishme, më të fshehur e fashitur përmes traumave dhe plagëve, shkruar me analizë korrekte pa humbur asnjë fije nga qëndisma artistike e rrëfimit.

Gjendemi ballas "kanioneve" të papritura të subjekteve të tregimeve, të cilat shndërrohet dhe marrin brendi analizash psikologjike me një vërtetësi tronditëse madje edhe në aspektin historik. Çka e bënë lexuesin e Ballsorit një ndijues, dëgjues, nuhatës, shikues, perceptues shqisor. Lexuesi i «Kratereve» në mos po nuk është, në mos po duhet të jetë, më e pakta duhet të bëhet një eksplorator i të tjera nivele leximi duke e futur në atë çka i jep të drejtën këtij lexuesi të marrë mbi shpatulla barrën e rëndë investiguese të tekstit. Kjo është ajo që befason në tregimet e Ballsor Hoxhës i cili, të vendos përpara jo një formë soditëse, përshkruese, panoramike, por një gurrë të rëndë lidhur pas qafe që tërheq çast pas çasti, tregim pas tregimi, thellë e më thellë, ndërmjet të tjerash, për të prekur thelbin e çështjes se çfarë është letërsia ndërkohë? Autori e ka kuptuar këtë fenomen ndërlidhës midis jetës reale dhe magjisë së krijimit si formë e epërme e të shprehurit dhe e ka shndërruar në një fenomenologji që e ka përshtatur sipas përmasave të tij si shkrimtar, çka mendoj se përbën një arritje. Kjo nuk është pak, do të thotë vetëdije krijuese. Një artist i vetëdijshëm për atë që bënë ka aftësinë nëpërmjet teksteve të tij të rrezatoj atë lloj drite drejt lexuesit e cila ngelet për një kohë të gjatë si pikë referimi duke hyrë kështu te nevoja e një leximi të dytë, apo shfletimi të herë pas hershëm të librit.

Ne nuk jemi ende në gjendje të themi se çfarë ecurie do ketë fati i librit të tij. Sepse është herët ta themi këtë. Por ama ndijojmë risinë e këtij autori. Prurjen e mirë me të cilën Ballsori gatuan përmes një gjuhe të kultivuar artin me mënyrën më sqimatare të mundshme. Njësoj si ata mjeshtrit e vjetër shekullarë që i mbijetojnë kraterit post modernist të unit bombardues qysh pas ditës së parë të një tragjedie, lufte, apo katastrofe natyrore, e thënë kjo në kontekst të drejt për drejtë me rolin e letërsisë dhe njeriun e parë si fitues, si viktimë, si bashkëpunëtor, si personazh, si aktor dramatik, të fajësuar, absurd, si akt i veprimeve të veta në shkallë sociale, lokale, akoma më gjerë. Njeriun vragë të përshkallëzimeve dhe konflikteve të dhunshme ndëretnike dhe sociale si është rasti konkret i Kosovës. Njeriun e lirisë të prangosur të katër mureve të një kafeneje ku zhvendoset liria e fituar si objekt vëzhgimi. «Krater njeriun» që vëzhgon imtësisht krateret ende të hapura në sytë, gjokset, mendjet e të si ngjashmëve të vet njësoj sikur të ishte një banues i hershëm i tragjedive të Eskilit dhe Sofokliut, «veshur me diell e mbathur me hënë» si ne epos dhe legjenda, mbathur me «mantelin beketian» të pritjes absurde. Të një pritjeje të lodhshme, të stërzgjatur. Të gjitha këto, lexuesi i ndijon si pjesë të pa ndashme të anatomisë morale. Sigurisht, nëse morali e ka një trup, apo është në vetvete një «objekt i vëzhguar fizik». Këtu qëndron edhe një tjetër prurje e këtij autori e cila duhet theksuar. Duke vëzhguar me imtësi "moralin" e "njeriut modern", format e tij të rrëfimit shndërrohen në fenomenologji të vëzhgimit si objekt në vetvete brenda vetes për këtë autor. Lexuesi fillon dhe sheh veten të projektuar poshtë një skaneri gati Eutopian do thosha, ku shihet dhe kryesisht fotografohet zemra e njeriut dhe problemet e saj (Të trashëguara apo të sotme? Vështirë të thuhet.) Frymët tona me të cilat mbartim ajrin e përbashkët të Prishtinës dhe Tiranës, apo Ballkanit. Truri dhe gjymtyrët me të cilat lëvizim drejt njëri-tjetrit. Muskujt e të shkuarës, së tashmes, edhe të ardhmes drejt kontinentit mëmë. Të gjitha këto ndërsa lexoja "Kratere njerëzish" rrezatuan si të thuash te unë si lexues jehonën dhe trajtat e ideve të More, Campanella, Bacon dhe Montaigne. E dëshmoj me sinqeritet se rrallë më ka ndodhur kjo ndërsa lexoj gjini të shkurtra të cilat për nga hapësira e kufizuar e tekstit nuk ta lejojnë këtë "luks" rrezatimi.

I shpreha ndoshta këto me një gjuhë të stërholluar që mund ta kisha shmangur. Por e ndjeva detyrim pas leximit të librit. Mundet të kisha thënë në mënyrë krejt sipërfaqësore atë çka rrjedh në syprinën e subjekteve si ndodh rëndomtë mes nesh dhe autorit. Por nuk e bëra sërish për hir të respektit që ngjall ky autor. Në dukje i vështirë, por i ndjeshëm ndaj detajeve shumëngjyrëshe. Autoritar në gjykim po aq sa i dedikuar ndaj tregimit që rrëfehet me disa linja paralele që kryqëzohen me të tjera linja duke krijuar atë tablo të kuqeje dhe të zeze që mbijeton në tërësinë e saj veç prej dinamikës natyrore që mbart karakteristika e këtij tregimtari. Një portretizim personazhi në sfondin e të cilit valëvitet një tjetër sfond blu qëndisur me yje të verdhë ardhmërie e cila na flet vertikalisht me të njëjtën gjuhë që flet e tashmja jonë e përbashkët.

Ballsor Hoxha është zë unik që vjen drejt lexuesit të tij me artin si urtësi, si maturi dhe si kulturë evropiane. Vjen me forcën e një rezistence ekzistenciale në tonin e vet si qytetar i lirë. Kjo falë letërsisë që ai bënë qysh prej një dekade në vazhdimësi në nivelin e dikujt që e dashuron këtë art. Sepse është pjesë e botëkuptimit të tij. Rruga për të mbërritur gjer këtu, kërkon mund, përpjekje, sakrifikim dhe mbi të gjitha sinqeritet. Sinqeritetin e të qenit vetvetja. Ballësor Hoxha është vetvetja, si autor edhe njeri. Vetëm kështu kapërcehet sprova, e pse jo qoftë edhe nëpërmjet letërsisë, si pasqyrë e zhvillimit moral të individit.

(Mendime, opinione dhe analizë rreth vëllimit poetik "Këngët e Babës" të Autorit Bislim Ahmetaj)

Ati si perendi, si gjest, si autoritet, si dashni dhe mall

Nga Mark Simoni

Kur del prej librit "Këngët e babës" dhe e lëshon nga dora, ndjenë se qënia jote të është ngarkuar me imazhe dhe emocione, situata impresionante dhe subjekte poetike interesante, gjendje estetike të veçanta dhe me një letërsi karakteriale të fuqishme. Bislim Ahmetaj e ka urbanizuar librin e tij në pesë blloqe të mëdhenj, secili jo vetëm i dallueshëm prej tjetrit, por që, edhe në vetvete është një univers i plotë, është nukli i një libri. Nga vetë titujt e kapitujve lexuesi kupton temat e harlisura të poezisë së këtij autori, larminë dhe premisën për t'i dhënë letërsisë së tij dimensionin universal. Megjithëse poezitë e përmbledhura në cikle, kanë një target të caktuar, ato asnjëherë nuk bien në situata monokrone, apo të jenë pjesë e stërgjatur e njëra tjetrës, por kanë dinamika, ngjyra, trajtesa, krejt të mëvetshme dhe origjinale, çfarë i japin këtij libri shije të mirë leximi.

"Fluturime të çmendura" në ciklin e parë, ku të impresionon shumë mardhënia e poetit me natyrën, me elementët dhe hapsirat e saj, si një ndërgjegje krijuesee mbushur me detaje jete dhe energji lëvizje. Madje ai stilizon aq bukur me subjektet e natyrës, motit, gjeografisë, hapsirës dhe qiellit, që nga elementët më të vegjël e të brishtë dhe deri tek ato rropama dhe tramundana tronditëse që lenë gjurmë të pa shlyeshme. Retë me qumësht zanash / Fole rrufeshë / Yjet mbledhur në një krozhë / Zogu ithnak / Bisedë me diellin / Hëna ma gjeti shtëpinë / Udhëtoj detrash, janë ndjenë që kanë po atë energji që të jep vetë natyra me dimensionin dhe potencën e saj. Po në këtë cikël dallohet ai nerv shqetësimi, që poeti e ka të tejshkuar pothuaj në të gjithë librin, si një element karakteri dhe bosht ekuilibri. Poezitë kanë shumë grintë, janë të prera, të shkruara pothuaj në mënyrë të drejtpërdrejtë, gati telegrafike dhe me një saktësi matematike, ku dallohet gishti i akuzës së poetit për ngjarje dhe fenomene që kanë sëmurë shoqërinë, e kanë kthyer vendin në një limonti pasive dehëse dhe pa asnjë shkëndi revolte. Poezitë "Ti bija ime", "Në linjën Londër Tiranë", "Zoti Mister" etj. e kanë këtë matricë shqetësimi.

"Qyqet e qytetit të qyqanave" titullohet cikli pasardhës, i shkruar me një aliteracion impresionant, ku mbi kokën e tërë botës ndjenë vajin e qyqeve, pikërisht se njerëzit e qytetit janë vetë Qyqana. Duket se këto qyqe dhe qyqana e kanë përcaktuar destinin dhe fatin e tyre dhe të gjithë qytetit. Funebre ato tri "Qy"-të, që hapin fjalët e titullit. Kjo dorë poezishë e këtij kapitulli ka një stil tjetër të shkruari nga poezitë e më parëshme. Janë Etyde, shkurtica, postulate, blice, definicione poetike, për të ardhur pastaj tek poemthi "I trishtë" që është ndër tekstet më të bukur që ka libri. është një kantatë e kënduar bukur dhe dhimbshëm, mbushur me detaje egzistenciale, është një ditar me mikrosubjekte shumë interesante, të shkruara me dhimbje dhe nostalgji, me një penel të zhdërvjelltë, që i jep tablosë dimensionin real të kohës nëpër të cilën ka udhëtuar Poeti. "Nuk shihnim më larg se maja e këpucëve tona, Dhe maja e këpucës qe përherë e grisur. / Kur fjala bënte mort, dhe në mort s'të vinin as kushërinjtë e parë. / Kur ishte e natyrshme pyetja A ke pasë lugë kosi për ato fëmijë? / Ishte luks frigoriferi, dhe mbasi nuk kishe çfarë të fusje në të, nënat tona të ngrata i përdornin si "dollap" dhe fusnin brenda pakot e ushqimeve. Dikund në lexim hasim këto vargje:

"Qyqja e qytetit tim vajton,
shumë më dhimbshëm,
Se qyqja e qytetit tënd... " Sa trishtim i shkruar krejt bukur, vajtim i krahasuar, qyqet e qyteteve të ndryshëm, zezonë tjetërsoji. Apo dikund tjetër vargje impresionante:

"Natën e kalojmë,
Me termetin e palosur nën kry".

çfarë simbolike, ankth i shkruar në tërë dimensionin real, por me një elegancë poetike të veçantë. "Bankomati dridhej dhe hungërinte si një kalë i egër". Apo "Duart tona në xhepat bosh, dhe atje numronim vetëm gishtat nga njishi deri në pesë".

Elegji e thekur dhe plot dhimbje e trishtim poezia "Mbrëmë ra dhe gjethja e fundit", shkruar me nota të mugëta, me nota si te marrshi funebër i Shopenit, çka na tregon ndjeshmërinë njerëzore të Autorit të librit. Po kaq dhimbje dhe butësi ka dhe në poezinë "Jetimja", shtëpia e së cilës nuk ka mure, por është vetëm një çantë e grisur, e ngarkuar në krahët e saj thatim.

Këto lloj poezishë i japin librit shumë sendiment, përkorje, delikatesë dhe e bëjnë përherë dhe më të fisëm.

Në ciklin e tretë "Për dashurinë nuk gjej tituj" kemi mardhënien e autorit me një prej ndjesive më të shenjta të njeriut që është dashuria. Në këtë hapsirë të pamatë poetike ndjehet sentimentalizmi, hareja, lumturia, ndjenja, mardhënia, shkruar shumë bukur estetikisht, në mënyrë shumë të hijshme dhe të këndshme. Janë të gjitha pa tituj, si letrat e dashurisë që s'kishin krye, si një letërsi epistolare, plot dhimbje dhe hove zemrash, figura fine dhe fragile, të hajthme dhe plot ngjyra si vetë argumenti jetësor dhe poetik.

I katërti cikël titullohet "Qytetet e atdheut tim", që megjithëse është një ditar poetik i një udhëtari të ndjeshëm dhe vështak, është shumë interesant për nga gjeografia e qyteteve, për nga profili i veçantë i secilit, dhe se si Poeti e pozicionon dhe e ndjenë çdo qytet që viziton. Por, regjistri i revoltës dhe dhimbjes, që ky autor e ka të dallueshëm edhe në kët tufë poezishë, shprehet me poemthin"Në qytetin e Lasgushit" që është një uverturë repekti, dhimbje, një gjendje nokturne, e shkruar me shumë sens mase, me një harmoni mes figurës së Lasgushit, qytetit dhe gjendjes.

"Këngët e babës" mbyllin librin. Tashmë sipari është gati të bjerë. Këto poezi megjithëse të shkruara me elementë të thjeshtë, njerëzor dhe egzistencial si (Mustaqet e babës, Baba në spital, M'ka pasë thanë baba, Kur vij në Hamallaj etj.) kanë atmosferë të epërme, gati hyjnore. Babai si një perendi, biseda të bukura si mes kreshnikësh, të vendosur herë herë në peisazhe alpine, Në poezinë "M'ka pasë thanë baba" kemi patjetër një poemë syshë, vështrimet si mardhënie, si lojë, si emocion, si komunikim. Në "Im atë qe burrë fisnik" kemi shumë art rrëfimi, shkruar me një filozofi të thukët, dhe me kundrapunkte.

"Im atë ishte burrë esnaf,
S'pat shumë pare...
... Por gjithmonë vishej bukur

Burrë i pashëm,
Por kurrë si vu në siklet gratë që e adhuronin

E dinte sa vlente,
Ndaj kurrë se shiti veten..."

Këto, dhe mjaft vlera të tjera që ka në mes rreshtave ky libër, më bëjnë të mendoj se botimi i tij është jo thjeshtë dëshmimi i një letërsie të realizuar, por mbi të gjitha që, letërsisë së vargut shqip i vjen një tekst serioz, i bukur, ambicioz dhe pretendent, që e pasuron bibliotekën tonë të letërsisë.

Mustaqet e Babës

Folëm me babën për katund e për fis,
për hoxhë, për dervish e për prift.
Folëm me babën
për mbretëri, komunizëm dhe demokraci,
folëm me babën
për Ukrainë e Rusi,
për Amerikë e Kinë, për Afganistan e Siri.
Dikur vonë, kur fjalët na u fikën,
u pamë në heshtje sy ndër sy.
Sytë e mi u rrëzuan
e fjetën mbi mustakët e tij ngjyrë gri.

Lulet mbi varrin tand janë tha

Lulet janë tha mbi varrin tand.
Po, more po,
edhe tufat e djemve te janë pjekë.
Buqeta e nanës qenka djegë
e motrave po ashtu,
kunorat e vëllezërve, nipave e mbesave,
të shokëve dhe të miqve
ngjajnë me skelete ku varur rrinë
lulet e thame si zilka hajmalish.
Mbi dheun e kaftë që të mbuloi ty
kanë nisë me dalë fije të njoma bari,
ndërkohë që në kryet tem hala zhurmon
gjuha e lopatave mbushun me dhe t'lagun
që përplaset pamëshirshëm
mbi arkëmortin tand.
Ti nuk e di se ku gjendesh tash
n'tokë, a n'qiell,
veçse lulet mbi varrin tand,
babë, janë tha
ndërsa mua përherë e ma shpesh
lotët po ma nxanë fytin,
aq sa frymë s'po muj me marrë...

Gjithmonë do shkruaj për ty

Babë,
mbramë prapë s'u ktheve në shpi,
por unë t'pashë n'andërr.
Kishe marrë parmendën
e po lëvroje arën tande të vogël buzë lumit.
Qetë para,
parmenda pas,
pastaj ti tue çelë plorin
e nana pas teje kah e hedh farën.

Unë duke ikë prej andrre
dhe ara jote e vogël buzë lumit -
duke çelë bimë të reja ngjyrë pranvere.



Vdekja e poetit

Poeti u këput
e ra përdhe.
Miqtë
e çuan në spital.
Në kartelën e tij të vdekjes, doktori shkroi:
Në trupin e tij ka jetuar gjatë
pranvera dhe vjeshta,
në shpirtin e tij ka gjurmë
të thella të jetës dhe dashurisë.
Këto sëmundje i shëron vetëm vdekja.

Natën vonë...

Nata gojë ujku,
gotë e thyer,
bisht dhelpne,
rrugë pa krye.

Nata brinjë gjarpri,
llampë e djegur,
dhëmb miu,
këmbë kërmilli.

Nata prrua i thatë,
drrasë e kalbur,
besë e shkelur,
dashuri e tretur.

Qaj në gjuhë të huaj, qesh në gjuhën time

Një fëmij i vogël
ndoshta dy a tri vjeç,
qan pa pra në gjuhë të huaj.

E ama
nji grua e hollë si plep
i flet prajt me za të shkimun.

"Shuj
t'pastë nana
jem ka shkojmë te nana Drane."

Fmija
pra e
s'ndihet ma,
nis e qesh shqip
e flet në gjuhë të huaj me za t'naltë.

E ama përlotet
e kqyr rreth e rrotull
si nji sorkadhe e frigueme
se mos dikush ashtë duke e venerue.

Ndërkohë
që dritat e avionit
të linjës Londër-Tiranë
janë t'zbehta, thuajse të shkimuna.

Shumica e
udhëtarëve t'tjerë
as qeshin, as folin,
ata janë t'përgjumun,
t'përhumbun, t'ngujuem
në heshtjen e tyne t'etertë
mbi telefona dhe smartfona .

Ndërkohë
fmija i vogël që,
qan në gjuhë të huaj
dhe qesh në gjuhë amtare,
ka shpërthye në të qeshuna
avioni i linjës Londër-Tiranë
e ka prekë tokën e Nanës Drane.

3 Dhjetor 2023

I randë qyrku i Lirisë

Në këto pesëdhjetë e një vite jetë
hala s'kam mujtë me e mësue
a ashtë ma mirë me folë
a me heshtë,
ashtë ma mirë me u ngjitë nalt tuj u lëpi
a me ndejtë me trupin drejt
tuj e fshi djersën
nën sy,
ashtë ma mirë me çue krye për padrejtësi
a me i pranue ato kryeultë,
veç për me e pas t'nxetë
nji racion tagji,
ashtë ma mirë me i pa me sy t'ballit
njerëzit e tu kah vuejnë për bukë
e për dritë e ty kah
t'verbon drita,

ashtë ma mirë me kanë me mend në krye
a thjeshtë një copë mishi
me dy sy,
ashtë ma mirë me kanë me zemër e shpirt
apo një amebë njëqelizore
që merr veç frymë.
Në këtë pesëdhjetë e nji vjetor
hala s'e di çka ashtë ma e mirë në jetë,

veç vetes sime ia kam mbushë mendjen top
se gjaja ma e randsishme
për me t'ardhë era njeri
ashtë beteja me mbetë i lirë.
Jeta më ka mësue që Liria e ka çmimin e shtrenjtë,
por çka duket e kam vendosë qysh fëmijë,
që çdo çmim do ta paguaj vetëm e vetëm
që qyrku i LIRISË të më rrijë mirë.

Reforma...

Në Livadhin e Pleshtave
ka lulëzue hashashi.
Pusi i Strakave
ashtë betonizue e
Logu i Kuajve
ashtë ba truell për kishë,
Fusha e Mëllenjave
i ashtë dhanë me koncension nji investitori të huaj që s'u pa kurrë.
Lumin e Kaltër e kanë ngujue n'tuba të zi,
troftat pikaloshe janë ba bjonde,
Ndërsa Ariu i murmë i Ahishtës
krejt ashtë thi.

***

Mëngjeseve
dal e mbledh vesë
ndër lule
që të shuaj mallin që më djeg për ty.

Mesditave
kur dielli zhurit
hijeve fshihem,
që malli për ty të mos më përvëlojë.

Mbrëmjeve
shkoj pas xixëllonjave
në parkun e madh të qytetit
me shpresën e vakët që dritëza e tyre
do mund ta ndriçojë fytyrën tënde ngjyrë vjollcë.

***

Nëpër copa letrash,
në faqe të pashkruara librash të palexuar
në cepa mendimesh të zbrazët të harruar
jetoj me ty.

Të shoh në filma,
teatro, variete,
në qytet, në rrugë dhe rrugica,
të lexoj nëpër gazeta,
në lajmet e shkurtra të televizioneve informative,
në buletine lajmesh të gjata,
prapë më del vetëm ti.

Në hijen time të mëngjesit,
të drekës dhe të darkës
të shoh vetëm ty.

Ëndrrën e gjumit të parë
e shoh me ty
dhe gjumi më del me ty në sy.
Në ëndrrat e mëngjesit je prapë ti
aq sa nuk e di
je ti në mua
a unë në ty.

***

E dashura ime është si shenjat e pikësimit.
Kur bëjmë dashuri
është pikë(.)
Kur grindemi
i ngjet pikëçuditëses(!)
Kur bisedojmë qetë-qetë
më ngjan si presje(,)
Kur gjendemi larg njëri-tjetrit
më projektohet si pikëpyetje (?)
Në thonjëza shndërrohet kur mua
më mbyt harrimi ("")
Si një apostrof (') i tretur
kur na zë trishtimi
Kur më zotëron plotësisht
më fut në kllapa( )
Pikëpresje (;) është kur nxiton
Dy pika(:) kur me shpirt më dashuron
Tri pika(...) kur jeta rrjedh

LAZËR RROK LUMEZI

Shkodrës

Mbi ujë zbresin me lagë buzët ernat e maleve
N'anë tjetër të lumit barkaxhinjtë ftyrvranët
ndërrojnë drejtimin e lundrave
e bashkë me to edhe anën tuej të përkatësisë.
Ndërkaq fëmijët s'janë të vetëdijshëm,
as njerëzit e tjerë gjithashtu,
se kalimi i lumit kapriçioz
do t'a ndryshojë vërtet anën e tyne të përkatësisë.
Lumi në dukje i pafajshëm asht në gjendje t'i fshehë
udhëtarët e natës që i zuni gjumi
mbi rrjedhën e heshtun të lumit të thellë.
Barkaxhinjtë nuk thonë asgja derisa
me përulsi të ndjeni ngrohtësinë e zjarrit dhe të rakisë.
Ata kapërcyen bregun e lumit
duke lanë aty të moshuemit dhe të pamundunit për të ruejtë vorret
dhe zakonet e vendit të lashtë, historitë dhe muret e nalta,
një kopsht me përrue, plot lule dhe fruta të ambla.
Nëse të dëbojnë edhe prej andej
Ju do të merrni me vete vetëm kangën tuej të padukshme...

LAZËR RROK LUMEZI lindi në Shkodër me 2 shkurt 1945. Prindërit, Rrok Lumezi me Filjen, kanë ikur nga Kosova të frikësuar prej partizanëve serb. Lazri lindi në një trap, duke kaluar liqenin e Shkodrës. Menjëherë mbas ardhjes në Shqipëri, të atin e arrestojnë në Tiranë dhe e kthejnë sërish në Kosovë për të bërë 15 vite burg. Pjesa tjetër e familjes më 1948 shkon në Zagreb. Atje Lazri kryen studimet në Drejtësi dhe mw pas nisw të punojë në zanatin e të parëve, si argjendar. Më pas ai specializohet në fushën e krijimtarisë së artit të aplikuar dhe stolive artistike, duke krijuar një stil të mëvetsishëm.

Lazër Lumëzi ka botuar deri më tash dy libra dhe po përgatitë të botojë të tretin. Nga libri "Na dva neba", kemi përzgjedhë poezinë kushtuar Shkodrës.

ILDA MEIDANI JEHA

me butësi jasemini



***

E priti agun në ballkon.
Vetem dy orë pas asaj qetësie madhështore
do të nderej dita mbi panjat e venitura, tymnajën
dhe gënjeshtrat e domosdoshme.

***

Mban me vete kurajën dhe zhgërryhet në të tashmen.
Nuk ankohet.
Gjallërohet me pak.
Si zemrat e mëdha.
Fle me një gri ëngjëllore nëpër shpirt.
Si dikush që e ka për detyrë të vuajë.
Rrallë e më rrallë i del një lot.
Nga historia e dhimbjes.

***

I moleps ditët dhe njerëzit me harenë, hovin shthurës
e të ndërkryer të të premteve.
Flet me pasion të tejdukshëm,
gazep të bërë zap e ngazëllim mallëngjyes.
Duket sikur nxjerr ajër xhungle nga thellësia e gjoksit.
Pushton me erosin superior të fustanit jakëmbyllur.

***

Është,
di të jetë më e madhe se çdo gjë që i ka ndodhur.
Të dëgjon me mendjen gjetkë.
Të shpërfill, si imazhin e një aksidenti të largët.
E paplagosshme të prek dorën me butësi jasemini.

***

Injoranca entuziaste,
tamburët dekorativë,
deliri i sinqertë
i peshqve në akuarium,
kaushet e hideve bërë me veprën e Hermann Hesse,
foshnja lënë me kakë të ngrohtë deri në kurriz,
nga e ëma tik-tokse,
ose ndryshe momente të agonisë së kulluar në Vendin tim....

MIRCEA CARTARESCU

Solenoid

(Fragment nga romani)

Përktheu nga rumanishtja: Luan Topçiu

Kam zënë përsëri morra, as që më çudit ky fakt, as që më frikëson, as që më shkakton krupë. Vetëm se më kruhen. Thërrija kam pothuajse gjatë gjithë kohës, i shukund përherë kur krihem në banjë: vezëza me ngjyrë sedefi, që ndrijnë errët mbi fajancën e lavamanit. Mbeten mjaft syresh mes dhëmbëve të krëhërit, të cilat i pastroj më pas me një furçë të vjetër dhëmbësh, që bishti i ka zënë myk. Nuk ka si të mos zë morra – jam mësues në një shkollë periferie. Gjysma e fëmijëve kanë morra, i kontrollojnë në fillim të vitit shkollor, gjatë vizitës mjekësore, kur infermierja ua kontrollon flokët me lëvizjet e sakta si të shimpanzeve – vetëm se nuk i thërrmojnë me dhëmbë krustat prej kitine të insekteve të kapura. Në vend të kësaj, u rekomandojnë prindërve një tretësirë të bardhë-të hirnosur, që kundërmon erë kimikatesh, të njëjtin që përdorin në fund të fundit edhe mësuesit. E gjithë shkolla fillon të mbajë erë tretësirë për morra për ditë të tëra.

Nuk është edhe aq keq, të paktën nuk kemi tartabiqë, nuk i kemi parë prej kohësh. I mbaj mend edhe ata, i kam parë me sytë e mi kur isha rreth tre vjeç, në vilën e vogël në lagjen Floreasca, ku kemi banuar rreth viteve '59-'60. M'i tregonte babai, kur ngrinte papritur dyshekun e shtratit. Ishin si kokrra të kuqe të errëta, të forta dhe të shkëlqyeshme si frutat e pyllit, ose si ato kokrrat e zeza të bimës zvarranike që e dija se nuk duhet t'i fusja në gojë. Veçse se kokrrat midis dyshekut dhe skeletit të shtratit vraponin shpejt drejt qosheve të errëta, aq të alarmuara saqë filloja të qeshja. E prisja me padurim të ngrinte përsëri babai cepin e rëndë të dyshekut (kur ndërroheshin çarçafët), për të parë përsëri ato krijesat e vogla të majmura. Qeshja me të madhe, saqë mamaja, që ma mbante flokun të gjatë e me kaçurrela, më merrte gjithmonë në krahë, duke më pështyrë lehtë për të mos më marrë mësysh. Babai sillte më pas pompën me analcid dhe u bënte tartabiqëve, të strukur nëpër nyjet e drurit, nga një dush me erë të keqe, saqë nuk dinin nga të shkonin. Më pëlqente era që lëshonte druri i shtratit prej bredhi që ende ruante erën e rrëshirës, më pëlqente edhe era e analcidit. Pastaj babai lëshonte dyshekun dhe mamaja vinte me çarçafët në krahë. Kur shtronte çarçafin mbi shtrat, ai fryhej si një petull e madhe mbi të cilin kisha një kënaqësi të pazakontë të futesha në të. Prisja që çarçafi të binte lehtas mbi mua, duke u ngjitur pas trupin tim të vogël, por jo mbi çdo pjesë të tij, duke krijuar rrudha dhe pala të ndërlikuara. Dhomat atëherë ishin të mëdha si hangarë, dhe në to vërtiteshin dy njerëz të stërmëdhenj, të cilët, nuk e mora vesh përse, kujdeseshin për mua: mamaja dhe babai.

Por nuk më kujtohen pickimet e tartabiqëve. Nëna më thoshte se ishin si rrathë të vegjël të kuq mbi lëkurë, me një pikë të bardhë në mes. Dhe më shumë se kruheshin të digjnin. Nuk e di, por e vërteta është se gjithmonë i marr morrat nga fëmijët kur përkulem mbi fletoret e tyre. Është si një sëmundje profesionale. I mbaj flokët e gjatë që nga koha kur mund të bëhesha shkrimtar. Kaq gjë më ka mbetur nga karriera ime si mësues, flokët e gjatë. Dhe golfet, siç i mbante shkrimtari i parë që kisha parë ndonjeherë dhe që më ka mbetur si një imazh i lavdishëm dhe i paarritshëm, ai i autorit: të *Mic dejun la Tiffany*. [1]

Flokët e mi gjithmonë prekin ato të vajzave, të rregulluara dhe plot me fjongo. Në këto gërsheta të forta, gjysmëtransparente, ngjiten insektet. Kthetrat e tyre kanë lakimin e fijes së flokut, të cilin e kapin në mënyrë të përkryer. Ecin pastaj mbi lëkurën e kokës, lënë aty jashtëqitjet dhe vezët e tyre. Pickojnë lëkurën, që s'ka parë kurrë dritën e diellit, me ngjyrë të bardhë si pergamenë, dhe ky është ushqimi i tyre. Kur kruarjet bëhen tmerrësisht të padurueshme, hap ujin e nxehtë në vaskë dhe përgatitem t'i asgjësoj.

Më pëlqen si tingëllon uji në vaskë, ajo valë e furishme, rrjedha e rrëmbyeshme e miliarda bulëzave dhe fijet që mbështillen në spirale, vrumbullima e rrjedhës vertikale në xhelatinën e gjelbërt të ujit që ngrihet gati pa u ndjerë, duke pushtuar muret e vaskës përmes fryrjesh dhe ngjitje të befta, sikur të ishin milingona të panumurta të tejdukshme që vërshojnë në xhunglën amazoniane. Mbyll rubinetin dhe bëhet qetësi, milingonat shkrihen njëra me tjetrën dhe safiri i butë si një pelte bëhet i qetë, më sheh si një sy i kthjellët dhe më pret. Lakuriq, hyj në ujë plot dëshirë. E zhys menjëherë kokën, ndiej se si muret e ujit më mbulojnë simetrikisht faqet dhe ballin. Uji më mbërthen, është i rëndë rreth meje, më bën të lëvitoj në mes të tij. Jam bërthama e një fruti me mish të gjelbërt-blu. Flokët e mi shtrihen deri në skajet e vaskës, si të hapte një zog i zi flatrat. Fijet e flokëve largohen nga njëra-tjetra, secila është e pavarur, secila lundron, e lagur njëkohësisht, mes të tjerave, pa i prekur, si tentakulat e disa zëmbakëve të detit. Lëviz kokën papritur nga një anë në tjetrën për të ndjerë se si fijet tendosen, shtrihen nëpër ujin e dendur, marrin peshë, një peshë të papritur. Është e vështirë t'i shkëpusësh nga alveolet e ujit. Morrat qëndrojnë fort pas trungjeve të trasha, bëhen njësh me to. Fytyrat e tyre jo-njerëzore shprehin një lloj hutimi. Mbulesat e tyre janë prej të njëjtit material si fijet e flokëve. Zbuten dhe ato në ujin e nxehtë, por nuk treten. Tubat e vegjël të frymëmarrjes, të vendosur simetrikisht në skajet e barkut të tyre të rrudhur, janë mbyllur mirë, si vrimat e ngjitura të fokave. Lundrojnë të qetë në vaskë, të çlirët si një preparat anatomik, lëkura e gishtave të mi fryhet dhe rrudhet. Edhe unë jam i butë, si të isha i mbuluar me një shtresë kitine të tejdukshme. Duart e mia, të lëshuara në mënyrë të lirë, lundrojnë në sipërfaqe. Organet e mia intime tentojnë të ngrihen, si një tapë prej druri. Është kaq e çuditshme që kam një trup, që jam në një trup.

Ngrihem në bisht dhe filloj të sapunoj flokët dhe trupin. Ndërsa kisha veshët nën ujë, dëgjoja qartë biseda dhe zhurma nga apartamentet fqinje, por si në ëndërr. Tani kisha tapa xhelatine në veshë. I kaloj duart plot me sapun mbi trup. Trupi im nuk është erotik për mua. Sikur jo mbi trupin tim, por mbi mendjen time kalojnë gishtat. Mendja ime e veshur me mish, mishi im i veshur me kozmos.

Ashtu si me rastin e morrave, nuk është një befasoi e madhe kur gishtat e mbushur me sapun mbërrijnë tek kërthiza. Prej disa vitesh më ndodh kjo gjë. Fillimish u frikësova, sigurisht, sepse kisha dëgjuar se mund të ndodhë që kërthiza të çahet. Por kurrë nuk isha shqetësuar për timen, sepse kërthiza ime ishte thjesht një gropëz në barkun tim "ngjitur me shtyllën kurrizore", siç thoshte mamaja. Në fund të kësaj gropëze ishte diçka e pakëndshme në prekje, që kurrë nuk më kishte tërhequr vëmendjen. Kërthiza nuk ishte gjë tjetër përveç vendi i gërryer i mollës, nga del bishti. Edhe ne jemi rritur si fruta mbi një kërcell të përshkuar nga vena dhe arterie. Por para disa muajsh, ndërsa i kaloja gishtat me nxitim mbi këtë anomali të trupit tim, vetëm për të mos e lënë të papastër, ndjeva diçka të pazakontë, diçka që nuk duhej të ishte aty: një lloj mase të ngritur që më gërvishti majën e gishtit, diçka jo organike, që nuk bënte pjesë në trupin tim. Ishte ngulitur në nyjen e zbehtë të mishit që vështronte që andej, si një sy mes dy qepallave. Për herë të parë e vështrova më nga afër, nën ujë, duke hapur me gishta skajet e çarjes. Ngaqë nuk po shihja mirë, u ngrita nga vaska dhe lentja e ujit në kërthizë rrodhi ngadalë. Zot i madh, thashë me vete duke buzëqeshur, kam arritur të sodis kërthizën time... Po, ishte një lloj nyje e zbehtë, që kishte marrë më shumë reliev se zakonisht kohët e fundit, sepse në moshën gati tridhjetëvjeçare muskujt e barkut më ishin relaksuar më shumë.

Një gdhendje, si thoi i një fëmije, në njërën prej sperdredhjeve të nyjës, rezultoi të ishte thjesht një papastërti. Por nga ana tjetër, e fortë dhe e dhimbshme, dilte si një bluashkëzë e vockël me ngjyrë zi-jeshil që e kisha ndier me majën e gishtit. Nuk e kuptoja se çfarë mund të ishte. U përpoqa ta kap me thonj, por, kur tërhoqa, ndjeva një dhembje të lehtë që më frikësoi: mund të ishte një lloj lythi që nuk ishte e udhës ta ngacmoja. U përpoqa ta harroj dhe ta lija aty ku kishte mbirë. Gjatë jetës na dalin mjaft nishane, lytha, eshtra të vdekur dhe gjëra të tjera që i mbartim me durim me vete, për të mos përmendur thonjtë dhe flokët, dhëmbët që na bien: copa të vetes që nuk na përkasin më dhe që fitojnë një jetë të tyren. I kam ende sot, falë kujdesit të nënës, në një kuti të vogël, të gjithë dhëmbët e mi të qumështit, dhe po ashtu, falë saj, kam dhe bishtat e mi të flokëve që nga mosha trevjeçare. Fotot tona me smalt të plasaritur dhe me dhëmbëza si të pullave postare nëpër skaje janë gjithashtu dëshmi për këtë gjë: trupi ynë dikur me të vërtetë u ndodh mes diellit dhe lentes së aparatit fotografik, duke lënë hijen e tij mbi pelikulën, ashtu siç hëna, gjatë eklipsit, shtron hijen e saj mbi diskun diellor.

Por pas një jave, përsëri në vaskë, ndjeva sërish kërthizën time të çuditshme dhe të irrituar: copa e paidentifikuar ishte zgjatur pak dhe ndihej ndryshe, më shumë shqetësuese sesa e dhimbshme. Kur na dhemb dhëmbi, e prekem me gjuhë, edhe duke rrezikuar që në fund të ndiejmë një dhimbje më të mprehtë e më të gjallë. Çdo gjë që del jashtë normales në hartën e ndjeshme të trupit tonë na trazon dhe na shqetëson: duhet me çdo kusht të heqim atë ndjesi shqetësuese që nuk na lë rehat. Ndonjëherë, në mbrëmje, kur shtrihem për të fjetur dhe heq çorapet, ndiej se lëkura e trashë dhe e verdhë në anën e gishtit të madh është trashur tepër. E kap atë fryrje të fortë me gishtat e mi, e tërheq për gjysmë ore derisa arrij të shqyej një copë, dhe e tërheq më tej me mollëzat e gishtërinjve të dhimbshme, gjithnjë e më shumë i irrituar dhe i shqetësuar, derisa të shkëput një copë lëkure të trashë, të qelqtë, me vijëzime si të papilave digjitale, një centimetër të tërë lëkurë të vdekur, që tani varet shëmtuar nga gishti. Nuk mund ta tërheq më shumë, sepse tashmë kam arritur në pjesën e ndjeshme të lëkurës poshtë saj, tek unë që ndiej dhimbjen, por duhet gjithsesi të zgjidh atë kruarje, atë shqetësim. Marr gërshërët dhe e pres, pastaj e shikoj gjatë: një copë lëkurë të bardhë, që e kam prodhuar unë, pa e ditur se si, ashtu si nuk mbaj mend se si kam prodhuar kockat e mia. E përkul midis gishtave, e nuhas, vjen një erë të vagët amoniaku: një copëz organike, por e vdekur, e vdekur që kur ishte pjesë e imja dhe më shtonte disa gramë në peshë, më trazonte ende. Nuk më vjen ta hedh, fik dritën dhe shtrihem, duke e pasur ende midis gishtave, që të nesërmen ta harroj krejtësisht. Megjithatë, për disa kohë çaloj lehtë: më dhemb vendi ku e kam këputur.

Kështu që fillova ta tërhiqja lehtë atë si gurth të fortë që më dilte nga kërthiza, derisa, papritmas, mbeta me të në dorë. Ishte një cilindër i vogël, rreth gjysmë centimetri i gjatë dhe afërsisht sa trashësia e një fije shkrepëseje. Dukej i nxirosur nga koha, i mykur dhe i llangosur nga kalimi i kohës. Ishte diçka e lashtë, e mumifikuar, e sapunizuar, një dreq e di se çfarë. E vendosa nën rrymën e ujit të lavamanit dhe shtresa e yndyrës filloi të zhdukej, duke lënë të kuptohej se, ndoshta, dikur ajo gjë e vockël kishte pasur ngjyrë të verdhë-të tejpashme. E vendosa në fund të një kutie bosh shkrepësesh. Dukej si maja e djegur e një fijeje.

Pas disa javësh nxora sërish nga kërthiza ime e zbutur nga uji i nxehtë edhe një fragment tjetër, këtë herë dyfish më të gjatë, nga e njëjta substancë e fortë dhe e pëzgjatur. Tani kuptova se ishte një fund i lakuar i një spangoje, madje mund të vëreja morinë e fijeve të spërdredhura që e përbënin. Ishte spango, spango e zakonshme, si ajo që përdoret për të paketuar. Ajo që, njëzet e shtatë vjet më parë, ma kishin lidhur kërthizën në maternitetin e fëlliqur, punëtorësh, ku kisha lindur. Tani, kërthiza ime po e nxirrte jashtë, ngadalë, një copë çdo dy javë, një copë çdo muaj, pastaj një tjetër pas tre muajsh të tjerë. Kjo e sotmja është e pesta dhe e nxjerr me kujdes dhe kënaqësi. E drejtoj, e pastroj me thonj, e laj në ujin e vaskës. Është copa e fundit, më e gjata deri më tani dhe, shpresoj, të jetë e fundit. E vendos në kutinë e shkrepëseve, pranë të tjerave:

1 *Breakfast at Tiffany's*, Truman Capote

qëndrojnë të qeta, të verdha-të tejpashme-të zeza, të shtrembra, me skajet lehtësisht të shthurura. Kërp, i njëjti nga ai me të cilin nikoqiret bëjnë trastat, që të presin duart kur janë të mbushura plot me patate, i njëjti me të cilin lidhen paketat. Kur ishte dita e Shën Mërisë, merrnim një paketë nga të afërmit e babait nga Banati: ëmbëlsira me lulekuqe dhe me mjaltë. Spangoja e zgjidhur, ngjyrë kafe-e tejpashme, ishte gëzimi im: lidhja me të dorezat e dyerve, që nëna të mos bënte më një fëmijë tjetër. Në çdo dorezë bëja dhjetëra, qindra nyje.

Shpëtoj nga meraku i spangos së kërthizës dhe dal nga vaska, bashkë me ujin që rridhte prej meje. Marr shishen me tretësirën kundër morrave që ishte pas WC-së dhe hedh një dorë të vogël nga shishja e saj me aromë të rëndë mbi kokën time. Pyes veten nga cila klasë i kam marrë këtë herë, sikur të kishte ndonjë rëndësi. Kush e di, ndoshta ka. Ndoshta në rrugë të ndryshme të lagjes dhe në klasa të ndryshme të shkollës, morrat janë të një lloji tjetër, me madhësi të ndryshme.

Shpëlaj trupin nga ajo lëngesë e neveritshme dhe pastaj filloj të krihem mbi lavamanin prej porcelani që shkëlqen nga pastërtia. Dhe papritur parazitët fillojnë të bien, dy, pesë, tetë, pesëmbëdhjetë... Janë jashtëzakonisht të vegjël, secili i ngjyer me bulëzën e vet të ujit. Me shumë vështirësi arrij të dalloj trupat e tyre me barkun e zgjeruar dhe nga tre këmbë që ende lëvizin në secilën anë. Trupi i tyre dhe trupi im, teksa qëndroj lakuriq dhe i lagur, përkulur mbi lavaman, janë të ndërtuar nga të njëjtat inde organike. Kanë organe dhe funksione analoge. Kanë sy që shohin të njëjtin realitet, kanë këmbë që i çojnë nëpër të njëjtën botë të pafundme dhe të pakuptueshme. Duan të jetojnë, ashtu si dua edhe unë. I fshij nga muret e lavamanit me një rrymë uji. Zhyten në sifonin e poshtëm, përfundojnë në kanalet e nëndheshme.

Shkoj të fle me flokët ende të lagura pranë thesareve të mia të gjora: kutia e vogël e tic-tac-ut me dhëmbët e fëmijërisë, fotografitë kur isha i vogël dhe prindërit e mi që ishin në kulmin e moshës së tyre, kutia e shkrepëseve me spangon e dalë nga kërthiza ime, ditari. Si gjithmonë në mbrëmje, i derdh dhëmbët në pëllëmbë: gurë të lëmuar, ende shumë të bardhë, që dikur kanë qenë në gojën time, me të cilët dikur kam ngrënë, kam shqiptuar fjalë dhe kam kafshuar si një këlysh qeni. Sa herë më ka shkuar ndër mend si do të ishte të kisha diku edhe një qese letre me rruazat e mia të shtyllës kurrizore të moshës dyvjeçare ose me falangjet e gishtave të mi nga mosha shtatë vjeç...

I vendos dhëmbët në vend. Do të më pëlqente të shihja edhe disa fotografi, por nuk kam më fuqi. E tërheq sirtarin e komodinës dhe i vendos të gjitha aty, në kutinë time të vjetër prej "lëkure gjarpri" të zverdhur, që dikur kishte strehuar një makinë rroje, një furçë rroje dhe një kuti me brisqe Astor. Tani i mbaj këtu thesaret e mia të gjora. Tërheq batanijen dhe mbuloj kokën dhe përpiqem të fle sa më shpejt, ndoshta përfundimisht. Lëkura e kokës nuk më kruhet më. Për më tepër, meqë më ka ndodhur kohët e fundit, shpresoj që të mos ndodhë më as sonte.

---

* Mircea Cărtărescu (lindur më 1 qershor 1956, Bukuresht, Rumani) është një poet, prozator, eseist, kritik letrar dhe gazetar rumun. Ai është një nga shkrimtarët më të çmuar dhe më të përkthyer të periudhës post-komuniste, duke botuar mbi 30 vëllime, të përkthyera në 25 gjuhë. Ai është një nga emrat e nominuar për Çmimin Nobel për Letërsi. Fitues i shumë çmimeve prestigjioze letrare në gjithë botën. Është profesor në Universitetin e Bukureshtit.

** Fjala "solenoid është termi standard teknik që përdoret për të përshkruar një komponent elektrik, zakonisht një spiralë me një bërthame metalike, që krijon një fushë magnetike kur kalon një rrymë elektrike. Në kontekste të caktuara, mund të shfaqet edhe si "sistem solenoidal" ose "bobinë solenoide", në varësi të përdorimit.

JOYCE CAROL OATES

Melankoli amerikane

poezi

Përktheu: Qerim Raqi

Homazh për Virginia Woolf

Hyra në lumë dhe lumi u ngrit pangopshëm.
Duhet të ketë pritur prej vitesh. Nuk mund të ketë ndjerë frikë.

Momenti më i mirë i jetës sime?- faqja e fundit, pika,
lehtësia për të shmangur çmendurinë.
Ngushëllimi për të mos filluar kurrë *nga e para.*

Dola në lumë dhe këmbanat ranë me një furi dehëse.
Duhet të ketë qenë një dasmë, sepse të panjohurit prekin buzët e lagura
me të miat.
Peshqit gjigant më kafshonin gishtat e këmbëve si dashnorë.

Një grua e padukshme që fundoset, dridhet, shkon poshtë rrjedhës,
më e rëndë se sa mund të mendohet.
Dhe shumë më kokëfortë.

Një pendë shihet larg - shikoni se si vërtitet, si ktheher drejt tokës!

Ky është momenti më i mirë i jetës sime, ky fund.

Valë pas valësh, pa fund, por pa mendime, pa tru për të menduar, pa puls ethesh, pa zë.

(Mua më pëlqen të dal nga dhoma duke folur,
thashë një herë me gëzim,
një fjali e papërfunduar kalimtare në buzë.)

Hyra në lumë dhe lumi u ngrit lakmueshëm
Pas meje lashë jetën e zhurmshme! –
terrorin kumbues të vdekjes!
Errësirën e thelluar mbi varrin e Rogerit!
Dhe a nuk është kjo luftë dënimi e qytetërimit tonë?
Unë mendoj se është. Mendoj se duhet të jetë. Nuk më intereson
mbijetesa.

Por në ditarin tim, që do ta shihni të gjithë, kam shkruar *Troftë dhe*
brumë sallam:
Njeriu ka një përfytyrim të caktuar të brumit dhe sallamit
duke i shkruar ato.

Ka një përfytyrim të caktuar për jetën e tij duke flakur atë tutje me guxim.

Imazhi i errësirës

Ka njerëz që ulen pranë dritareve dhe ëndërrojnë.
Në rrugën time ëndërrojnë shumë njerëz nga dritaret që kornizojnë një rrugë të drejtë, krejtësisht të zakonshme me makina të parkuara.
Horizonti përbëhet nga muret dhe makinat dhe është shumë afër:
sytë e këtyre njerëzve, të habitur, lëvizin të shqetësuar rreth kornizave, rreth dritareve të tyre, duke pritur
që druri të shkërmoqet dhe
dielli t'i nxjerrë jashtë.
në akte të dhunshme.

Kur bora bie në shtëpinë e tyre, vështrimi i tyre mprehet
nga uria themelore e dimrit.
Ata presin.
Pranvera jonë e vrullshme e rreme
bën që tulipanët dhe sythat të kalben dhe
të torturojnë sytë e tyre
në maje gjilpërash.
Era ua sfilit shikimin.

Kur nata më në fund bie
asgjë më keq nuk ndodh vetëmse errësira shtrihet
nga errësira themelore
e botës.

Gruaja është vdekja e shpirtit"

Zemërime të thella përqafimesh
Erë dhe diell në një paroksizëm të pafund
të të vdekurve të ligë

një lule e bardhë në një degë
një shpirt që fle në një pemë
gratë imagjinojnë muzikën, duke fjetur
ëndërruar një degë në dritën më të qartë

femërore është vdekja, çarje që hapen
të holla si fije, dështim i butë i foljeve,
saktësia e shndritshme mashkullore e syrit
ka dëshmuar përgjithmonë

burrat me pasionet e tyre hyjnë në mua dhe harrojnë
format e tyre të sakta

shpirtrat e tyre të zemëruar, të çliruar
nuk kanë asnjë kuptim tjetër, ose kanë kuptimin
e erës, diellir dhe ajrit
me ngutinë e tyre mashkullore, përjetësisht
në lëvizje nëpër tokë —

Në pritje

Numër i madh pulëbardhash, s' numërohen dot.
Valë aritmike - gjigante, sipërfaqësore - tingujt thithës që s'mund të parashikohen kurrë.
Ai pret në plazh me duar të shtrënguara mbi gjunjë.
Nuk është fëmijë, është shumë hijerëndë.

Një patë kanadeze fluturon, zhurmëshëm
me krahët e ngathët.
Shtatë rosakë kalërojnë mbi valë
varka të panumërta, të gjitha të heshtura.
Është përsosshmëri kjo?
Ai pret që vala tjetër të ndryshoj gjithçka.

Nëse ti duhet të vdesësh dhe unë mbetem gjallë

në pritje jemi të gjithë të barabartë
në mendime identikë
në artin e pritjes

"pas pak"
dhe pastaj mbretëron pritja
e ngrirë
gumëzhitëse nën dritat e neonit
derisa ti lufton për të mos u fundosur
e unë luftoj panikun e pritjes
nën sipërfaqen
e çmitizuar
serioze
të një duzine pllakash

kapelet e ndezura të infermiereve
një univers perfeksionesh të vogla
asnjë ritual nuk funksionon këtu, vetëm mekanika
këtu ku kthimi nga të vdekurit
bëhet me orar, ose me vonesë
"për pak kohë"

i ftohti në sallës së operacionit është reduktuar
në zeron absolute,
edhe paniku pret
përqendrimi total i trupave tanë.
asnjë ritual, vetëm shprehi
për të pritur
për të mbijetuar.

Epoka e akullit

Shpirti lëviz kah të dojë vetë:
ajri është pallë, është britmë.

Tërë natën mishi i gjallë i pemës është rjepur dhe në mëngjes syri nuk mund të masë asnjë distancë,
veshi është shurdhuar bardhësie.

Një botë e qeltë! – vezullim shumëkrahësh akulli.
Nëse pulsi rrah bredhin duhet të mësojë kujdesin
sepse këtu prekja më e vogël të vret.

Drita nga lindja është e mprehtë si brisku.
Ne ecim në rrathë të verbër, të pafuqishëm.
Pema - bari - guri - lumi - fryma jonë e freskët:

marramendja e akullit na sulmon, hipnoza e lashtë
e gjumit.

Në epokën e akullit, bukuria rrëshqet si një maskë lëkure.
Nuk mund të marrësh frymë, ngrihesh në përsosshmëri.

(Me rastin e Ditës Botërore të Përkthimit)

YASMINA MELAOUAH

Pantoflat e superheronjve ose përse jam përkthyese

Përktheu Mariana Ymeri

Është e vështirë, kur reflekton për përkthimin si përkthyes dhe jo si teoricien, t›i rezistosh tundimit të metaforave. U drejtohemi imazheve me shpresën e zgjidhjes së kësaj enigme të lashtë. Prej gati njëzet vjetësh në këtë mjeshtëri, kam lexuar dhe dëgjuar për lundrimtarë fjalësh, mediumë, akrobatë, ndërmjetës, kam dëgjuar ta krahasojnë përkthimin me ekzekutimin e një partiture muzikore dhe interpretimin e një ëndrre, me pritjen e një udhëtari që vjen nga larg dhe aktin e të bërit dashuri...

Kapemi pas këtyre metaforave, sepse ndihemi të trullosur. Vetëm para një ekrani kompjuteri, një libër në të majtë, një shishe me ujë në të djathtë, mundësisht përballë një dritareje nga mund të shohësh qiellin herë pas here dhe të qetësosh sytë në retë lart, nisesh, në të vërtetë, për një aventurë gjigante, ku futet në lojë shumë më tepër sesa honorari yt, sesa kënaqësia e një pune të kryer mirë dhe madje edhe pesha hipotetike që kjo punë mund të ketë në suksesin e një romani, të një libri.

Kompjuteri, shishja e ujit dhe dritarja janë bagazhi i lehtë i një udhëtimi të vështirë plot mall, janë valixhja prej kartoni e një refugjati të Babelit. Në këmbë, në një shtegtim të ngadaltë, plot të panjohura, gracka, rreziqe, por edhe vrulle gëzimi e dhurata të papritura rrugës, duke përkthyer ne ndjekim ëndrrën e kthimit në shtëpi.

Futemi në kokën e mijëra personazheve, sepse na jep frymë një lloj nostalgjie, një ëndërr e marrë dhe këmbëngulëse me të cilën, me maska të rreme dhe të pafundme, ndoshta njeriu ndeshet gjithmonë. Nostalgji për unitetin, nostalgji për Babelin para shkatërrimit. Të gjitha metaforat e përkthimit, të gjitha maskat e përkthyesit janë figura të bashkimit, të urës, të unitetit ose, të paktën, të afshit, dëshirës së zjarrtë, të aspiratës drejt bashkimit. Vetë imazhet e përkthimit evokojnë shpesh kufirin, por është i vetmi rast, besoj, ku fjala kufi tregon vendin e një takimi, jo të një ndarjeje.

Me shishen time të ujit dhe retë e mia, në lodhjen fizike të pamat të shumë orëve pune në ditë, ndoshta - kush e njeh këtë punë – bëj bashkë disa pjesë të jetës sime dhe përplasja e mrekullueshme e pjesëzave që bashkohen, krijon gëzimin e fjalës së duhur që gjen përpikmërisht hapësirën që e priste në faqe. Dhe, në fund të gjithë kësaj, lumturia e lexuesit shumëfishon timen dhe sanksionon një fitore të vogël, kalimtare mbi kaosin, çrregullimin, shkapërderdhjen pas Babelit.

Në shtëpi më thonë se përkthimi nuk është punë, por një hobi për mua. Diçka, me sa duket, shpërfaqet nga hareja me të cilën zhdukem me shishen time të ujit, përballë ndonjë reje, kudo ku gjendem, për t'iu kthyer faqeve të shkruara.

Dhe ndoshta çka duket para syve të tyre, është gëzimi i natyrshëm në çdo kërkim, dëshira e çdo udhëtimi dhe zbulimi. Disa ditë, ndërsa luftoj për të rënë në gjurmët e fjalës së duhur, ndërsa humbas orë - por a janë vërtet të humbura? - duke ndjekur ritmin që më troket në kokë, në kërkim të një fjale me të cilën ta përshtat - ndiej se gëzimi im i ethshëm duhet të jetë shumë i ngjashëm me atë të hetuesit ose të kujtdo që lufton për të zgjidhur një enigmë. Si ata, në fakt, unë e di mirë se kënaqësia më e madhe është mundi i udhëtimit, tensioni i kërkimit dhe se në këtë, të gjithë ne, përkthyesit, ndihemi si flamurtarë të vegjël që sfidojmë pështjellimin, rrëmujën, kaosin e botës pas Babelit. Ne kërkojmë Graalin tonë, në të vetmen formë të mundshme që mund të marrë faqja, në një ritëm të përsosur që i përshtatet ritmit të autorit ashtu si këmba e vogël e Hirushes i përshtatet këpucës prej kristali. Kërkojmë

Hirushen tonë, nga njëri skaj i mbretërisë në tjetrin, mes rrënojave të Babelit.

Vetëm ne e dimë se sa peshë mbart ky hulumtim, sa i rëndësishëm është, ne që në sytë e të gjithëve veshim rrobat e krijesave në hije, të padukshme. Thellë-thellë, në realitet, ndihemi si ata superheronjtë e fshehur pas identitetit të fëmijëve të ngathët dhe të turpshëm.

Por ne kthehemi sërish e sërish në padukshmërinë tonë, në heshtje. Gjërat e mëdha e të vështira bëhen vetëm, ne heshtje, me ngadalësi.

Dhe ja ku erdhëm te ngadalësia. Një nga gëzimet më të mëdha, një nga dhuratat e mëdha të kësaj pune: të mësosh të jesh i ngadalshëm. Pothuajse një paradoks, duke ditur se sa të shkurtra janë afatet në shumicën e rasteve, duke ditur se si sot shpejtësia është kthyer në një dogmë. Një paradoks dhe një privilegj, pra, të edukosh veten me ngadalësinë, t'i japësh vetes kohë për të konsultuar shumë fjalorë, të endesh nëpër shtëpi duke evokuar me lëvizjen fizike sugjestionimin e saktë muzikor që nuk të vjen kurrsesi, i gozhduar në tavolinë.

Humbje e kohës - apo fitim i saj? - të ndjekësh gjurmë, të presësh të lulëzojnë ritmet, t'i bësh sytë katër, gjoja me mospërfillje, për fjalën, të vetmen, të duhurën. Edhe për këtë shërbejnë retë përtej dritares sime.

Ngadalësia të mëson të vëzhgosh botën, të dëgjosh zërat, të kapësh peshqeshe të papritura në detaje, në qoshet e mbuluara nga hija, në peizazhe të strukura ku asnjë udhërrëfyes nuk të merr për dore. Ngadalësia të mëson të mirëpresësh. Dhe është një nga dhuratat më të mëdha të këtij profesioni fantastik bukëshkalë.

Në ngadalësinë e përkthimit, mësova ta këqyrja botën.

Mësova të sodisja vitrinën e një dyqani hekurishtesh, të magjepsesha nga përsosmëria e një manikote, pasi përktheva *Bleu de chauffe* të Aurousseau-t.

Mësova bukurinë e kanaleve kulluese të trotuareve të Parisit, me rrotullat e tyre prej pëlhure për të devijuar ujin, pasi u rrëzova mbi to shumë herë.

Mësova ta njihja Parisin pëllëmbë për pëllëmbë dhe lagjen Belleville sikur të kisha jetuar aty prej një jete, duke përkthyer sagën Malaussène të Pennac-ut.

Mësova shijen e karameleve që nuk shiten më dhe zbulova ngjyrat dhe format e pabesueshme të disave që ende shiten, duke përkthyer të tjerë autorë. Falë tyre, nuk mërzitesha më duke qëndruar në radhë në supermarket dhe magjepsesha duke admiruar vitrinat e ëmbëlsirave, shijen e të cilave, madje, u përpoqa ta provoja.

Mësova vërtet të këqyrja botën duke përkthyer. Ndoshta, në fakt, nuk jam më e aftë të sintetizoj. Nga dëshira për të ecur ngadalë, për t'u ndalur në çdo fytyrë, çdo shkrim, në çdo leh peme, në çdo fjalë që dëgjoj, humba aftësinë për të pasur një vizion të përgjithshëm. Vdes të shikoj dritaret e shtëpive një nga një, të shikoj brenda, dhe kështu, ndoshta, perspektiva e rrugës më del nga vështrimi.

Në këmbim mësova të "mendoj në këmbë" dhe "të mendoj ngadalë", siç thotë një tekst i Cassano-s. Në këtë ngadalësi më duket sikur gjithçka mund të gjejë një vend brenda meje, sikur zemra ime është zgjeruar për të mirëpritur gjithçka, për t'i mirëpritur të gjithë, sikur për shkak të deformimit profesional gjithmonë u bëj jehonë shumë zërave, të gjithë zërave, si një pasqyrë e pangopur për çdo detaj të botës.

Me ngadalësinë mësova përulësinë.

Përulësinë për të bërë gabime, për të njohur gabimet, për të dyshuar vazhdimisht në atë që di. Nëse të përkthesh, para së gjithash do të thotë të matesh me një gjuhë tjetër, të përkthesh letërsi do të thotë të matesh me një gjuhë brenda gjuhës. Secili autor e rishpik botën me fjalë dhe fjalët e tij janë cepa të papërsëritshëm, alkimia verbale që nga "plumbi" i gjuhës së tribusë, nxjerr floririn e një gjuhe poetike. Përulësia e përkthyesit është hapja ndaj një horizonti kulturor, shumë aspekte të të cilit janë të huaja, është "mirëpritja e të huajit në shtëpinë tonë", duke i lejuar të sjellë me vete gjithë huajtësinë, distancën e tij të domosdoshme, duke u rrekur të përshkojë këtë së bashku me lexuesin, së bashku me komunitetin tonë kulturor.

Kjo përulësi e dashur është mburoja e vërtetë kundër grackave të tmerrshme të banalizimit dhe normalizimit. Kjo përulësi e ëmbël është përkushtim ndaj diçkaje "të bukur dhe të vështirë", që nuk do t›i nënshtrohet kurrë, asnjëherë, gjuhës së fisit, të stereotipizuar egërsisht e të standardizuar, që synon të imitojë në mënyrë qesharake "të lartën".

Përkthyesi është i përulur dhe vigjilent, kërkues ndaj vetes dhe lexuesit, të cilit i kërkon të përballojë përpjekjen e një udhëtimi të paorganizuar «no alpitour».

Te përulësia, përkthyesi arrin me kalimin e kohës. Përkthyesi fillestar - dhe shoh të tillë teksa u mësojnë njëzetvjeçarëve të përkthejnë - në mënyrë paradoksale, nuk njeh as ngadalësinë dhe as përulësinë.

Një lloj padurimi, një entuziazëm i pamatur, një formë e çuditshme plotfuqishmërie e bën të nxitojë e rendë nëpër tekst, duke kërkuar në mënyrë të pandërgjegjshme rrugë të shkurtra, ndonjëherë, pa e kuptuar, që po shkatërron ritmin e një faqeje të tërë - për të mos thënë të një romani të tërë - vetëm pse ka keqkuptuar kohën e një foljeje.

Studentët e mi, shpesh entuziastë dhe të padurueshëm, shpesh shumë të zgjuar, janë të vendosur që të mos rrinë e merren me atë që nuk dinë, atë që nuk e njohin, që nuk hyn në horizontin e tyre gjuhësor dhe kulturor. Ja pse, përballë distancës, veçantisë së paepshme të një faqeje romani, ata përdorin të gjitha strategjitë e mundshme për të rrëgjuar atë distancë që u merr mendtë dhe i fut në panik. Sa herë - dhe ndonjëherë më ndodh edhe mua - marramendja përballë humnerës së një ndërtimi të pazakontë, të një fjale të vjetruar mënjanohet aty për aty falë arsyetimit qetësues të "gabimit të shtypit". "Duhet të jetë një gabim shtypi, prof", më thonë. Është thjesht një version më naiv, më i pafajshëm, më pak arrogant i murtajës endemike të normalizimit, në emër të dogmës së lexueshmërisë, të rrjedhjes së tekstit, të lehtësisë.

Përulësia shprehet kur përkthyesi nuk gjen më justifikime, nuk gjen alibi për të mbrojtur siguritë e tij modeste dhe shkon lakuriq në faqe, me durim, i gatshëm t'i vërë veshin.

Ndoshta kjo gjendje është privilegj i rritjes. Rrudhat janë të dobishme për diçka - i themi kolegëve shpesh në telefonatat tona - dikush lufton me gjermanët e vet, unë me francezët e mi. Megjithatë, ka qenë e lehtë për mua të isha e përulur, e lumtur të isha sy e veshë, sepse pothuajse gjithmonë kam pasur mundësinë të zgjidhja "të ftuarit" në gjuhën time. Jam një përkthyese me fat, edhe sepse kam punuar me autorë shumë të dashur, në shumicën e herëve të zgjedhur personalisht, në disa raste edhe miq, falë përkthimit.

Janë një numër i vogël romanesh të përkthyera prej meje, që nuk më kanë ngjallur pasion. (Dhe në këto pak raste, duhet thënë, përkthimi është torturë.) Ndërsa në shumicën e rasteve

takimi i përditshëm me faqen ka qenë gjithmonë një takim i pritur me gëzim, ethshëm, një premtim kënaqësie dhe pasioni. Aq më tepër kur sfida ishte e mundimshme, faqja plot pengesa, përkthimi një mision në dukje i pamundur. Kur i bie

botës kryq e tërthor, me përulësi dhe pasion, asnjë përkthim nuk është i pamundur.

Kurrë nuk kam qenë në gjendje të zhvilloj një "strategji përkthimi" të vërtetë, efektive dhe mund ta përshkruaj atë vetëm dhe gjithmonë "après coup", pasi ndodh, duke u kthyer prapa dhe duke parë rrugën që kam bërë. Fillova të arsyetoja për zhargonet, për italishten neostandarde, për potencialin e jashtëzakonshëm të varieteteve rajonale të italishtes, vetëm PASI i kisha prekur dhe përdorur "pa mendje" e me të dyja duart për të përkthyer Pennac-un, Jaenada-n, Smail-in, Aurousseau.

Pra, e zhveshur, e takoj faqen, të mbrojtur nga heshtja dhe vetmia, përgjegjëse e vetme për rrugën time, në një tete-à-tete të përditshme me autorin.

Shpesh flasim për këtë vetmi mes përkthyesve. Ndonjëherë është një barrë e tillë që disa prej nesh nuk e përballojnë dot, ndryshojnë punë, zgjedhin diçka tjetër vetëm për të lënë shtëpinë, për t'u veshur e ngjeshur, që të shkojnë në punë. Shpesh, duke e shoqëruar time bijë në shkollë, para se të kthehesha për t'u mbyllur në papafingo për të përkthyer, i shikoja për një hop me zili gratë me taka, që nxitonin për në metro, niseshin për diku, në ndonjë zyrë ku do të hynin duke hequr e hedhur tutje pallton dhe duke thënë "mirëmëngjesi, sa ftohtë sot".

Por kjo vetmi, aq e nevojshme, tekefundit, është një vetmi e mrekullueshme e mbushur me njerëz: ne që punojmë në këtë zanat, e dimë. Mbushur me lexues për të cilët përpiqemi të japim më të mirën - për ta, për lexuesit, jo për botuesit, e them me gjithë respektin për ta, i harxhojmë energjitë tona - por mbi të gjitha të stërmbushur nga prania e një komuniteti të fortë dhe të bashkuar, të njerëzve që në të katër anët e tokës, besoj, pa ekzagjerim e njohin veten si të ngjashëm dhe krahasohen, enden si klerikë endacakë nga njëri skaj te tjetri i Italisë dhe i Europës.

Letërsia më ka ofruar gjithashtu një strehë, më ka hapur dyer shtëpish më pak të pasigurta se ato nga lëvizja shumë shpesh, më ka bërë të përjetoj dashuri më pak kalimtare se ato që kam përjetuar, por ka vulosur edhe miqësi më pasionante se çdo dashuri.

Kur erdha te përkthimi, mendova se ishte thjesht një "porte étroite" nga ku mund të hyja edhe më nga afër në botën përrallore virtuale të letërsisë.

Përkundrazi, ky kontakt i përditshëm me faqen e shkruar, me fjalën e shkruar, kjo lojë akrobatike e rolit dhe këndvështrimit të një rrëfimtari, ky ushtrim i vazhdueshëm i vendosjes së këmbëve të mia në gjurmët e tij pa ia gërvishtur fizionominë delikate, në fund, më ka mësuar edhe magjinë e vështirë të botës. Më mësoi të shikoja, të dalloja bukurinë ngashënjyese të çdo thërrimeje të realitetit, më hapi dritare të papritura në realitetin më modest që kemi para syve tanë: qytetet, dritaret, oborret, listat e blerjeve të braktisura në fund të një karroce supermarketi, njerëz të përgjumur në metronë e fundit të natës.

Për këtë arsye, sot mund të shpreh vetëm mirënjohjen time për të gjithë ata që më shoqëruan hap pas hapi, që nga romani i parë francez që lexova një verë shumë të nxehtë tridhjetë e tre vjet më parë, ndërsa isha mërzitur në Tunizi, deri këtu, madje duke marrë një çmim për të bërë atë që më pëlqen më shumë në jetën time.

Yasmina Melaouah, e diplomuar në letërsi franceze moderne, ka përkthyer vepra dhe autorë të rëndësishëm, si Daniel Pennac, Patrick Chamoiseau, Fred Vargas, Colette, Jean Genet, Andreï Makine, Laurent Mauvignier, Mathias Énard, Albert Camus, Martin Winkler dhe Antoine de Saint-Exupéry. Së fundi, ka ripërkthyer disa tituj të Albert Camus. Është nderuar me shumë çmime përkthimtarie në Itali, ku jeton.

ALFRED DUKA

Xhandari i urës

Aty nga fillimi i viteve tridhjetë të shekullit kaluar, u ndërtua rruga që lidhte Burrelin me Dibrën. Ajo kalonte, aty ku dredhon edhe sot, në të djathtë të rrjedhës së lumit Mat, duke ndjekur deltinat fushore, krijuar prej zhveshjes së maleve e më pas duke ngjitur një ërmale me leqe pafund, derisa mbërrin në Qafë të Buallit, ku erërat e përjetshme u fryjnë bulqitë papushim brirëve të tij.

Anipse në udhën e re filloi lëvizja, fshatarët e rrjedhës së majtë të Matit, mbeten përsëri të izoluar, pasi nuk kishte asnjë urë për t'i bashkuar me udhën e madhe. Fati ju erdhi në derë, por me lumin ndërmjet, nuk e kishte këtë emër. Puna shkoi deri aty, sa fshatarët zunë të flasin poshtë e përpjetë keq për Mbretin. Si nuk e mendoi Naltmadhnia, se kështu ne mbetëm që mbetëm siç kemi qenë. Kësisoj, kërkonte një zgjidhje kjo punë dhe ajo nuk vonoi; një përfaqësi e atyre katundeve u mblodhën dhe i drejtuan nje letër Mbretit, me anë të së cilës i kërkojnë ndërtimin e një ure që t'i bashkonte me rrugën kryesore. Sigurisht që Mbreti e gjeti të arsyeshme kërkesën e tyre dhe pas disa muajve, nisi dhe u ndërtua një pasarelë, në afërsi të fshatit Shulbatër, me gjërësi të mjaftueshme, për të qarkulluar njerëzit, bagëtitë dhe kafshët e ngarkesës.

Pas një viti, Mbretit i vjen një letër tjetër, e nënshkruar nga të njëjtët persona, që kishin kërkuar ndërtimin e urës, tashmë me kërkesën për ta shembur atë. Letra mbante titullin: "Kërkesë per shembjen e ures"!!! Ata shpjegonin se arsyeja se përse kërkonin shembjen, ishte se grupe hajdutësh të zonave të rrjedhës matanë lumit, u vidhnin bagëtinë natën duke i transportuar ato nëpërmjet saj. Ura, thoshin ata, ishte bërë shkak për t'ua lehtësuar punën hajdutëve, më shumë se për të na ndihmuar ne! Ata shtuan se një natë, tani vonë, një fshatari të tyre, i kishin vjedhur me ç'kishte pas mbas shpirti, as pulat nuk i kishin harruar.

Mbreti si mbeti ca kohë me atë Letër të çuditshme në dorë, sakaq urdhëroi që të vendosej një xhandar për ruajtjen e urës.

Fshatarët, për ta nxitur që ta kryente shërbimin sa më mirë, xhandarit i thanë se të ka caktuar në këtë detyrë vetë Mbreti. Ndaj Hasani (kështu quhej xhandari) e ruante pasarelën me përkushtim dhe e vërteta është se vjedhja e bagëtive u ndërpre. Kësisoj shpëtuan ata edhe ura!

Pas disa viteve në roje të saj, hajdutët nuk guxuan më të preknin gjënë e banorëve matanë lumit, por vendi u pushtua nga Italia fashiste dhe Mbreti iku, por Hasani qëndroi duke vijuar punën dhe vazhduar të mbajë si atëherë uniformën e xhandarit bashkë me armatimin.

- Lene këtë punë, o Hasan aga, se Mbreti ka ik dhe tash ka hy Italia, e asaj nuk po i bëhet vonë për gjënë e gjallë të katundit tonë, i thoshin njerëz të ndryshëm që kalonin atypari, por edhe të afërm dhe familjarë të tij.

- Tani nuk ka se kush të paguan, kështu që nuk ka kuptim ma kjo që ti bën, i thoshin të tjerë.

- Mue n'këtë punë me ka shti Mreti. E din Ai kur me e lanë punën unë!

- Mor po Mbreti ka ik, mor burrë, kush të paguan ty?

- E di Ai se kush më paguan. Vetëm kur të më thotë Naltmadhnia, e la punën unë.

Hasan aga e kishte mendjen top për këtë gjë.

- More, a nuk po dimë na me t'u shpjegue, a nuk po din ti me na kuptue? - këmbëngulnin shoqnia edhe familjarët e tij në të tyren.

- Ua thashë! Atë punë e din Mreti dhe pikë! - ua kthente Hasani nopranisht. As që tundej fare.

- Po, kush të paguan ty se?

- E di Ai, pra, - ua priste shkurt Hasan aga, ku sipas kaploqes së vet, ju jepte njëfarë të kuptuemi fshatarëve, për një lidhje disi misterioze, apo njëfarë komunikimi që e dinte ai se si e mbante me vetë Mbretin, duke e shoqëruar me një lëvizje të dorës, si tu thoshte se kaloni, kaloni ju, se nuk i dini mirë këto punët e thella të hyqymetit...

Hasani e ndjente veten pjesë të Mbretit, një si gjymtyrë e Atij, që lëvizte në mënyrë të vetëvetishme. Hidhte sytë nga Burgajeti dhe i vinte se po fliste me Të. Aq fort e besonte këtë gjë, sa që sytë i merrnin një si përshkenditje dhe për disa kohë futej në një si transhendencë, mbështetur parmakëve të saj, në mes të urës, ndihmuar edhe prej lumit që kalonte rrëmbyeshëm poshtë këmbeve të tij, sidomos në netë me hënë, kur lumi përcillte me shkulma mijëra pasqyrime të gjithëfarëllojshme, tëposhtë rrjdhës së vet, duke shtyrë njëra - tjetrën papushim, si një maratonë e stërmadhe pishtarësh, në shpinë të Matit. Ndodhte në netë të tjera, varësisht prej hënës, që lumi i krijonte një gjendje gati lunatike, përtej asaj që ia kishte njohur vetes deri më atëherë; i dukej si një peshqir i stërmadh pasqyre të thyer, copat e të cilit valëzonin të lidhura me njëra tjetrën rrjedhës teposhtë, si lumë drite, duke ia mbushur shpirtin me ato lloj vizionesh që kurrë nuk i kishte përjetuar më parë.

Hasan aga jetonte me urën, brenda qenies së saj, si në një dashuri kurrë më parë njohur, as dëgjuar prej tij. Ndërkohë ai e dinte se Lumi kishte qenë aty për shumë vite e vite, por asnjëherë nuk e kishte parë në atë mënyrë. Dhe s'kishte faj! Sepse deri sa pa u bërë ura, ai dhe askush nuk e kishte shaluar Matin në vrapin e përjetshëm të tij, teposhtë rrjedhës së vet. Pra u bë sebep Naltmadhnia dhe ura që Hasani t'i përjetonte ato ndjesi. Ajo punë i ishte bërë aq e tija, saqë nuk dëgjonte askënd, as njerëzit e familjes së tij. As pas një viti që nuk e paguante askush. Ai, ura dhe Mbreti, ishin shkrire në një qenje, që as vetë nuk po dinte si me ia vu emrin.

"Ky asht mendjendamë", thoshnin njerëzit dhe nuk ia ngau kush ma tej, atë vendimin e tij, për të mos u ndarë më kurrë me urën... mos hyni në gjynah më me të, thanë ca të tjerë. Sidoqoftë, njerëzit e familjes së vet, ndjeheshin keq për sjelljen e Hasanit, pasi sa herë që hapej në fshat muhabeti rreth tij, për ta shmangur e ruajtur familjen, e bënin si hasha, si një i shkuar dëm. Dhe nuk kishin faj. Po bëheshin afër tri vite, që ruante urën, pa asnjë lloj pagese. Përtej kësaj, uniforma e xhandarit, ishte yrrnek më vete...

Dikush pat hedh idenë para do kohe, për të mbledhur katundet e asaj ane dhe për të grumbulluar disa të holla, aq sa kishte pasur rrogën më parë, por Hasani e pat kundërshtar prerë -nuk e pranoj kurrë. Mue lekët e rrogës teme, do të m'i japë Mbreti. Pikë. E di Mbreti se si dhe kur. Ju merruni me punët tuaja, unë me timen. Kaq asht kjo gjë.

*

Aty nga mesi i vitit 1942, një autokolonë e ushtrisë fashiste po kalonte për në Dibër.

Kolonel Ganini, në krye të saj, i lodhur nga rruga e gjatë, përhumbshëm sodiste luginën e bukur të Matit, me kokën e mbështetur në pëllëmbë, gjysëm përgjumur, ndërkohë në anë të xhadesë i tërhoqi vëmendjen një burrë me uniformën e xhandarmarisë së Mbretërisë së Zogut, me pushkë në krah, tek ecte serbes në punë të tij, pa ja ndjerë se aty po kalonte një autokolonë e ushtrisë që ja kishte përzënë Mbretin...

- Kush është ky, - pyeti ordinancën që kishte pranë.

- Nuk po kuptoj asgjë, - ia ktheu shefit.

- Ndalo, - i tha shoferit dhe urdhëroi qe t'ia sillnin aty atë njeri gjysëm të rreckosur, por që kishte të gjitha shenjat ushtarake të xhandarit të Zogut, si dhe armën e asaj kohe, pavarësisht se edhe ajo italiane ishte.

- Kush je ti? - e pyeti koloneli, duke e vështruar vagullt atë burrë në gjysmë të moshës, thatim, me një uniformë të dalë boje, por edhe të arnuar diku - diku, a thua se iu fantaks vetë Don Kishoti në buzëmbrëmje asaj lugine, nisur askush se dinte se për ku.

- Xhandari i Mbretit, - ia ktheu serbes Hasan aga, duke e tërhequr me tërsëllimë rripin e pushkës përpara, si një kafshë e prapë që s'donte t'i bindej, pa ia ndjerë aspak se ushtria që po kalonte e kishte përzënë Mbretin dy vjet më parë dhe burri që po e pyeste ishte komandanti i saj.

- Për ku je nisur? - e pyeti koloneli.

- Te puna ime, - iu kthye Hasani me tërsëllimë.

- Ku na qenka kjo puna jote?

- Jam roja i Mbretit! Ai më ka lanë me ruajt këtë urën që këput Matin këtu matanë.

- Po ti kush je? - ia priti Hasan aga, më zotërues se koloneli, por përkthyesi nuk ia përcolli shefit të vet, pyetjen idiote të xhandarit.

- Po Mbreti ka ikur! Për cilin mbret po flet?

- Ka hik, apo s'ka hik, e di Mbreti atë punë. Ti shif punët tuaja. Mbreti i di vetë punët e veta. Ti një ushtar je si gjithë të tjerët, ndërsa ai kudo që të jetë asht Mbret, or ti.

Sigurisht që përkthyesi ia mori dorën, duke i përkthyer krejtësisht gjëra të tjera, që kishin të bënin me natyrën dhe bukuritë e asaj lugine me të vërtetë të mahnitshme.

- Kush të paguan ty?...

- E di Mbreti se kush më paguan mue, ty nuk të duhet gja ajo punë. Atë punë e di Ai, - këmbënguli Hasani. - Unë nuk iki prej kësaj pune pa më thanë Mbreti. Kur të thotë Ai, po. Vetëm Atij ia dorëzoj punën unë.

Koloneli pikasi se përkthyesi nuk po ishte korrekt dhe i tërhoqi vëmendjen që t'ia përkthente çdo fjalë, pasi po e shijonte këtë kokorroq të çuditshëm me uniformë të arnuar e të dalë boje kësaj lugine në fund të botës.

- Si ka qenë ky Mbreti juaj? - e pyeti koloneli.

- Naltamdhnia, ka qanë e asht mbreti ma i mirë në gjithë dynjanë, or ti.

- Mirë, - ia bëri koloneli, si të pohonte dhe ai konsideratën e tij. - A do të pranosh të bëhesh pjesë e ushtrisë fashiste?

- Pa më thanë Mbreti, jo!

- Po sikur të thotë ai?

- Po - ia ktheu prerë Hasani dhe nuk harroi ta shtrëngonte përsëri rripin e pushkës me tërsëllimë, duke marrë një qëndrim sa më ushtarak, por ai s'e kuptonte se po bëhej një Zhvejk thatim ballkanas, megjithatë mjaftueshëm për ta engledisur kolonel Ganinin.

Koloneli thirri itendentin dhe e urdhëroi që ta paguante xhandarin për kohën që kishte shërbyer pa pagesë.

Pas përllogaritjeve, itendenti bëri gati paratë dhe ia dha kolonelit.

Koloneli, me një buzëqeshje ia zgjati tufën e liretave Hasanit.

Hasan aga, pasi i mori nga dora e kolonelit, i numëroi me ngadalë një e për një Lirat italiane dhe si u thye nga koloneli, tha:

- Ju rrit ndera Naltmadhnisë ene ty, që m'i prune dhe pasi e nderoi "alla zogisht", ktheu shpinën, dhe u largua në drejtim të urës.

Kolonelit i rrëshqiti një buzëqeshje teksa ndiqte largimin e xhandarit më të famshëm që kishte njohur dhe i zbriti ndërmend Niçja i famshëm... Filantropia, është një Ego e kamufluar, asgjë më shumë, e as më pak. Sidoqoftë e bëri të ndjehej mirë ky Donkishot që këmbëngulte me mendjen e vet, se ato para i vinin nga Mbreti, i cili as vetë ai nuk dinte se ku kishte përfunduar, e megjithatë pikërisht ky fakt zu ti krijojë prajshëm sëbrendshmi në shpirt një lloj gazmendi, si një sëmbim pranvere, nën tinguj që zbresin pa leje, drejtpërdrejt në shpirt.

*

- Jo, po, se ç'na qenka, iu tha gjithë kapadillek katundarëve të vet Hasan aga. Jo, po, se ju nuk më keni ndigjue mue. Ma keni mërzit jetën ka dy vjet e gjysë. A e morët vesht? Mreti ma çoi rrogën lek e më lek, - hë hë, tundi kokën "xhandari".

- Për çfarë rroge po flet, Hasan aga, - ia krisën të qeshurës fshatarët e tij. - Mbreti nuk e di se ku është vetë, e të paska çue rrogën ty? A je ne vete, mor burrë? Apo të ka ik miza krejt?

- Pasha Allahun, ka ardh mbramë nji gjeneral prej Tirane që kishte çue Naltmadhnia, e m'i ka pru lek e'mlek, siç e kam pas rrogën për dy vjet e gjysë.

Fshatarët shtangën. Hasanin e njihnin për njëfarë të krisuri, por ai nuk gënjente kurrë.

- Po si bani vaki kjo punë, Hasan aga?

- Kam dy vjet e kusur që ju them, por ju nuk merrni vesht. Janë punë hyqymeti këto punë, e nuk i dini fort mirë. Nuk ju ve faj, se s'keni punu n'shtet, - ngrefej Hasan aga, si dijetari i punëve të mëdhaja...

Tiranë, mars 2019

Emil Zola dhe fotografia - një faqe dashurie

Nga Xhyher Cani PhD

Shkrimtari Emil Zola si artist fotograf afirmohet fillimisht si eksperimentues autodidakt i pasionuar pas njohurive teknologjike të përparuara në fushën e fotografisë, që i teston dhe i pasuron me mësime dhe vizita në atelietë e mjeshtërve të mëdhenj.

Krahas Emil Zolait romancier, krijuesit të ciklit të Rougon – Macquar-it, Zolait gazetar dhe kritik i artit, Zolait autor i pamfletit elokuent kundër padrejtësisë "Unë akozoj/J'accuse ", ekziston dhe një profil më pak i njohur nga formati-gjeni i shkrimtarit, po aq magjepës sa dhe portretet e tjera - Emil Zolai fotograf.

Gjeni i letrave dhe lider i romanit naturalist, Emil Zolai (1840-1902) është gjithashtu një njeri i imazhit. Edhe pse fotografia filloi si *hobby p*ër babain e serisë Rougon-Macquart, edhe në këtë fushë krijimtarie artistike spikat talenti madhor i tij dhe pasioni për fotografinë, që zgjati deri në fund të jetës.

Në këtë profil të dyfishtë artistik takohet shkrimtari gjenial dhe fotografi plot ndjenjë që punonte me devizën : "Asnjë ditë pa shkruar dhe asnjë ditë pa imazh".

Zolai si artist fotograf afirmohet fillimisht si eksperimentues autodidakt i pasionuar pas njohurive teknologjike të përparuara në fushën e fotografisë, që i teston dhe i pasuron me mësime dhe vizita në atelietë e mjeshtërve të mëdhenj. Të dyja këto profile, të ushqyera nga vizioni krijues, karakterizohen nga i njëjti mekanizëm: *syri*, i cili vështron, vëzhgon dhe pasqyron me realizëm natyrën dhe shoqërinë.

Më 1894, Emil Zolai ishte 54 vjeç dhe pothuajse e kishte përfunduar veprën e tij madhore letrare, Rougon-Macquart, kur nisi një krijimtari të re, atë të fotografisë, duke instaluar nga një laborator fotografik në secilën prej rezidencave e tij, në Paris, Verneuil dhe në Medan. I etur për të fotografuar, ai realizoi një fond prej 7000 negativash fotografike me tema intime, shoqërore dhe artistike, duke skicuar kështu albumin e tij të ardhshëm, që përbën kantierin e tij të madh fotografik që tashmë kishte ëndërruar.

Shkrimtari ndante ndërkohë jetën e tij familjare në çift me bashkëshorten legjitime, Aleksandrina Melej (Alexandrine Meley), me të cilën nuk pati asnjëherë fëmijë dhe me të dashurën, Zhanë Rozero (Jeanne Rozerot), që i solli në jetë dy fëmijë, Denizën dhe Zhakun (Jacques). Kjo jetë e dyfishtë do të mbetet e fshehtë deri në vitin 1891, datë që përkon edhe me fillimin e pasionit të tij për fotografinë. Më 1897, Zolai realizon albumin i tij luksoz fotografik, të titulluar *Denize* dhe *Jacques, Histoire vrai*, me dedikim plot ndjenjë, kushtuar Zhanës, që përfundimisht legjitimon lidhjen e tij intime familjare në imazh.

Në fokus është kryesisht sfera familjare ; portretet e gruas, portretet e së dashurës dhe fëmijëve që formojnë ansamblin madhor të veprës së tij fotografike ; portrete krejt të thjeshta, të realizuara me spontanitetin e çastit, me një përkujdesje të përpiktë të dritës dhe gjithmonë me një tis ëmbëlsie në përjetësimin e modeleve. Të kompozuara në çaste madhështore apo të thjeshta, por gjithmonë shprehëse, albumi familjar bëhet një fiksion nostalgjik.

Këto fotografi luajnë rolin e talismanit dhe janë objekte fetishe që mishërojnë portrete të dashura.Vetëm një pakicë fotografish, të gjykuara të vlefshme, i kushtohen rrugës së botimit. Ky libër fotografik familjar me faqe imazhesh është një roman i vërtetë fotografik, ku takohen së bashku brezat familjarë, kronika dhe ritmi i jetës. Në këtë kontekst, albumi fotografik është tepër intim dhe bëhet një formë shprehjeje e jetës së përbashkët protokollare, ku vatra familjare depoziton yjësinë e ndjenjave që e rrethon.

Në këto negativa fotografike, përfaqësuese të temave të parapëlqyera të Zolait, shihen kompozime formale të imazheve me një poetikë ikonike, ku fotografitë e tij evokojnë tablotë e pikturës, me ekulibrat dhe simetritë, me rimat dhe ritmet plastike, me plane që të kujtojnë skicat topografike të romaneve të tij. Kjo intuitë formale që merr pjesë në realizimin e bukurive të këtyre fotografive, nuk është asnjëherë abstrakte; ajo shërben si poezi, duke thyer kodet estetike të imazheve të epokës me skena të mbingarkuara panoramike marramendëse. Veç sferës familjare, në fokusin e aparatit të Zolait u përjetësuan edhe portretet e miqve të tij, Maupassant-it, Huysmans-it dhe Cézanne-it.

Figurë e shquar e natyralizmit letrar, ku përshkrimet e tij ishin më të vërteta se vetë natyra, Zolai ishte gjithmonë i pranishëm për të fiksuar të dielat familjare, shëtitjet me biçikletë dhe lëvizjet e trenave të Parisit. Fotografia e tij mbetet intime dhe dokumenton të përditshmen, duke fokusuar qeniet e tij më të dashura. Pa dyshim që Zolai bëhet me kohë fotograf me një përgatitje të lartë teknike. Ai zotëron përdorimin e aparatit të tij panoramik, duke variuar me këndet e pamjeve dhe duke u përpjekur papushim të fiksojë përjetimet e tij të ndjera estetikisht.



Në raportin mes shkrimtarit dhe fotografit shihet një relacion pjellor mes njeriut dhe objektit teknologjik, një praktikë racionale që mundëson forma pamore krijuese të një fotografi që nuk i mungonte tashmë syri estetik dhe artistik.

Fotografia e Zolait nxjerr në pah energjinë mbi palëvizshmërinë, vë në dukje ritmin e jetës kundër pozave statike të përftuara në atelie. Kështu, lëvizjet trupore të fëmijëve që vrapojnë drejt objektivit, lodrat vallëzuese të kushërinjve në Medan, sfidat e turmave në *Ekspozitën Universale të Parisit* të vitit 1900, dinamika plot jetë e Londrës, kur ndodhej në ekzil, flasin për një temperament artisti, për një nënshkrim vetjak estetik, për një aventurë fotografike drejt horizonteve me sharm, larg kopjeve naive të një realiteti të përditshëm.

Fotografia është një akt refleksioni. Artisti që fotografon, përpiqet të japë identitetin e objektit që fokuson, ai e asimilon, e sintetizon dhe e përshtat atë në kompozimin artistik që synon. Sigurisht, procesi i fotografimit nuk është thjesht regjistrim automatik. Artisti i vërtetë nuk braktis rendin pamor, por respekton gjithë kriteret artistike dhe teknike: pozimin, kuadrimin, ndriçimin, si dhe proceset kimike. Raportet e Zolait me fotografinë janë komplekse dhe origjinale.

Vepra fotografike e Zolait evokon një qasje tjetër të shkrimtarit, një tonalitet ndryshe, pothuajse sentimental me stilin e shkrimtarit që ishte nganjëherë edhe gazetar, edhe polemist, dhe kaloi nga realizmi në natyralizëm. Imazhet e albumit fotografik nuk evokojnë ciklin e romaneve të tij, por na hapin me dashuri dhe ëmbëlsi portën e sferës intime të autorit.

Emil Zolai shkrimtar nuk mund ta konsideronte fotografinê si njê kalim kohe për t'u argêtuar, pêrkundrazi, ai kuptoi shumê shpejt autonominê reale dhe shkencore tê kêtij mjeti shprehês.

Mendimi i Zolait kulmon në vëzhgimin e tij estetik "mbi faktet e natyrês", kur e përkufizon fotografinë si mjetin ideal për të kapur dhe theksuar një veshtrim në detaje të realitetit.

"Kur evokoj objekte qê kam parë, - shkruante Zolai -, unë i rishikoj tê tilla, ashtu siç janë realisht, me linjat, format, ngjyrat, aromat dhe tingujt e tyre".

Edhe pse Zolai këshillohej me mjeshtrin e madh fotograf të kohës, Nadar-in, me të cilin shkëmbente një korrespondencë të pasur, Zolai në fushën e fotografisë u vetëformua si autodidakt, përmes eksperimentit dhe, më pas, fitoi përvojën e duhur. Koha e pozimit, korrigjimet e nevojshme gjatë punës, cilësia e pllakave të xhamta të përdorura, aplikimi me rigorozitet i teknikave vetjake dhe përpjekjet e panumërta për të kapur atë që kërkonte në objektin e fokusuar, të gjitha këto cilësi lartësonin veprën fotografike të Zolait.

"Sipas mendimit tim, ju nuk mund të thoni se e keni parë diçka në themel, nëse ju nuk i keni bërë një fotografi", - theksonte në një intervistë *Njeriu* i letrave, i pasionuar pas imazhit.

Në këtë refleksion të Zolait, që përkufizon me elegancë vështrimin

Shtëpi angleze

fotografik, bëhet e mundur të shikosh edhe atë që nuk mund ta dallosh. Në fakt, detaji vjen nga fuqia e objektivit, nga përpikmëria e kuadrimit, nga improvizimi i çastit të fokusimit, me një fjalë, nga i gjithë sistemi teknik dhe niveli i dijes së fotografit që manipulon.

Zolai punoi në epokën e pllakave të xhamta, por edhe më pas, me daljet e para të pelikulës, ai zotëroi me përsosmëri gjithë proceset kimike argjentike ose cianotipe.

Për 10 vjet rresht, Zolai do të kompozonte albume fotografike vetjake, pa kërkuar kurrë t'i publikojë këto imazhe. Për të, fotografia ishte "*Violina*

Rrethinat e Londrës - Pallati i kristaleve

*e tij e re e Ingres*it"; ajo u kthye në burim frymëzimi dhe dëshmi kënaqësie e sferës intime familjare dhe shoqërore. Dhe për ironi të fatit, duhej pritur njëqind vjet, deri në vitet 80 të shekullit të kaluar, që publiku të befasohej me një faqe tjetër artistike të këtij mjeshtri të madh që kishte gdhendur tashmë letërsinë. *Zolai fotograf* (*Zola photographe)* do të ishte libri që do të botonte nipi i tij, duke nxjerrë në pah pasionin dhe dashurinë e gjyshit të tij të shquar për fotografinë. Për historianët dhe kritikët e fotografisë, metoda letrare e natyralizmit ndikoi në praktikën e tij fotografike fine.

Ky aktivitet i babait të natyralizmit për një kohë të gjatë është injoruar apo është lënë në hije, nisur nga masivi gjigand i prodhimit të tij letrar Aktualisht, është e vështirë të vlerësohet realisht veprimtaria e tij fotografike, ngaqë ende sot trashëgimi i koleksionit të tij fotografik nuk është rekuperuar dhe restauruar tërësisht.

"Zolai fotograf" i François Emil – Zola-it dhe i Massin-it ka qenë, në fakt, një zbulim për publikun, por, në një farë mënyre, ka rritur edhe enigmën e profilit teknik dhe artistik prej mjeshtri fotograf të Zolait. Në punën e tij spikat mënyra e të shprehurit plot vërtetësi, e karakterizuar nga mungesa e retushit, braktisja e aksesorëve kanonikë, shfrytëzimi i kapjes së çastit të duhur, pozimi me fleksibilitet kohe, procesi i fotografimit gjithmonë në mjedise të hapura, madje edhe kur fotografonte natën etj.; kjo mënyrë e të shprehurit është provë e shijes së tij për procesin e të fotografuarit, ku teknika ngjizej me ndjenjën e tij artistike. Fotografitë në statusin e babait të familjes që Zolai realizon në albumin e famshëm *Histoire vrai,* që shkrimtari fotograf u dedikon fëmijëve dhe Zhanës, është përmbushja e përkryer e aktit të devocionit familjar, duke krijuar një "mal" imazhesh që do të vazhdojë të ngrihet deri në fund të jetës së tij

Ky legjitimitet familjar nënshkruhet nga një baba shkrimtar, i dashuruar dhe i pasionuar pas fotografisë, që koleksionon në objektivin e tij me një art të madh dhe me natyrshmëri të afërmit e tij, duke e bërë tejet të dukshme lumturinë që ai përjeton. Zolai shkrimtar, i dashuruar pas imazhit, është një fotograf i mirë, një artist ekuivalent me profilin e artistit që hyri në histori me penë në dorë. Zolai është një amator që nuk ushtroi artin e tij në fotografi me amatorizëm, por një fotograf që ushtroi artin e tij plot përkushtim dhe me përsosmëri teknike. Vizioni i Zolasë si autor që skanoi në detaje shoqërinë e kohës, bashkohet me vështrimin e fotografit, ku kujdesi, saktësia, improvizimi i çastit të gjetur janë të pranishme në negativat e tij. Por, megjithatë, Zolai nuk ka ekspozuar kurrë, ai nuk i shpërndau kurrë imazhet e tij, edhe pse spikasnin nga humanizmi. Në të dyja aktivitetet e tij krijuese, si shkrimtar dhe fotograf, ku njëri aktivitet është publik dhe tjetri privat, kodi krijues estetik është i pranishëm. Shënimet teknike të zbuluara më vonë në fletoret e punës së shkrimtarit, sjellin të dhëna për kohën e pozimit, kapjen e objektivit, kompozimin kimik të kripërave dhe shkallën e ndriçimit, cilësi që karakterizojnë një fotograf të emancipuar teknikisht.

Zolai dinte të vështronte me sy piktori dhe të fiksonte vizionin e çastit; Zolai kishte frekuentuar shkollën e piktorëve, në atelienë e Manesë (Edouard Manet), ku edhe aty mori mësime; dhe kjo nuk ishte pa efektivitet. Zolai mësoi nga piktura kapjen e detajit dhe sensin e kompozimit dhe, ashtu si Maneja, vështrimi i tij artistik dinte të depërtonte në terren, veçanërisht në mjediset peisazhiste. Madje, teksti zolian i dosjeve përgatitore të veprave të tij është përceptuar si një performancë vizuale, ku cilësitë më të spikatura janë përpikmëria, saktësia, njëkohëshmëria dhe gjerësia, cilësi që flasin për përsosmërinë e aparatit fotografik. Zhvendosja e Zolait shkrimtar në terrenin e piktorëve, në vetë vendin e aksionit, zbulon më mirë statusin e fotografit.

Zolai është një romancier fotograf dhe jo një fotograf romancier. Në këtë pikëvështrim, *Albumi* fotografik i Zolait është një vepër krijuese artistike, ashtu si romani i tij natyralist, sepse na ofron një narrativë të jetës dhe me këtë kureshtje ne e "lexojmë".

Por një album ka karakter privat dhe nuk ka karakterin publik të romanit. Sigurisht, procesi i krijimit të *Albumit* nuk është ai i romanit. por kur shkrimtari është dhe fotograf, *hyjëzimi* artistik vezullon edhe më shumë.

Burimet e konsultuara

Zola, Emile, *Lettres à Jeanne Rozerot,1892-1902*, presentée et annotée par Brigitte Emile –Zola et Alain Pagés, Editions, Gallimard, Paris, 2004.

La photographie zolienne: Histoire vraie, in "Ariane", Revue d'études littéraires française: Le Cercle des Muses (II), n°17 (2000-2001).

Une ethnographie inédite de la France, textes établis et présentés par Henri Mitterand, introd. de Jean Malaurie, avant-propos de H. Mitterand, Plon, 1986.

Le Roman mis à nu par la photographie, même, in "*Romantisme"*, n°105 (1999).

Les métamorphoses du 'cadre. Le principe du cadrage dans l'avant-texte des Rougon-Macquart, *in* Jean-Pierre Leduc-Adine (dir.) Zola. *Genèse de l'œuvre*, CNRS Éditions, 2002,

Philippe Ortel, *La Littérature à l'ère de la photographie. Enquête sur une révolution invisible*, Nîmes, éd. Jacqueline Chambon, 2002.

ZOLA PHOTO, 480 documents choisis et présentés par François - Émile-Zola et Robert Massin, Editions² Hoebeke, 1990.

"*Zola en images*", *Les Cahiers du naturalisme,* n° 66.

Denisa dhe Zhani

Poezia "Silvias" e Giacomo Leopardi-t

TË LEXOSH POEZINË SI NJË PARTITURË

Nga Natasha Poroçani

(Vijon nga numri i kaluar)

Leopardi shoqëron idetë me efektet e prodhuara nga tingujt dhe në këtë rast kjo proçede funksionon si një katalizator në raportin mes realitetit poetik dhe idesë së tij mbi të vërtetën.

Me zanoren *i* shoqërohen tinguj ose zhurma reale, apo edhe impresione akustike pak a shumë simbolike, sidomos kur ky tingull na shfaqet në sufikset *io/ia*: Konkretisht *gioventù, maggio, giorno, Io, mio, miglior, ch'io, fior, chiome, ragionava, giovanezza, ragionam. Silvia, leggiadri, lasciando, mia, apparia, pria,* nëse i hulumtojmë këto fjalë në përdorimet e tyre brenda vargjeve, konstatojmë se efekti i tyre shoqëron idetë filozofike të Leopardit, përkatësisht: *Silvia*, *gioventù, maggio, leggiadri, lasciando* -pranvera e fundit e Silvias*; giorno*-zhurma simbolike e një faze të jetës iluzive*; Io, mio, miglior, mia, apparia* - identifikimi i vetvetes dhe përballja me mungesën e shpresës*; ch'io, fior, chiome, ragionava, giovanezza, ragionam, pria*-kthimi në pashpresën e gjetjes së vetvetes.

c-fjala çelës: Silvia

Në muzikën e poezisë së Leopardit përsëritjet e tingujve përzihen dhe reflektojnë të njëjtën fjalë/semë/figurë me të cilën dialogon mendimi i poetit: është fjala për praninë e Silvias, jo më si emër, por si një çelës muzikor që lidh tonalitetin e disa figurave:

-*v*-ja për të cilën folëm më lart;

-*apostrofët*: (v. 1: "*Silvia*"; v. 29: "*o Silvia mia*"; v. 36: "*o natura, o natura*"; v. 43: "*o tenerella*"; vv. 54-55: "*cara compagna dell'età mia nova, mia lacrimata speme*"; v. 61: "*tu misera*");

-*anagramën*: "*Silvia…salivi*" (vv. 1 e 6);

-*anaforat*: "*Che pensieri soavi, / Che speranze, Che cori*" (vv. 28-29); "*perché non rendi poi…./ perché di tanto…*" (vv. 38-39); "*questo è quel mondo? Questi / i diletti… / Questa la sorte…*" (vv. 56-59)

-*përsëritjet*: "*o natura, o natura*" (v. 36); "*come, / come passata sei..*" (v. 53);

-*polisidentin* **:**"*che pensieri soavi, che speranze, che cori…*" (vv. 28-29)

Nga kjo ulje dhe ngritje e tonit, nga kombinimet e kaq shumë zanoreve brenda vargjeve lidhen idetë e Leopardit me simbolikën e Silvias. Duke variabilizuar deri në limite këtë lojë tingujsh, në të vërtetë ajo nis te rimat: v: 4-6; 10-11; 12-13; 8-14; 16-18; 20-21; 23-27; 32-33; 35-36; 37-39; 46-47; 50-53; 57-59; 55-58; 61-63; dhe asonancat: v: 2-5; 29-30; 56-57;

Këtë mori tingujsh të dominuar nga zanoret dhe diftongjet, e bën akoma më komplekse struktura sintaksore e thyer, e etiketuar ndryshe si *enjambements*[1]: "*sonavan le quiete / stanze"* (vv. 7-8); "*peria fra poco / la speranza mia dolce*" (vv. 49-50); "*negaro i fati / la giovanezza*" (vv. 52-53); "*questi / i diletti*" (vv. 56-57); "*la fredda morte ed una tomba ignuda / mostravi"* (vv. 62-63). Këto shkëputje të periudhës në vargun pararendës, për t`u rimarrë në vargun e mëpasëm, krijojnë lëvizjen e kërcimit të *kastelanës*, valle tipike rekanatase[2] plot ritëm nën muzikën e klaviçenbalit.

Përmes morisë së instrumenteve tingullorë (figurat retorike) muzika synon të endë një seri korrepondencash mes fjalëve dhe ideve, duke dhënë jo imazhe mes fjalëve, por imazhe mes tingujve. Silvia vetë është një imazh. Kënga e saj është e vetmja e dhënë fizike e plotë që na flet, na dialogon ne si lexues, sepse *flokët e errët (La dolce lode or delle negre chiome)* që përmend Leopardi janë shenjë vetëm e bukurisë së Silvias. Pra, Silvia është çelësi i solit që ndërton e udhëheq partiturën. Teksti poetik i Leopardit ka një strukturë të afërt me një kompozim muzikor, të ngjashëm me muzikën e popullit të tij, e bukur për t`u dëgjuar, e lehtë për t`u kërcyer.

E vërteta e Leopardit në ekuivalenca tekstuale (rruga e vështirë drejt shqipërimit)

Todorov poezinë e klasifikon si arti që prek kryesisht *dëgjimin*, *por që ka nevojë për ligjërimin e garantuar "atë lloj marrëveshjeje, që i cakton çdo ideje një tingull, i cili bëhet vula dhe simboli i saj."*[3] Ndërsa një lexues besnik dhe "haker" i Leopardit, shpenzon kohën e tij të paktë në dritaren përballë shtëpisë së Terezës, vargjet e Silvias ngjallin tek ai një efekt të çuditshëm që të fton të pajtosh realitetin ku lexuesi jeton (shekullin XXI) me imagjinatën ku të shpinte zhurma e avëlmentit dhe zëri i Silvias ndërsa endte (shekulli XIX). Siç kemi dashur të pohojmë, ndërsa kemi shkruar më sipër, zëri i Silvias prevalon poezinë e Leopardit. Një eufoni perfekte falë aq shumë tingujsh e muzike që të ngrenë peshë, por edhe një kakofoni e trishtë, kur mes asaj eufonie silviane, të vjen edhe zëri i Leopardit, i shembur nga e vërteta e hidhur që e takon në çastin kur identifikon fatin e tij. Për ta sjellë këtë dualitet (eufoni-kakofoni) në shqip, na duhet të thellojmë njohjet e të përdorim çelsin (jo më të solit) filozofik të fjalëve dhe figurave retorike. Të shpërbëjmë Silvian/ poezinë.

Ashtu si lexuesi dhe dëshmuesi i *rrafshit të përmbajtjes*, Leopardi-spektator përgjonte këngën e Silvias: *D'in su i veroni del paterno ostello/ Porgea gli orecchi al suon della tua voce.* I mbetur pas mureve, për më tepër i ndrydhur në shtatë vitet e studimi të rreptë: *Io gli studi leggiadri/ Talor lasciando e le sudate carte,/ Ove il tempo mio primo.* Ballkonet të cilësuara nga kritika[4] si pengesa, kufiri mes poetit dhe botës së jashtme, duken më shumë si lidhje e tij me botën, një dritare nga ku ai do të identifikojë fatin dhe perspektivën vetjake. Duke analizuar nënshtresimet semantike që referojnë vargjet e tij, për të shkuar deri te e vërteta.

Vetë folja *porgea* (përgjonte) e nxjerr poetin nga pallati, sepse ai nis e imagjinon: *Mirava il ciel sereno,/ Le vie dorate e gli orti,/E quinci il mar da lungi, e quindi il monte./ Lingua mortal non dice/ Quel ch'io sentiva in seno.* Dhe imagjinata e dërgon në qiell, në hënë, në shesh, në shtëpinë e Silvias, në kopsht, në vende ku nxitet nga zëri i këngës së saj. Ta sjellësh këtë enumeracion në një gjuhë tjetër, shfaq vështirësinë e gjetjes së konotacionit semantik të duhur, i cili të mund të përcjellë tonin euforik e iluziv të imagjinatës së poetit. *Vështroja qiellin e pastër,/rrugët e diellta e rrugicat,/ këndej detin e kthjellët së larti, të lartin mal./ T'rrëfente se ç'vlonte në gjoks,/fjala më ishte e varfër.*

Në marrëdhënien dialoguese të poetit me Silvian, fjala që merr peshë dhe del nga kuptimi i një foljeje duke u kthyer në koncept është folja *rimembri,* e shoqëruar nga ndajfolja *ancora*. Nëse i referohemi identifikimit të Baziçit, folja *rimembri* duhet të përkojë në shqipen tonë me një folje, e cila të përmbledhë disa të dhëna:

- fazën e mallit (*Silvia, rimembri ancora Quel tempo della tua vita mortale,/ Quando beltà splendea/Negli occhi tuoi ridenti e fuggitivi,/E tu, lieta e pensosa, il limitare/ Di gioventù salivi?*),
- sfondin e qetë pranveror (*Era il maggio odoroso: e tu solevi/Così menare il giorno.*), periudhë të jetës njerëzore, rininë (*Io gli studi leggiadri/Talor lasciando e le sudate carte,/ Ove il tempo mio primo/. E di me si spendea la miglior parte*),
- pohimin kulmor të kësaj ndjesie (*Lingua mortal non dice/ Quel ch'io sentiva in seno*).

Semantikisht folja përmbledh konceptin e një jete njerëzore iluzive, por e shtrirë në një prerje të hapësirës kohore: koha e djeshme e iluzioneve, koha e tanishme e identifikimit. E vendosur brenda pyetjes retorike (*Silvia, rimembri ancora*), foja e lëviz vargun nëpër vende, ku orientues është zëri i Silvias dhe ndjesia e mallit e bën avullore imazhin, të ndjeshëm, të hareshëm nga tingujt e këngës së saj, por edhe të trishtë për shkak të fatit që i pret të dy, Silvian dhe poetin. Për ta përcjellë këtë koncept, të plotë në dualitetin dhe kakofoninë e tij, folja *kujtoj*[5] e shqipes është e zbehtë, sepse e kufizon semantikisht mendimin, e përcjell si folje që lidh fakte, ngjarje, por nuk lidh imazhe. Për këtë gjykuam se folja *ndërmendet (Silvia, të ndërmendet ende*), falë formimit të saj *ndër+mend*, arrin të realizojë gjithpërfshirjen. Parafjala *ndër*[6] e shoqëruar me emrin *mend* e shtrin procesin në qerthullin që numëruam më lart dhe ky proces bëhet pa ndërprerje. Duke u kthyer në folje fjala e re, e krijuar përcjell procesin jo vetëm në dinamikë, por edhe në vagullsinë e tij, sepse semantikisht parafjala i shtrin mendimet përderisa ajo vendos një marrëdhënie të pandërprerë mes Silvias dhe Poetit.

Sigurisht që, ndërsa një gjuhë pret t`i sjellësh një poezi, rrugët që të ofron po aq sa të duken pa krye, po aq edhe sapo merr kthesën e padukshme të shfaqin një dalje të re. Kjo ka të bëjë me kuptimësinë që fjala dhe teksti fiton në kontekstet e reja ku përdoret, si dhe me instrumentin retorik nëpërmjet të cilit ata vijnë. Rruga e re nëpër të cilën po vjen fjala/teksti negocion me cilësitë (*të qenësishme, diagnositukuese apo rastësore*[7]) për të realizuar përzgjedhjen e duhur dhe për ta transferuar atë në gjuhën pritëse duke respektuar përmbajtjen nukleare të idesë së vargut, por duke ruajtur edhe përmbajtjen nukleare të fjalës/tekstit. Në vargjet: *Che pensieri soavi,/ Che speranze, che cori, o Silvia mia!/ Quale allor ci apparia/ La vita umana e il fato!,* është një thirrje e dyfishtë brenda së cilës pohohet vrulli i iluzioneve të rinisë së hershme (mendime, shpresa, tallaze), të cilat lidhëza *che* (ç`-në shqip) nëpërmjet tonalitetit pyetës që e përcjell në bërthamën e saj nukleare, shoqëron dhe një ndjenjë euforike habie. Dhe dialogu kthehet në monolog kur teksti bëhet diagnostikues: kjo është jeta dhe fati. Kjo cilësi diagnositikuese që na e përcjell metafora (*ci apparia)* në këtë kontekst është e vetmja fushëpamje e rinisë së dikurshme. Ndaj dhe ne e gjykojmë zgjedhjen e vetme që u përcillte fati: *Sa të ëmbla mendimet/ sa shpresa e sa ndjesi, e imja Silvia!/Si na shfaqej atëherë/jeta e njeriut dhe fati!*

Po me të njëjtën formë transmetohet malli për një kohë të bukur e të bekuar: *E tu, lieta e pensosa, il limitare/Di gioventù salivi-E ti, gëzimmenduara kaloje/ të hershmin e rinisë prag.* Vetëm se në këtë rast *lieta e pensiosa*, nuk janë cilësime diagnostikuese, por të qenësishme. Ato përcaktojnë disa tipare morale, të imazhit që poeti ka për Silvian, jo të Silvias. Duhej një retorikë e caktuar që ta përcillte këtë dinamikë sjelljeje imazherike. Në përgjithësi fjala në italisht nuk është fonetikisht aq e pavarur sa të rrëshqasë në vijimësinë e tingujve,[8] për shkak të theksit të saj të ngulitur. Kjo na e bën më të lehtë zgjedhjen fonetike dhe na ndihmon që përkatësia leksikore brenda sintagmës të jetë po aq e qenësishme semantikisht sa në gjuhën burimore, ndaj dhe zgjodhëm një neologjizëm (*mbiemër i emërzuar/metaforë*) krijuar posaçërisht për të përcjellë disa kuptime që referon sintagma: *E ti, gëzimmenduara kaloje.*

Pasi ka evokuar bukurinë dhe zërin e Silvias, pasi ka pohuar të vërtetën mbi pamundësitë e një marrëdhënieje absolute gjuhë-mendim-emocion, (*Lingua mortal non dice/ Quel ch'io sentiva in seno),* pasi ka përgatitur me pyetjen e dyfishtë lexuesin, Leopardi kalon në tone të një dhimbjeje të fortë, nëpërmjet apostrofit: *O natura, o natura,/ Perché non rendi poi/ Quel che prometti allor? perché di tanto/ Inganni i figli tuoi?* dhe pyetjes retorike drejtuar natyrës, duke akuzuar. Kjo akuzë filozofike mishtohet në disa figura *apostrof, pyetje retorike, inversion, enjambements.* Poeti ka hedhur sfidën e poezisë së tij: romantikisht ai është i prirur të shprehë të pashprehurën. Sjellja në gjuhën pritëse kupton sistemin e brendshëm të figurave në gjuhën burimore, si dhe strukturën që ka përdorur poeti (e shtjelluam më herët muzikalitetin strukturor të poezisë). Referuar Galdit,[9] *apostrofi* përdoret kur diskursi zhvillohet me fjalë drejtuar personave apo gjërave prezente apo të imagjinuara dhe në rastin tonë, laiciteti (besojmë!) e dërgon poetin drejt natyrës. Ndaj dhe në shqip rasti është analog, lidhur me apostrofin. Figura që ne e quajtëm i*nversion* në fakt, në retorikën

---

1 Termi derivon nga frëngjishtja dhe do të thotë, pak a shumë, *ringjitje*. Është një figurë retorike që gjendet vetëm në poezi dhe konsiston në thyerjen, në fund të rreshtit të sintaksës së fjalisë në mënyrë të tillë që mendimi të vazhdojë në nisjen e rreshtit tjetër. Në prozë kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës sintaksore të periudhës.

2 Castellana është një valle tipike rekanatase dhe karakterizohet nga shpejtësia, është plot me lëvizje të gjalla. Ky vallëzim lindi në muret e qytetit, brenda kështjellave, nga të cilat ka marrë emrin. Melodia e kryer nga fizarmonika është e pikësuar nga ritmi i ngutshëm i klaviçelës, hapat rrjedhimisht janë të shpejtë dhe ritmikë. http://folkloremaceratese.blogspot.com/2006/02/caratteristiche-di-alcuni-balli-tipici.html

3 Tzevan Todorov, Teorie del simbolo, Garzanti, Milano 1991, fq 184 (Cit. R. Marteta, vep. cit., f. 102):

4 Stefania Notici, vep. Cit., f. 54.

5 Sjell ndërmend dikë a diçka: kujtoj fëmijërinë; i ngopuri s'e kujton të uriturin (fj. u.); / i sjell diçka ndërmend dikujt: ia kujtova ngjarjen. https://fjalorthi.com/kujtoj

6 ndër parafj. së bashku me një emër a përemër tregon vendin që zë dikush a diçka në mes ose në rrethin e disa gjërave, një vend në kuptim të figurshëm, vende të të njëjtit lloj, kohën, gjatë së cilës zhvillohet diçka pa ndërprerje etj.; midis, në, nëpër; gjatë: kam ndër mend; ndër të parët; ndër të tjera; ndër shekuj; ndër vete midis nesh; i ra ndër këmbë iu lut shumë; me shpirt ndër dhëmbë me mundim e me vuajtje të mëdha; duke hequr keq; në gjendje shumë të rëndë.

ndër- element fjalëformues; parashtesë e disa fjalëve të prejardhura, që tregon se diçka gjendet a vepron ndërmjet dy ose më shumë të tjerave, ka marrëdhënie të dyanshme në mes dy a më shumë gjërave etj. (p.sh. ndërshtetëror, ndërzanor; ndërhyj, ndërlidh; ndërveprim; i ndërsjellë etj.). https://fjalorthi.com/ndër?PageSpeed=noscript

7 Umberto Eco, vep. cit., f. 147.

8 Ladislao Galdi, vep. cit., f. 64.

9 Galdi, Idem, f. 190

e italishtes përafron me inversionin, por jo krejt. Sipas Galdit,[10] stilistika e Miljorinit (Migliorinit) dhe Kjapelit (Chiapelli) bën një dallim të fortë mes ndërtimit të rregullt të frazës dhe mundësive të ndryshme të *inversionit*[11], sipas të cilit ky i fundit shërben për t`i dhënë një reliev më të dukshëm një termi apo një kategorie sintaksore. Në rastin e Leopardit *inversioni* nuk është thjesht një fjalë apo një term, por një antitezë: *poi-allor* e realizuar me ndajfolje. Me pak fjalë, në këtë ndërtim sintaksor jolinear, ai që theksohet është produkti semantik i derivuar nga antiteza. Po ashtu *enjambements*-i ka efekte të padiskutueshme ritmike, që i referuam më herët. Shqipja duhet të krijojë në këtë rast një sistem të dyfishtë tekstor me kujdesin që të mos shkaktojë pasoja në planin semantik dhe atë sintaksor: *O natyrë, o natyrë,/pse tradhtove më vonë/ç'ka premtove dikur?/ Pse aq shpesh/bijtë e tu i mashtron?* Kjo është e vërteta filozofike që kërkon të dijë Leopardi, e cila e nis poetin përtej një ndjesie të thjeshtë dashurie e dhembshurie. Sipas identifikimit që bën Blasuçi momenti i dhembshurisë përkon me vargjet *Tu pria che l'erbe inaridisse il verno,/Da chiuso morbo combattuta e vinta, Perivi, o tenerella. E non vedevi/ Il fior degli anni tuoi;/ Non ti molceva il core/ La dolce lode or delle negre chiome,/ Or degli sguardi innamorati e schivi;/ Né teco le compagne ai dì festivi/ Ragionavan d'amore.* Një skenë e vendosur në dy rrafshe konverguese: nga njëra anë sfondi tragjik emotiv i vdekjes, dhe nga ana tjetër sfondi i trishtë i një vjeshte në ikje. Semantikisht kemi një fushë të gjërë, në të cilën fjalët që krijojnë hartën janë: *combattuta e vinta, perivi*. Një peizazh i bukur metaforik, ku duket se ngjyra dominuese është trishtimi. Fundi i rinisë, në këtë rast nuk është veçse fundi i jetës: lufton, pushton, humb, ikën. Nuk ka enumeracion veçse në imazhin e krijuar te lexuesi. *Ti, para se blerimi të zverdhej prej dimri/nga sëmundje tinëzare, luftëtare e mundur.*

shuheshe dashuri. E nuk mund ti të shihje/petalet e tëndes rini./Pa, në zemër nuk regëtije

nga fjalët e ëmbla për t'errtën floknajë,/për t'ëmblat vështrime dashurie të drojtur./Do mungoje kur shoqet të flisnin/ndër lodra dashurore.

Kritika italiane i ka kushtuar vëmendje të veçantë perifrazimit të Silvias dhe përvojës poetike të poetit, për të cilën Prete pohon se "*ndërsa përvoja poetike është gjithmonë një përvojë e teoricienëve, nga ana tjetër, përvoja filozofike ka të bëjë gjithmonë me poezinë, tronditet nga era e poezisë, nga hetimi i saj përfundimtar*."[12] Në tekstet e historisë së letërsisë është etiketuar si "*poeti i paqartësisë së iluzioneve*",[13] por edhe "*poet i mitizimit të figurës së Silvias*".[14] Këto interpretime të argumentuara sipas këndvështrimit të secilit studiues konvergojnë, pak a shumë, teorinë e Basuçit që ne kemi zgjedhur për t'iu qasur Silvias në analizën tonë, analizë e cila synon të gjejë një të mesme të artë në dyzimin: të shpëtojmë diçka apo të humbim diçka. Zgjidhjen e dualitetit që mund të konsiderohet tragjik në pamundësinë e tij për t`i paqtuar dy mundësitë, po ia referojmë në këtë kontekst vargjeve më delikate që përcjellin përvojën paralele mes jetës së Silvias dhe iluzioneve të poetit: A*nche peria fra poco/ La speranza mia dolce: agli anni miei/ Anche negaro i fati./ La giovanezza. Ahi come,/ Come passata sei,/ Cara compagna dell'età mia nova,/ Mia lacrimata speme!* Po ta vërejmë vargjet bëhen tani më të matura dhe shmangin natyrën idilike. Rinisë i përkasin iluzionet, ndërsa pjekuria sjell të tjera emocione. Për të lidhur këto dy faza të jetës së Silvias, poeti përdor lidhëzën *come*. Kjo lidhëz në funksion *epanalepse*, ngurtëson fundin e rinisë dhe nisjen e vdekjes. Përvoja paralele e jetës së poetit që përmendëm më lart është humbja e gjallërisë dhe prania e vuajtjes, së cilës i mëshon humbja e shpresës (*la speranza mia dolce).* Në dy mundësitë për të humbur a shpëtuar, vendosëm të negocionim me fjalën, për të shpëtuar mendimin dhe vargun. Për ta përcjellë dhimbjen që shumësia e zanoreve të italishtes nuk e gjen aq të paqtë në shqip, shfrytëzuam shprehësinë që pasthirrmat kanë në gjuhën shqipe dhe zhvendosëm lidhëzën shtuese, duke e ruajtur shprehësinë dhe ngarkesën emotive të vargut. Lidhëza *come*, siç e theksuam merr përgjegjësi sepse duke lidhur dy fusha semantike, ajo qartëson iluzionet dhe mitizon Silvian (referuar më lart). Ajo shenjon një shkallë krahasueshmërie me nuanca habie, dhimbjeje, malli, pabesie, etj. Për ta dhënë të plotë këtë fushë shenjuese, ne zgjodhëm një lokucion lidhëzor *se si*. Lokucioni në këtë rast përmbush nëpërmjet dy pjesëve të tij dy misione: me pjesën e parë sqaron, ftillon, përcakton mitizimin e Silvias, me të dytën përcjell vargëzon gjithë nuancat që numëruam më lart: *Oh, do të vdiste pas pak/edhe shpresa ime e ëmbël: Motmoteve tëmia/u qe mohuar nga fati/ rinia. O zoti im se si,/ se si ikjes i përket!/Mike e dashur e rinisë së parë,/lotshpresa ime e shuar*.

Realiteti i vdekjes së Silvias është e vërteta e saj dhe e poetit. Ky rrëfim, refleksion, dialogim i ndjerë ka një fund të trishtë të përbashkët. *Historia e Silvias, me shëmbëlltyrën e saj të ndritshme dhe të shpejtë, bëhet kështu emblema e së njëjtës histori të rinisë dhe shpresave të destinuara kur shfaqet e vërteta*[15]. Paqartësia që ne ndeshim ka të bëjë me fuqinë

sintetizuese të vargut: kjo e vërtetë deluzive i takon vetëm poetit, apo bashkon gjithë njerëzimin shpërbërja e shpresës? *Questo è quel mondo? Questi/ I diletti, l'amor, l'opre, gli eventi/ Onde cotanto ragionammo insieme?/ Questa la sorte dell'umane genti?/ All'apparir del vero/ Tu, misera, cadesti: e con la mano./ La fredda morte ed una tomba ignuda/ Mostravi di lontano*.

Në fakt, fundi është kontrasti mes iluzionit dhe aparencës së thatë e të vërtetë. Duke mos qenë grua/femër, por vetëm një shëmbëlltyrë drite, kontrastimi me grinë e fundit të poezisë (*La fredda morte ed una tomba ignuda)* zbërthen të vërtetën filozofike, për të cilën jemi endur nëpër vargje duke synuar të përmbushim misionin tonë të vështirë: të sjellim në shqip të vërtetën e Leopardit. Strofa e fundit është përgjegjësia semantike e poezisë: ruajtëm përemrat dëftorë, ruajtëm enumeracionin, pyetjet reorike dhe leksikun, duke përdorur ato sema që i japin mundësi lexuesit të receptojnë cilësitë e qenësishme të tyre. Luajtëm me sintaksën për ta sjellë në formën poetike të shqipes, diku mes *inversonit dhe enjambements*-it, për të arritur te pohimi i Leopardit: fati i Silvias është i njëjtë me fatin e poetit. *Kjo qenka ajo botë dhe këto/ gëzim, dashuri, vepra e momente/ në pështpëritjet tona aq shumë ligjëruar./ Ky qenka fati që njerëzimin e brente?/ Ndërsa zbardh e vërteta,/ perëndon ti e mjerë. Nga tjetër botë/ shënon akullin e vdekjes dhe varrin e zhveshur/ dora jote e ftohtë*.

Silvias

Struktura e tekstit poetik të Leopardit, e afërt me strukturën e kompozimit muzikor, e ngjashme me muzikën e popullit të tij, ndërtohet përmes korpusit semantik të përdorur, i cili nënkuptohet si shenjë e jetës reale nga jeta e autorit, qëmton ndjesi të dhimbjes së trishtë, e cila më pas vijon rrugën në pavarësinë e saj, nëpërmjet vetidentifikimit; ndërsa qëmtimi pragmatik është hapësira ku e vërteta shpaloset e njëjtësuar me dhimbjen e madhe të poetit përmes imazhit të përmbysur jetë/vdekje.

Poezinë (në shqip) u munduam ta kthenim në partiturën e Leopardit. Shqipja herë të ndihmon e herë të pengon për të siguruar muzikalitetin që ne i premtojmë poetit, por idetë nuk ia gjymtuam.

Silvias

1.Silvia, të ndërmendet ende
ajo kohë e jetës tënde mortore
kur bukuri rrezatoje
nga sytë e tu gazmorë e ikanakë,
e ti, gëzimmenduara kaloje
të hershmin e rinisë prag?

2.Tingëllonin të qeta
dhomat e udhët përqark
këngëve të tua vetmitare.
Kur atëherë në punëra femërore thelluar
uleshe krejt e gëzuar
prej ardhëmërisë vagullore që në mendje kishe
Ishte maji aromëluleve: e kështu ti ishe
e mësuar ditën të kaloje.

3.Unë leximet e bukura
shpesh braktisja edhe kartat e vështira
ku rinia ime e parë
dhe nga vetja pjesa më e mirë shkrihej.
Që lart ballkoneve të pallatit atëror
gjerbja veshit tingullin e tëndit zë
edhe dorën e shkathët
që pëlhurën e lodhshme përshkonte.

4. Vështroja qiellin e pastër,
rrugët e diellta e rrugicat,
këndej detin e kthjellët së larti, të lartin mal.
T'rrëfente se ç'vlonte në gjoks,
fjala më ishte e varfër.

5.Sa të ëmbla mendimet
sa shpresa e sa ndjesi, e imja Silvia!
Si na shfaqej atëherë
jeta e njeriut dhe fati!
E sot, kur shpresa e madhe më ndërmendet
u ndjekërkam i mundur
nga një ndjenjë memece ankthi.
Gjakon gjëma ime gjer në gjymtyrë.
O natyrë, o natyrë,
pse tradhtove më vonë
ç'ka premtove dikur? Pse aq shpesh
bijtë e tu i mashtron?

6.Ti, para se blerimi të zverdhej prej dimri
nga sëmundje tinëzare, luftëtare e mundur
shuheshe dashuri. E nuk mund ti të shihje
petalet e tëndes rini.
Pa, në zemër nuk regëtije
nga fjalët e ëmbla për t'errtën floknajë,
për t'ëmblat vështrime dashurie të drojtur.
Do mungoje kur shoqet të flisnin
ndër lodra dashurore..

7.Oh, do të fikej pas pak
edhe shpresa ime e ëmbël: moteve të mia
u qe mohuar nga fati
rinia. O zoti im se si,
se si ikjes i përket!
Mike e dashur e rinisë së parë,
lotshpresa ime e shuar.
Kjo qenka ajo botë dhe këto
gëzim, dashuri, vepra e momente
në pështpëritjet tona aq shumë ligjëruar.

8. Ky qenka fati që njerëzimin e brente?
Ndërsa zbardh e vërteta,
perëndon ti e mjerë. Nga tjetër botë
shënon akullin e vdekjes dhe varrin e zhveshur
dora jote e ftohtë.

BIBLIOGRAFI

Barile, L., Il Leopardi di un Rebora "malato d'assoluto", Interlinea, Novara 1993.
Barthes, R., Aventura semiologjike, Dukagjini, Pejë 2008.
Bisuti, D., La poesia salva la vita, Universale Economica Feltrinelli, quarta Edizione, Ottobre 2018.
Blasucci, L., Genesi e contruzione di „A Silvia" e Note sul testo di „A Silvia" në Lo stormire del vento tra le piante, Testi e percorsi leopardiani, Marsillio, Venezia 2003.
Chevrel, Y., Letërsia e krahasuar, Naimi, Tiranë 2016.
Eco, U., Të thuash gati të njëjtën gjë, Dituria, Tiranë 2006.
Eco, U., Sulla letteratura, Bompiani, Milano 2002.
Ferroni, G., Storia della literatura italiana, vol III, Dal`ottocento al novecento. Einaudi, Torino 1991.
Galdi, L., Introduzione alla stilistica italiana, Patron Editore, Bologna 1984 (ribotuar 8 herë-botimi i parë 1971).
Gashi, A., Proza autobiografike (Poetika dhe modele), Parnas, Prishtinë 2017.
Hatim, B., Teachhing and researching translation Harlow: Longma, 2001. Xvi+254pp. ISBN 0-582-32899 (Applied linguistics in action series)
Heidegger, M., Der Weg zur Sprache, Vitrorio Klosterman, Frankfurt am Main, 1985.
Marteta, R., Publicistika e Lazër Shantojës. Paradigmë shqiptare e mendimit modern, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet albanalogjike, Tiranë 2021.
Nida, E.A., & Taber, C.R., Theory and practice of Translanting, Brill, Leiden 1969
Notici, S., L`idea di musica in Leopardi e la sua incidenza sui i „Canti", Universita degli studi della Callabria, Facolta di lettere e filosofia, anno 2005-2006.
Plangarica, T., Aspekte të gjuhësisë së zbatuar, INALCO, Paris 2017.
Prete, A., Finitudine e infinito, Su Leopardi, Feltrinelli, Milano 1998.
Rebora, C., Per un Leopardi mal noto, «Rivista d'Italia», anno XIII, fasc. IX, settembre 1910.
Rieu, E.V., Translation in Cassell`S Encyclopeadia of Literatture, Vol 1, Casell, London 1953.
Ristani, V., Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve `90, Geer, Tiranë 2010.
Teichman, E., Hapa nëUniversin e ligjërimit (Përmbledhje punimesh gjuhësore-pragmatike), Marin Barleti, Tiranë 2010.
Todorov, T., Teorie del simbolo, Garzanti, Milano 1991.

Web-site
https://www.studenti.it/la-ginestra-di-leopardi.html
http://folkloremaceratese.blogspot.com/2006/02/caratteristiche-di-alcuni-balli-tipici.html
https://fjalorthi.com/ndër?PageSpeed=noscript
https://site.unibo.it/griseldaonline/it/didattica/carla-sclarandis-leopardi-scuola-competenze
https://core.ac.uk/download/pdf/59326015.pdf
https://www.researchgate.net/publication/266017340_Translation_ideology_and_creativity

10 Galdi, Idem, f. 184
11 Si shumica e gramatikave deskriptive.
12 Antonio Prete, Finitudine e infinito, Su Leopardi, Feltrinelli, Milano 1998, f. 9.
13 Giulio Ferroni, Storia della literatura italiana, vol III, Dal`ottocento al novecento. Einaudi, Torino 1991, f. 233-235.
14 https://site.unibo.it/griseldaonline/it/didattica/carla-sclarandis-leopardi-scuola-competenze
15 Luigi Blasucci, vep. cit., f. 139.

Karikaturë nga Arben Meksi